

KOLEGJI UNIVERSITAR
PJETËR BUDI
Instituti për studime –Prishtinë

LOGOS

Nr.5/2012

Botuesi :

Kolegji Universitar "Pjetër Budi"

Instituti për studime-Prishtinë

Koordinator:

Fitim Maçani

Bordi editorial:

Akademik Sofronija Miladinoski

Prof.Dr.Zija Zimeri

Prof.Dr.Baki Koleci

Prof.Dr.Ibish Mazreku

Prof.Dr.Sreten Miladinoski

Recensent:

Prof.Sofronija Miladinoski,PhD,

Prof.Naume Marinovski,PhD,

Redaktor gjuhësor :

Emira Limani

Dizajni:

Fazli Nrecaj

U shtyp në shtypshkronjën:

Digital Print-Prishtinë

Tirazhi:

500

Bashkimi Evropian – Sfidat dhe Perspektivat e Ballkanit

Fatmir Halili

Abstrakt

Bashkimi Evropian të cilin e njohim ne sot nuk lindi aty për aty por kaloi nëpër një proces të gjatë dhe përplot vështirësi. Nga një ide jo edhe aq e formësuar në fillim arriti të bëhet një bashkim shtetesh me tendencë të një superfuqie globale.

Nga një bashkim fillimisht me gjashtë anëtarë dhe i lidhur vetëm ekonomikisht, sot BE-ja numëron njëzeteshtatë anëtarë me një bashkëpunim ekonomik, politik dhe në fushën e sigurisë. Rruga nëpër të cilën kaloi ishte përplot sfida, nuk ishte e lehtë të mposhten nacionalizmat kombëtarë, nuk ishte e lehtë të harrohej e kaluara e përlëshjeve ushtarake dhe jo vetëm në mes të këtyre kombeve. Nuk ishte e lehtë të bashkohej Gjermania, Franca, Anglia etj. për të filluar një jetë të përbashkët pas përjetimeve të tmerreve të luftës së dytë botërore, por nuk do të jetë i lehtë të ndryshoi as mentaliteti dhe kokëfortësia e politikës ballkanase dhe e urrejtjes ndaj njeri-tjetrit që ende frymon në këtë rajon të Evropës. Sido që të jetë, sfidat edhe më tej pritet të vazhdojnë. Duke ditur të kaluarën jo të largët të Ballkanit, si sfida e radhës sigarisht mbetet integrimi i këtyre vendeve në Bashkimin Evropian. Çfarë strukture do të ketë BE-ja dhe si do të funksionoj në të ardhmen ky bashkim shtetesh? Cilat do të jenë sfidat e zgjerimit të më tejshëm të tij? A do të arrij të tejkaloi këto sfida në të ardhmen BE-ja etj., pikërisht këto do të jenë temat me të cilat do të ballafaqohemi në këtë punim. Jam koshient se për këtë temë mund të shkruhen me qindra faqe, megjithatë do të mundohem që të prek pikat më të rëndësishme të sajë.

Fjalë kyçe: *Bashkimi Evropian, Ballkani, sfida e zgjerimit, integrimi evropian, reforma strukturore, shieti ligjor, etj.*

Politikat e Ballkanit kundrejt integrimeve Evropiane

Me rastin e hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë Hungaria, Rumania dhe Bullgaria nuk u dhanë leje mjeteve transportuese të trupave Ruse të fluturonin mbi territoret e tyre duke parandaluar në këtë mënyrë një ndeshje me forcat e NATO-s me pasoja të rrezikshme për paqen në të gjithë Evropën. Si shpërblim për këtë Bashkimi

Evropian me 2007 i pranoi në BE ende pa i plotësuar të gjitha kushtet¹. Siç shihet nga kjo ky integrim me shumë ishte për arsye politike,

Integrimi i radhës që pritet të ndodhë, ku përfshihen edhe shumica e vendeve të ish-RSFJ-së, vërtetë është kompleks dhe ndoshta ndër më të vështirët. Vende ku ende po ndihet era e sistemit të kaluar dhe e urrejtjes ndaj njëri-tjetrit. Pavarësisht nga arritjet e deritanishme, megjithatë stabiliteti i rajonit vazhdon të ngrihet mbi baza të dobëta. Proceset e reformave strukturore në vendet e ish – Jugosllavisë (përveç Sllovenisë dhe Kroacisë) pengohen nga trashëgimia e të kaluarës: sfida tepër të mëdha strukturore, probleme konstitucionale, një situatë e vështirë ekonomike dhe paqëndrueshmëri politike, krimi ekonomik, krimi i organizuar, korrupsioni i madh i zyrtarëve të lartë, lidhja e politikaneve me mafinë. Në dekadën e parë të shekullit XXI siç duket rajoni ka filluar të stabilizohet, rreziku i luftës nuk është më i pranishëm, por fatkeqësisht regjimit hegjemonistë të Millosheviqit ende i kanë mbetur rrënjët në Serbi dhe tenton ta mbaj rajonin nën presion të vazhdueshëm. Një reformë politike është e domosdoshme të ndodhë që të orientoj politikën Serbe drejt realitetit të shekullit XXI. Vendet e tjera të rajonit si: Republika e Kosovës, Shqipëria, Maqedonia etj. kanë reformuar politikën e tyre duke e orientuar tërësisht drejt perëndimit, por megjithatë elemente negative politike, shoqërore, ekonomike, si dhe problemet me krimin e organizuar dhe korrupsionin, vazhdojnë të mbetën prezentë.

Historia e vërtetë e Ballkanit është e lidhur me një të kaluar të hidhur ku tendencat për mbizotërim të një kombi ndaj një tjetri kanë dominuar gjithnjë, dhe këto probleme akoma po e përcjellin këtë pjesë të Evropës. "Kjo histori duhet të mësohet me qëllim që të shmangët përsëritja e saj dhe nuk duhet të shërbejë si mekanizëm përmes të cilit një grup ndjehet i justifikuar për ta sunduar tjetrin². Për BE-në Ballkani ishte një sfidë që duhej përballur me urgjencë dhe me një strategji afatgjatë e të përpunuar mirë. Në pranverën e vitit 1999, u duk se BE përfundimisht e kuptoi këtë domosdoshmëri dhe ishte i "dënuar" të vepronte pa humbur kohë³

Bashkimi Evropian përmes sfidave dhe perspektives

Kalimi nga një ide në realitet, duke bashkuar për një jetë të përbashkët vendet e një kontinenti që kishin përjetuar një të kaluar të hidhur, vërtetë ishte një sfidë dhe një proces i vështirë. Por akoma nuk është një shtet i vetëm dhe nuk dihet se çfarë do të jetë.

Evropa është në një pozicion ndërmjetësues, që do të thotë se nuk ka një formë të qartë që mund ti vendosim një emërtim të saktë përkatës, ndoshta është e destinuar për

¹ Shih më gjerësisht për këtë në: WOLFGANG LIBAL, CHRISTINE von KOHL, Ballkani faktor qëndrueshmërie apo pëshqjellimi në Evropë, Rozafa, Prishtinë, 2006, fq.32

² EUROPA, revistë nr.4 botimi i bibliotekës evropiane të Kosovës, Prishtinë, 2008, fq..026

³ Paskal Milo, Bashkimi Evropian, albPAPER, Tiranë, 2002, fq.276

të qenë një shtet i madh, por siç na mësojnë SHBA-të, një transformim i ngjashëm nuk realizohet sot për nesër⁴.

U deshën po thuaj njëqind vjetër dhe një luftë civile para se SHBA të bëheshin shtet që të gjithë njohim dhe që jemi të vetëdijshëm për forcën ekonomike dhe rolin politik që kanë në arenën ndërkombëtare. Sa vite i duhen Evropës së sotme që të kristalizojë dhe finalizojë projektin e saj të madh bashkues, në një strukturë të vetme gjithëpërfshirëse të qartë, efektive dhe solide në aspektin ekonomik, politikë, diplomatik dhe ushtarakë⁵. Natyrisht se sfidat për të tejkaluar nacionalizmat e popujve të ndryshëm sidomos atyre të Ballkanit në fazën e tanishme kërkon një kohë jo të shkurtër. Me të drejtë e kishte thënë Zhan Monë: “duhet ndryshuar rrjedha e ngjarjeve, për këtë duhet ndryshuar shpirti i njerëzve”.

Bashkimi Evropian është ide gjeniale e projektuar pikërisht nga qytetarët e saj, e dashuruar pas institucioneve, përmes të cilave janë krijuar ligje dhe doktrina ndërkombëtare, për të cilat bota kishte shumë nevojë për tu shkëputur nga e kaluara jo e hijshme e pasur me beteja të përgjakshme, për tu bërë pjesë e një të ardhme më të mirë që në thelbin e saj ka bashkimin dhe integrimin vullnetar me shpresën dhe dëshirën e bashkëjetesës në paqe, harmoni, mirëkuptim, prosperitet dhe zhvillim⁶. Mbetet që ti lëmë kohës të dëshmojë se kur do të arrijë Evropa të realizojë këtë aspirim të sajë. Në këtë rast vlen të përmenden edhe fjalët e Shumanit⁷, i cili në deklaratën e tij të 9 majit 1950 pat thënë “Evropa nuk mund të bëhet me një të goditur, as edhe në një ngrëhinë të vetme: ajo do të bëhet me realizime konkrete, duke krijuar më së pari një solidaritet real”⁸.

Forma e ardhshme institucionale dhe organizative e BE-së

Që nga themelimi i tij Bashkimi Evropian si një organizatë shtetesh vazhdimisht shkoi drejt zgjerimit dhe formësimit të tij institucional. Nuk ka dyshim se shumica e qytetarëve të BE-së e shohin atë si njëriën prej superfuqive të ardhshme të botës ku njerëzit do të jetojnë të sigurt dhe me një ekonomi të zhvilluar.

Teoria parashikon skenarë të ndryshme të zhvillimit në të ardhmen e BE-së. A do të bëhet një federatë shtetesh evropiane me një kushtetutë, do të përfundojë në një zonë të zgjeruar të tregtisë së lirë, e cila do të shpinte pastaj drejt integritetit politikë, ka të

⁴ <http://juridiksi.e-monsite.com/rubrique,bashkimi-evropian,1078728.html>

⁵ Po aty,

⁶ Po aty

⁷ Ish Ministër i Jashtëm Francez, i cili e prezantoi idenë për Evropën e Bashkuar më 9 maj 1950

⁸ Bashkimi Evropian- përmbledhje traktatesh, botim i qendrës Evropiane, Tiranë, 2000, fq.3

bëjë me modelin e të ashtuquajturit "integrim binjak" apo do të shuhej edhe vetë ky integrim?

Këto skenarë të zhvillimit të ardhshëm të BE-së, janë edhe qëndrimet zyrtare politike të tri fuqive kryesore të Bashkimit Evropian, deri më tash janë dalluar drejtimi Britanik, Francez dhe ai Gjerman për zhvillimin e ardhshëm të BE-së¹⁰. BE ka institucionet e veta që nga traktati i Parisit i vitit 1951 që kanë evoluuar nga një fazë në fazën tjetër, territorin dhe popullsinë që janë elementet kryesore për ekzistimin e një shteti, por ende nuk mund të japim epitetin e një shteti në kuptimin e plotë të fjalës.

Është e vështirë të parashikojmë se çfarë strukture do të ketë në të ardhmen BE-ja për faktin se ndryshimet globale dhe sfidar që e presin BE-në janë shumë të mëdha dhe të paparashikueshme. Duke pasur parasysh kronologjinë e ngjarjeve dhe rrugën nëpër të cilën ka kaluar BE nga themelimi i BETHÇ-së¹¹ më 1951 e deri tek traktati i Lisbonës (kushtetuta Evropiane) mund të nxjerrim një përfundim se BE në një të ardhme jo shumë të largët do të jetë një federatë shtetesh Evropiane me një kushtetutë të përbashkët dhe si njëra prej superfuqive Globale.

Balkani Perëndimorë dhe Bashkimi Evropianë

Më 1993 Këshilli Evropian i Kopenhagës mori vendim crucial që të gjitha shteteve të Evropës Lindore dhe Qendrore t'ua hapë perspektiven e anëtarësimit, nëse do të përmbushin kushtet e caktuara. Por pas Sllovenisë dhe Kroacisë, shtetet tjera të dal nga ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë nuk kishte fituar statusin e kandidatit për anëtarësim të plotë në BE. Kjo nuk pritet për një afat të shkurtër e as të mesëm kohor edhe nga shtetet e Ballkanit Perëndimor. Bashkimi Evropian njih megjithatë, përgjegjësinë e vetë në rajon dhe obligohet për të shtyre përpara reformat politike dhe ekonomike¹². Konflikti në Kosovë, në pranverën e vitit 1999 dhe angazhimi i drejtpërdrejtë i vendeve të BE-së në zgjidhjen e tij e nxiten atë në refleksione më të thella e më të gjera. Ky konflikt nuk ishte diçka e veçuar nga procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë, që kishte filluar në fillim të viteve 90-të, Kosova dhe Ballkani ishin pjesë e Evropës. Politikat e pavendosura dhe zgjidhjet gjysmake përkundrejt këtij rajoni, kishin një kosto të lartë e të gjithanshme për BE-në gjatë gjithë viteve 90-të¹³. Ajo që është e rëndësishme për vendet e Ballkanit, është ndërmarrja e reformave politike, ekonomike e të drejtësisë për të përmbushur konditat e vendosura nga BE-ja, por një faktor shumë i

⁹ Shih më gjerësisht për këtë: Blerim Reka & Arta Ibrahim, Studime Evropiane, Tetovë, 2004, fq.282

¹⁰ Po Aty fq. 283

¹¹ Komuniteti për Thëngjill dhe Çelik i nënshkruar në vitin 1951 në mes të Francës, Gjermanisë, Italisë dhe vendeve të Beneluksit (Holandë, Belgjikë dhe Luksemburg).

¹² Blerim Reka, Arta Ibrahim, Studime Evropiane, Tetovë, 2004, fq. 252

¹³ Paskal Milo, Bashkimi Evropian, AlbPAPER, Tiranë, 2002, fq. 275, 276

rëndësishëm që kërkohet të realizojnë vendet e Ballkanit është largimi i nacionalizmave të së kaluarës dhe vendosja e marrëdhënieve të mira fqinjësore në mes këtyre popujve.

Nëse dështojnë proceset e reformave dhe të tranzicionit, Ballkani Perëndimorë ka për tu kthyer në një geto edhe më të izoluar nga ç'është sot, duke u kthyer në një kërcënim për stabilitetin dhe paqen. Angazhimi i deritanishëm i bashkësisë ndërkombëtare dhe sidomos ai i Bashkimit Evropian në rajon, kanë qenë tepër të mëdha dhe ato duhen quar me sukses deri në fund. Që të arrihet në Ballkan të krijohet një elektorat pro-Evropian, që ëndrrat e veta t'i shndërroj në vota për elitat politike të afta për të çuar përpara procesin e reformave, s'mjaftojnë thjeshtë gjestet simbolike dhe retorika. Do të duhen përpjekje po aq të mëdha për të bindur publikun e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian se në një të ardhme, Ballkani do të jetë pjesë e Bashkimit Evropian dhe se kjo është diçka e ngutshme.

Përfundim

Bashkimi Evropian si bashkësi shtetesh të pavarura e cila filloj të formësohet nga themelimi i Komunitetit për Thëngjill dhe Çelik në Paris në vitin 1951 nga gjashtë shtetet e para si një bashkësi e cila kishte për qëllim futjen nën kontroll të thëngjillit dhe çelikut, ka evoluuar dhe është shndërruar në një organizim ekonomik, politik dhe juridik, me pranimin në gjirin e saj edhe vendet postkomuniste ka zgjeruar kufijtë e saj dhe ka përfshirë shumicën e vendeve të Evropës perëndimore. Natyrisht e arritur e padiskutueshme ishte zgjerimi i BE-së, perspektiva e anëtarësimit në BE ia doli të konsolidonte reformat demokratike dhe ato të tregut në tërë Evropën Qendrore dhe Lindore. Procesi i integrimit solli ndryshime të mëdha në shoqëritë që ishin aq të ndryshme në mes tyre.

Viteve të fundit jemi dëshmitar të krizës ekonomike dhe financiare që i ka kapluar disa vende të Bashkimit Evropian dhe si duke ka ndryshuar edhe qasja ndaj zgjerimit. Do të thotë se zgjerimi i ardhshëm është sfida kryesore e Bashkimit Evropian, zgjerim ky që pritej të përfshijë vendet e Ballkanit që shumica janë ish njësi të federatës Jugosllave.

Të gjitha vendet e Ballkanit e kanë perspektivën në Bashkimin Evropian, kjo është e proklamuar qartë në dokumentet dhe deklaratat e zyrtarëve të BE-së, por është edhe kërkesë e theksuar e të gjitha këtyre vendeve për tu bërë pjesë e Evropës së bashkuar.

Këto vende obligohen t'i plotësojnë kriteret e parapara për anëtarësim ndërsa Bashkimi Evropian ta pranoj kërkesën e tyre për anëtarësim.

Me integrimin e vendeve të Ballkanit do të marrë fund procesi i integrimit në mbarë kontinentin e Evropës.

Bibliografia

1. Paskal Milo, *Bashkimi Evropian*, albPAPER, Tiranë, 2002
2. Blerim Reka, Arta Ibrahim, *Studime Evropiane*, Tetovë, 2004
3. WOLFGANG LIBAL – CHRISTINE von KOHL, *Balkani – Faktor Qëndrueshmërie apo Pëshqjellimi në Evropë*, Rozafa, Prishtinë, 2006
4. *Revista Evropa*, nr. 4, Biblioteka Evropiane e Kosovës, Prishtinë, dhjetor 2008
5. *Bashkimi Evropian-përmbledhje traktatësh*, botimi i qendrës Evropiane, Tiranë, 2000.

<http://juridiksi.e-monsite.com/rubrique,bashkimi-evropian,1078728.html>

e - TURIZMI

MSc Lulzim Shabani, PhD candidate

Kolegji Universitar "Pjetër Budi", Prishtinë, Kosovë

Abstrakti

Trendet e zhvillimit të shoqërisë në të gjithë sektorët kanë ndryshuar falë zhvillimeve të Teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

e-Turizmi përmes sistemeve elektronike mundëson:

Promovimin e vendeve - lokacioneve turistike,

Informimin për vendet më të bukura,

Pamje vizuale të imazheve dhe video nga vendet turistike,

Rezervime One-Line nga distanca,

Pjesëmarrjen interaktive në mes të turistëve dhe ofruesve të shërbimeve turistike.

e-Turizmi gjithashtu mundëson që përmes e-anketave të klasifikohen vendet më të bukura (joshëse) turistike.

Këto dhe shumë benefite të tjera të cilat ende nuk ofrohen në Kosovë, por që ofron e-Turizmi në vendet me industri të zhvilluar turistike rezultojnë në mënyrë zingjirore në përfitime më të larta për ofruesit e shërbimeve, ndërsa për turistët çmime më të favorshme.

Fjalët kyç: e-Turizmi, turistët, zhvillimi, informimi.

Hyrje

Zhvillimi i teknologjive të reja të informacionit është një kontribut i madh për zhvillimin e të gjitha llojeve të turizmit. Për bizneset turistike internet oferta është bërë burimi më i madh i informacioneve për prenotime të objekteve në të gjitha periudhat kohore. Kjo ofertë virtuale e cila mund të transmetohet në shumë mënyra ka racionalizuar dhe shkurtuar shpenzimet dhe kohën për furnizuesit turistik, ndërmjetësuesit dhe konsumatorët.

Shënimet për trendet e fundit turistike kanë vërtetuar se zhvillimi i këtyre teknologjive ofron mundësi më të lamshme për të zgjeruar bazën e konsumatorëve dhe futjen në treg të produkteve ose shërbimeve të reja dhe ndikon drejtpërdrejtë në racionalizimin e biznesit.

Sipas Organizatës Botërore të Turizmit (OBT), interneti ka arritur revolucionarizim në shpërndarjen e informacionit në industrinë turistike dhe atë të shitjes së produkteve dhe shërbimeve, përfshirë këtu dhe promovimin e lehtë të tyre.

Megjithatë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të cilat veprojnë në Kosovë dhe ofrojnë shërbime turistike, po përballen me pengesa dhe probleme nga më të ndryshmet të cilat kryesisht kanë të bëjnë shkallën e përballueshmërisë së kësaj dinamike, si dhe strukturën e zbatimit të saj në këtë rritje aq të shpejtë të ndryshimeve që sjell teknologjia e informacionit. Pavarësisht këtyre sfidave, këto ndërmarrje turistike, apo disa prej tyre me faqet e internetit të zhvilluara dhe inovative tani mund të kenë qasje të barabartë në tregjet regjionale dhe ndërkombëtare të turizmit.

Miratimi i strategjisë për e-Turizëm ka hapur një portë e re për zhvillimin e kësaj industrie. Zhvillimi i komunikimit digjital dhe informacionit turistik nuk është më një opsion alternativ, por një domosdoshmëri për ndërmarrjet të cilat ofrojnë këto shërbime që ato të zhvillohen dhe të rriten.

Kontributi teorik i hulumtimit tonë bazohet në përfshirjen e dimensionit social si një nga avantazhet konkurruese të e-turizmit që mund të ndikojnë në miratimin më të shpejtë të këtij shërbimi. Në mënyrë që të dallojë veten nga shpërndarësit tradicional të ofertës, turizmi online dhe furnizuesit e shërbimeve duhet të përqendrojnë marketingun e tyre në motive sociale dhe avantazhet e tjera të e-turizmit për klientelë të tyre, të tilla si çmimet konkurruese, kursimet në kohë, lehtësinë e qasjes së produktit dhe pavarësinë në vendimmarrje turistike.

Ky dokument përshkruan një hulumtim apo kërkim shkencor në lidhje me përparësitë dhe kërcënimet e shkaktuara nga interneti për kompanitë turistike, duke përcaktuar një korizel për të vlerësuar domosdoshmërinë e zhvillimit të këtij sektori të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik.

Përfitimet nga e-Turizmi

Nga hulumtimet e zhvilluara viteve të fundit rezulton se gama e përfitimeve për vendet apo ndërmarrjet të cilat kanë instaluar e-Turizmin është shumëdimensionale. Kurba e përfitimeve fillon nga siguri më i lehtë informacioneve mbi shërbimet e turizmit, siguri më cilësor dhe sasi i tyre, krijimi i tregjeve të reja, përmirësimi i shërbimeve, krijimi i mardhënieve interaktive me klientët, ulja e kostos operative, tërheqja dhe mbajtja apo ruajtja e klientëve, bashkëveprimi më i lehtë me partnerët e tjerë në këtë lloj biznesi e deri te identifikimi i partnerëve të rinj të cilët i futen procesit garues apo konkurrencës në këtë sektor.

Ndryshimet teknologjike që sjell kjo ofertë janë dhe do të vazhdojnë të jenë forca kryesore që mund të ndryshojë rregullin e konkurrencës. Kjo ndodhë sepse shumica e aktiviteteve në këtë sektor të ekonomisë përdorin informacionin si produkt të tyre kryesor në marketing. Ndikimi i fuqishëm dhe dinamik i kësaj teknologjie e cila është bërë platformë e komunikimit masiv, mund të përmbledhet në shumë komponente, por në rastin tonë po i përmendim tri më kryesore:

- Zhvillimi i TIK mund të ndryshojë strukturën e këtij sektori dhe rregullat e konkurrencës,
- TIK mund të përdoret për të krijuar avantazh të qëndrueshëm konkurrues dhe të sigurojë kompanitë me instrumente të reja kualitative dhe sasiore konkurruese,
- Si rezultat i zhvillimit të TIK, biznesi i ri turistik mund të zhvillohet pa ndjenjën e inferioritetit karshi bizneseve tjera më të vjetra apo më të mëdha.

Pengesat dhe problemet për zhvillimin e e-Turizmit

Si në çdo vend tjetër edhe te ne ka një numër të pengesave për zhvillimin e e-Turizmit. Këto vështirësi përfshijnë njohuri të kufizuara të teknologjisë në dispozicion, të mungesës së vetëdijesimit, koston e investimit fillestar, pastaj mungesa e besimit në të mirat që ofron e-Turizmi dhe kostoja e mirëmbajtjes së sistemit. Këto probleme gjithashtu përfshijë mungesën e burimeve njerëzore të kualifikuara dhe rezistencën ndaj përqafimit të e-Turizmit si një perspektive e re zhvillimore për të vazhduar edhe me pamjaftueshmërinë e zhvillimit të infrastrukturës për e-Biznesin në përgjithësi, apo e –Turizmin në veçanti. Në fund nuk duhet të

anashkalohet edhe madhësia e tregut turistik bashkë me frikën e ndryshimeve në kulturën korporative.

Ekziston nevoja për një sistem të mirë-strukturuar informativ ose të teknologjive inteligjente në industrinë e turizmit për të lehtësuar qasjen e informacionit turistik nga përdoruesit. Sistemi aktual i TIK ka kufizime të caktuara. Për shembull, qasja në informacion përmes internetit dhe www është një mjet inteligjent për të marrë informacion, por shumë herë informacioni është shumë i fragmentuar. Konsumatori – përdoruesi turistik do të arrijë deri te informacioni i plotë turistik vetëm pas kërkimit inteligjent i cili po të mos jetë i zhvilluar dhe mund mashtrojnë në këtë proces, prandaj veçat e kërkimit për turizëm duhet të zhvillohen.

Implikimet politike

Roli i qeverisë në zhvillimin e teknologjisë së informacionit pa dyshim se është shumë i rëndësishëm. Qeveria duhet të shmangë krijimin e pengesave të panevojshme për e-biznesin. Mbështetja aktive e qeverisë për të nxitur një kulturë sipërmarrëse është gjithashtu shumë e rëndësishme. Agjendat kryesore të politikave përfshijnë sidomos rregullimin e kuadrit ligjor në të cilin faktor të rëndësishëm do të ishin mbrojtja e pronësisë intelektuale, dhe vlefshmëria e zbatimit të kontratave ndërmjet ndërmarrjeve turistike dhe palëve të treta. Taksat duhet të zbatohen për internet transaksionet dhe të identifikohen të gjithë përdoruesit për të eliminuar krijimin e monopoleve. Përkrahja mund të sigurohet në uljen e taksave, mbështetje monetare, si dhe ndarjen e njohurive dhe informacionit

ndërmjet industrive dhe organizatave kërkimore.

Së fundi, qeveria mund të ndihmojë në rritjen e e-biznesit në mënyra të ndryshme përmes planifikimit, krijimin e komizës ligjore dhe rregullative, ndërtimin e kapaciteteve në teknologjinë e informacionit, infrastrukturë, aftësimin, formimin dhe planifikimin e burimeve njerëzore si dhe ndërmarrjen e masave promovuese nxitëse. Qeveria duhet të funksionojë si një lehtësues, promovues, mësues, për testimin dhe vendosjen e pilot aplikacioneve të reja në këtë industri dinamike të shërbimeve. Qeveria gjithashtu mund të ndihmojë në krijimin e tregjeve në zonat në zhvillim në fazën fillestare dhe në heqjen e pengesave rregullative që mund të pengojnë rritjen e tregjeve dhe bizneseve.

Përfundimi dhe puna në të ardhmen

Trendet në rritje të shfrytëzuesve shkaktojnë edhe disa kërcënime të cilat duhet ti kenë parasysh ndërmarrjet turistike gjatë hartimit të strategjive të tyre për aktivitetet e ardhshme. Në këtë punim janë evidentuar disa faktorë, por që nuk përbëjnë komizën e përgjithshme për të analizuar kërcënimet dhe mundësitë që ofron kjo teknologji. Këto sugjerime mund të përdoren për të vlerësuar një ndërmarrje, region, apo sektor turistik, sepse tregu e-Turistik është shumë më i gjerë dhe me kompleks se sa është paraqitur në vështrimin tonë. Ky studim mund të thellohet me bashkëveprimin e më shumë faktorëve relevant të cilët kanë implikime të drejtpërdrejta nga kjo ofertë virtuale. Kontributet e tyre do të plotësonin mozaikun për avantazhet konkurruese brenda këtij sektori.

Telekomunikacioni dhe interneti janë një komponent i rëndësishëm i cili domosdohëmërisht duhet të ketë trende të ngritjes për promovimin e sektorit të turizmit dhe komunikimin,

Subjektet turistike të cilat janë duke zhvilluar përgatitjet për këtë revolucionarizimi virtual duhet:

- Të ndërtojnë një sistemi sipas standardeve ndërkombëtare për grumbullimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore mbi zhvillimin e kërkesës dhe ofertës,
- Të arsimojnë burimet njerëzore në shërbim të turizmit,
- Të fillojnë marketingun dhe promovimin e e-Turizmit brenda dhe jashtë vendit.

Forcimi i pranisë së Kosovës në internet është një detyrë më tepër. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka lansuar web faqen (<http://www.visitkosovo.org>). Kjo është një përpjekje fillestare e qëlluar për të siguruar që vizitorët potencialë mund të gjejnë informacion bazë për vendin. Ky website dërgon mesazhin se vendi është i hapur për biznes dhe se ka një ofertë turistike e cila synon të jetë elektronike.

Hartimi i një strategjie për praninë e përgjithshme në internet që përfshin:

- Një gjeneratë të dytë të website-it të Departamentit të turizmit për të përfshirë shpjegime më të detajuara dhe informacion mbi rrugët si dhe kontaktet me kompanitë e licensuara të turizmit dhe portalin e sektorit privat.
- Një lidhje me portalin e sektorit privat për të siguruar një qasje të lehtë të pjesëmarrësve të industrisë së turizmit të tillë si operatorët që presin vizitorët, hotelet, restorantet, furnizuesit e pajisjeve, etj.
- Krijimi i forumit të turizmit të Kosovës, i atashuar në website-in kombëtar të turizmit, i lidhur me site të shumtë, që monitorohet dhe përgjigjet në bazë ditore nga një person i programit të promovimit të turizmit.
- Vendosja e inxhitit të kërkimit. Ekspertët e teknologjisë së informacionit mund të ndihmojnë Ministrinë, përkatësisht departamentin e turizmit dhe sektorin privat në strategjitë për të siguruar që website kombëtar dhe site-et e tjera të renditet në krye të google kërkimit për destinacionet kryesore turistike në Kosovë.

Në këtë këndvështrim, është e domosdoshme për të rekrutuar një menaxher të komunikimit që do të sigurojë se mesazhet, reklamat, promocionet dhe ndërveprimet e tjera mes liderëve të opinionit dhe komunitetit të synuar të janë në kohë reale, të marrë pjesë në diskutime dhe pyetje-përgjigje postuar nga e-turistë në faqen e internetit të kompanisë si dhe në platforma të tjera të internetit, siç janë faqet e internetit të specializuara bashkëpunuese dhe rrjetet sociale.

Një çështje tjetër me rëndësi që nuk duhet të neglizhohet është koha e shkarkimit të faqeve të internetit të cilat duhet të projektohen në atë mënyrë që klientët të ndjehen se janë duke kursyer kohën. Përveç kësaj, në mënyrë që të promovohet dimensionin social i e-turizmit, do të ishte e preferueshme që furnizuesit e turizmit në internet dhe të produkteve të udhëtimit të bëjnë faqet e tyre më shumë interaktive. Pra, rekomandojmë përfshirjen e një sipërfaqe në faqet e tyre në të cilën e-turistët mund të ndajnë mendimet, praktikat më të mira, komentet dhe përvojat e tyre.

Referencat

- Akkermans, H. (2001). Intelligent E-Business: From Technology to Value. IEEE Intelligent Systems, 16(4), 8-11.
- Bashkim Ruseti & Kozeta Sevrani, Sistemet e informacionit të menaxhimit.
- Bakos, Y. (1998). The Emerging Role of Electronic Marketplaces on the Internet. Communications of the ACM, 41(8), 35-42.
- Briggs, S. (2001). Successful Web Marketing for the Tourism and Leisure Sectors, Kogan Page.

- Buhalis, D. & Schertler, W. (1999). *Information Communication Technologies in Tourism 1999*, SpringerWien, New York.
- Dayal, S., Landesberg, H. & Zeisser, M. (2000). Building Digital Brand, *The McKinsey Quarterly*, Number 2.
- Organization for Economic Co-operation and Development (OECD) (2000). Realizing the potential of electronic commerce for SMEs in the global economy, Conference for Ministers responsible for SMEs and Industry Ministers. Bologna, Italy.
- Plant, R. (2000). *E-Commerce: Formulation of Strategy*, Prentice Hall.
- Poon, A. (1993). *Tourism, Technology and Competitive Strategies*. Wallingford: CAB International.
- Porter, M. & Millar, V. (1985). How Information Gives You Competitive Advantage. *Harvard Business Review*, 63(4), 149-160.
- Qeveria e Republikës së Kosovës - "Strategjia e Qeverisjes elektronike", 2009-2015
- Rayport, J.F. & Jaworski, B.J. (2002). *Introduction to E-commerce*, McGraw Hill
- Trepper, C. (2000). *E-Commerce Strategies*, Microsoft.
- United Nations Conference on Trade And Development (UNCTAD) (2001). *E-commerce and Development Report 2001*.
- Wöber, K. W., Frew, A. J., & Hitz, M. (2002). *Information and Communication Technologies in Tourism 2002. Enter 2002*,
- World Tourism Organization (WTO) (2001). *E-business For Tourism, Practical Guideline For Tourism Destination and Busiess*.

Faktorët që ndikojnë në turizmin shqiptar

M. A. Entela Binjaku

Fondacioni "Harriet Martineau"

Vendet evropiane të ish-Blokut Komunist hynë në rrugën e tranzicionit nga një sistem i mbyllur, totalitar në një sistem të ri të hapur, demokratik duke u përballur natyrshëm me shumë probleme dhe sfida. Jashtë këtyre ndryshimeve nuk mbeti as Shqipëria. Në këto 20 vite të sistemit të ri, Shqipëria ka përjetuar ndryshime të mëdha politike, institucionale, shoqërore e ekonomike. Ndryshime të tilla sollën, krahas përmirësimit të kushteve të jetës, edhe afrimin e mundësive për të ndërtuar industrinë e turizmit, të panjohur më parë.

Për hir të pozitës gjeografike, Shqipëria konsiderohet një destinacion turistik në bregdetin e Mesdheut. Duke qenë se turizmi konsiderohet si një katalizator i rritjes ekonomike, ai merr një rëndësi të jashtëzakonshme. Edhe në Produktin e Brendshëm Bruto (PBB) e vendit tonë turizmi ka një kontribut të konsiderueshëm, megjithatë potencialet që zotëron vendi, Shqipëria, janë të atilla sa duhet të kontribuojnë edhe më shumë në të ardhurat e përgjithshme ekonomike të vendit.

Në kuptimin që i jepet sot, për shoqërinë shqiptare, turizmi është një dukuri e re, por si për çdo shoqëri tjetër të mësuar me këtë koncept, mbështet nevojën për rigjenerim të shëndetit, dëshirën për të ndryshuar ambient, nevojën për të kultivuar ndjenjën e së bukurës, zgjerimin e njohurive kulturore historike, vendosjen e lidhjes me natyrën, shtimin e lidhjeve sociale etj., në kushtet kur bukuritë turistike të krijuara nga vetë natyra, apo të ndërtuara nga dora e njeriut, janë një ushqim shpirtëror i pazëvendësueshëm.

Turizmi është industria që përmbush disa kushte të rëndësishme për vendet e zhvilluara në përgjithësi e në zhvillimin e vendit tonë në veçanti. Ato janë:

Efektet ekonomike janë të njohura si kontributi në PBB, të ardhurat si rezultat i punësimit.

Efektet mbi mjedisin: Turizmi mund të ruajë një zonë të mbrojtur e cila mund të ishte shumë e brishtë ndaj zhvillimeve të industrisë.

Ekoturizmi është një koncept shumë i ri i cili synon të ruajë jetën genuine, autenticitetin, traditat kulturore e sociale dhe veçoritë e vlefshme të zonës.

Efektet kulturore: shkëmbimi ndërkulturor është një ndër efektet e njohura.

Efektet politike: Turizmi është një mundësi më vete për të afruar popujt, kulturat, besimet fetare, apo dhe traditat e vendit me ato të vizitorëve të ndryshëm.

Efektet sociale: Zhvillimi i turizmit në një zonë të caktuar ka një efekt me kahe të kundërt: krijon vende të reja pune dhe përmes rritjes së kushteve të përmirësuara ekonomike ndihmon në përmirësimin e raporteve sociale brenda familjeve, por nga ana tjetër orët e gjata të punës dhe shërbimit e zakonisht një program i ngjeshur i punës i bën njerëzit më pak social, dhe në një lloj mënyre bëjnë të heqin dorë nga të shijuarit e jetës së rregullt e të planifikuar.

Qëndrimi i individit ndaj punës, pronës, parasë, administrimit të të ardhurave në funksion të plotësisht të interesave materiale dhe sociale është në themel një diskutim që i prek sociologët. Studiuesit socialë trajtojnë sferën sociale të një veprimtarie prodhuese, ndikimin e faktorëve socialë (emigrimi, edukimi, arsimimi, shkalla e formimit profesional etj.) mbi rendimentin e punës apo prodhimit.

Arsyja se përse hartuesit e politikave ekonomike e konsiderojnë turizmin si trendin e rëndësishëm ekonomik dhe social të vendit tonë lidhet edhe më rëndësinë e madhe që ka pasur ky element në këto vite tranzicioni, ku shihet si një nga burimet më të rëndësishme të të ardhurave, të mundësive të punësimit, të diversifikimit të ekonomisë, të mbrojtjes së ambientit si dhe të promovimit të shkëmbimeve ndërkulturore.

Të gjitha shtetet kanë përdorur një shumëllojshmëri metodash në varësi të filozofisë së zgjedhur për të zhvilluar një turizëm sipas standardeve të kërkuara dhe në përputhje me specifikat që paraqet secili vend.

Elementët socialë të industrisë turistike janë dy: *venkasi dhe miqtë*. Raporti midis tyre përcaktohet nga kushtet që të parët ofrojnë, kultura që pasqyrojnë në shërbimet që kryejnë, të kuptuarit e mentalitetit të turistit dhe arritja e fitimit vetëm si shpagim i kënaqësisë që ka marrë ky i fundit. Nga ana tjetër, miqtë janë subjekt i padiskutueshëm dhe që kanë gjithnjë të drejtë dhe ky është i vetmi koncept mbi bazën e të cilit turizmi mund të lulëzojë.

Midis këtyre dy grupeve të mëdha qëndron infrastruktura turistike: hotelet, restorantet, agjencitë turistike, shërbimet e transportit, operatorët turistikë, shërbimet e telekomunikacionit, ambienti artistik-kulturor etj.

Ndikimi i kontekstit shoqëror në zhvillimet e ekonomisë së vendit nuk është një dukuri e panjohur, përkundrazi, njihen një sërë veprash që konsiderohen njëherazi edhe si ekonomike ashtu dhe sociologjike. Ekonomia, si një çelës i zhvillimit dhe transformimit të shoqërisë, ka

qenë objekt studimi i shumë studiuesve madje shpesh e njëjta vepër është konsideruar edhe sociologjike, si shkencë e lidhur ngushtë me të, edhe ekonomike njëherazi. Jo kaq rastësisht shumë mendimtarë të mendimit sociologjik kanë qenë edhe ekonomistë të shquar (Veberi, Marksi, Pareto, Hume etj.).

Edhe pse vihet re një rritje e turizmit të vendit tonë, duhet thënë që kemi ende një rrugë të gjatë përpara. Shqipëria duhet të punojë në shumë drejtime për rritjen e përgjegjshmërisë ndaj vlerave të turizmit, trajnimet në këtë fushë, shtimin e bashkëpunimeve me kompanitë që operojnë në tregun ndërkombëtar, shtimin e publicitetit mbi atë që ofron turizmi në Shqipëri, konsolidimin e frymës së bashkëpunimit midis operatorëve turistikë, liberalizimin e tregut të agjencive ajrore etj.

Turizmi në Shqipëri përbëhet nga turistët vendas, bashkatdhetarët nga vendet fqinje, bashkatdhetarët e mërgimit, si dhe nga të huajt e vendeve kryesisht evropiane. Kështu të gjitha këto grupe shoqërore kanë kërkesa të veçanta në kryerjen e turizmit dhe duhet të trajtohen ndryshe. Madje edhe grupmosha të ndryshme turistësh kanë kërkesa dhe objektiva të veçanta të cilat duhet të merren në konsideratë nga biznesi turistik. Në ekonominë aktuale të tregut, kur çdo aktivitet privat ka tendencë të profilizohet gjithnjë e më tepër në aktivitetin e tij, duhet menduar edhe në turizëm për një profilizim të aktivitetit si rezultat i kërkesave specifike të turistëve të ndryshëm. Do të ishte e pamundur që, për shembull, një familje në Malësinë e mrekullueshme të Valbonës të mund të plotësonte kërkesat e një grupi turistësh të huaj të moshës së re, së bashku me një grup turistësh nga Tirana në një moshë të thyer, e kështu me radhë. Ndryshimet e mëdha midis kërkesave të tyre na bën të mendojmë se profilizimi i bizneseve të ndryshme për kategori grupmosha dhe subjekte të ndryshme do të ishte më efikas. Për këtë është e nevojshme që nën drejtën e rekomandimeve të specialistëve të fushës, të hartohen e të ndërmerren nisma të ulla që të shmangin dukuri të padëshiruara duke shtuar aktivitetin.

Nga ana tjetër, bizneset turistike duhet të krijojnë lidhje të vazhdueshme me operatorë të ndryshëm turistikë, jo vetëm për sigurimin e turistëve e kësajsoj të zhvillimit të biznesit të tyre, por edhe për të përvetësuar një kulturë të domosdoshme turistike. Shembulli i haneve të Valbonës të cilët janë instruktuar më së miri nga zonja Catherine Bohne, është një shembull i rëndësishëm së kulturës turistike në vendin tonë.

Në Shqipëri vitet e fundit janë bërë mjaft përpjekje për arritjen e kontakteve profesionale mes agjencive vendase të turizmit dhe atyre të huaja. Pjesëmarrja e vazhdueshme në panairt turistike në çdo vend ku ato zhvillohen, si Gjermani – Berlin, Itali – Milano, Tel Aviv – Izrael etj., është një shenjë e kuptimit të rëndësisë së koordinimit të operatorëve tanë turistikë me ata të huaj. Por pritshmëria e rezultateve është akoma shumë më e madhe se sa efekti që këto kontakte kanë arritur.

Tërheqja e turistëve të huaj do të ndikojë që Shqipëria të shfrytëzojë kapacitetet turistike për të garantuar një përfitim maksimal nga futja e valutës së huaj, dhe do të ndikojë në funksionimin e sektorit të turizmit në Shqipëri me të njëjtat parime, me të cilat funksionon industria e turizmit në botë.

Politika e çmimeve, si pjesë e rëndësishme e kulturës në biznesin turistik, mbetet një nga elementët më të ndjeshëm, nga njera anë në rritjen e numrit të turistëve në vendin tonë, nga ana tjetër e rritjes gjithashtu të të ardhurave nga ky aktivitet. Nëse kostoja e përgjithshme për një turist do të ishte më e madhe apo qoftë edhe e barabartë me koston e tij në bregdetin e Greqisë, për arsyen e propagandimit prej dekadash, traditën dhe emrin e mirë që ka fituar ky vend turistik, çdo turist do të preferonte që paratë e tij t'i shpenzonte në Greqi, por nëse çmimi do të ishte më i ulët, kurioziteti për të vizituar një vend pak të njohur, plazhet e virgjëra dhe mikpritja do të ishin arsye të forta për ta tërhequr çdo turist në vendin tonë.

Gjithashtu, publiciteti në industrinë turistike është akoma në hapat e para e madje edhe konceptet mbi të janë ende larg me atë që realizohet në vendet e zhvilluara turistike. Të investosh për publicitetin, në konceptin e shumë operatorëve tanë të turizmit do të thotë të harxhosh para, ndërkohë që duhet kuptuar se është një investim i cili do të japë frutet e tij menjëherë. Kështu, p.sh., promovimi i vlerave kulturore të vendit do të shërbente si një mënyrë më e mirë për njohjen edhe të potencialit turistik të Shqipërisë dhe zgjerimin e këtij aktiviteti.

Nga ana tjetër, praktika evropiane na mëson se turizmi është ngushtësisht i lidhur me artin dhe kulturën. Festalet, ekspozitat, koncertet apo aktivitetet e ndryshme artistike në vendet e zhvilluara turistike si Itali, Francë etj., realizohen në qendrat turistike dhe kryesisht në periudhat e sezoneve turistike. Në Shqipëri, megjithëse flitet mjaft për ngritjen e aktiviteteve artistike në qendrat turistike, kjo ide është reduktuar në ndonjë koncert spontan, me nivele pothuajse amatore apo në diskot e hapura në plazhe.

Një ndër faktorët e rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në vendin tonë është qëndrueshmëria në kohë e disa elementëve të lidhur ngushtë me të siç janë uniciteti i produkteve, cilësia e lartë e shërbimit në plotësim të nevojave të grupeve të synuar.

Dihet se ndryshimin e mundësojnë njerëzit, dhe këtu fjalën e kemi për punonjësit dhe sipërmarrësit. Ata janë burimi me anën e të cilëve përbushen kërkesat e turistëve.

Nëse sipërmarrësit janë trajnuar sipas kërkesave të kësaj industrie, edhe mënyra e tyre e të punuarit ju mundëson ngritjen e strukturave të posaçme, tërheqëse duke aftësuar personelin e punësuar në drejtim të shërbimeve që kanë në qendër dhe si qëllim përfundimtar, kënaqjen e kërkesave të turistëve. Natyra e bukur, traditat kulturore, gatimi tradicional, mund të shërbejnë si një burim i rëndësishëm me qëllim rritjen e interesit të turistëve si vendas ashtu edhe të huaj.

Pra, përvoja e vendeve të zhvilluara turistike na mëson se rritja e turizmit kërkon së pari kulturë dhe më pas kushte të përshtatshme për t'u zhvilluar. Në pikëpamje kulturore, mikpritja Shqiptare është një bazë e mirë nga e cila mund të zhvillohet turizmi individual apo familjar, por turisti nuk është më një mik, por një subjekt i cili kërkon përveç të tjerash pavarësinë dhe intimitetin e tij, apo atë që quhet "*privacy*", kërkon marrëdhënie brenda mentalitetit të tij, kërkon kushte në të cilat është mësuar të kalojë pushimet si dhe të zbulojë të reja natyrore, historike, artistike, kulturore, sportive etj., të cilat do të mbushin pushimet e tij aktive dhe do ta shndërronin atë kështu në një publicitet të gjallë për të ardhmen.

Në kushtet e një marketingu të ndërgjegjësuar dhe të përgjegjshëm, me burime njerëzore të cilësisë të lartë, nëpërmjet një plani krijues të produktit, një klimë biznesi me rregulla të qarta loje dhe me strukturë të qartë të përshtatshme për një qëndrueshmëri afatgjatë.

Në përfundim mund të konkludojmë se faktorët e rritjes së turizmit në vendin tonë janë të shumtë dhe të tillë që bashkëveprojnë me njëri-tjetrin. Vetëm harmonizimi i tyre mund të krijojë ekuilibra të favorshëm dhe rezultativ, ndërkohë që vlerësimi i caktuar vetëm në disa prej tyre nuk do të sillte asnjë rezultat pozitiv.

Turizmi shqiptar në përgjithësi po bën hapa të rëndësishëm përpara dhe nga një vend i pasigurtë dhe i panjohur për turizmin, po kthehet në një atraksion real i cili ka shumë gjasa të rritet me kalimin e kohës. Në këtë moment, theksi më i rëndësishëm i duhet vënë ngritjes së mëtejshme të kulturës së gjithë elementëve të industrisë së turizmit, si dhe lidhjes së tij me idetë më të avancuara të vendeve të zhvilluara.

**Harmonizimi i rregullativës ligjore në përputhje me trendët
bashkëkohore në Tregun Turistik**

Prof. Ass. Dr. Ibish MAZREKU

MSc. Orhan M. ÇEKU, PhD kandidat

K.U. "Pjetër Budi" Prishtinë

ibish.mazreku@hotmail.com

orhani1982@gmail.com

ABSTRAKT

Turizmi i Kosovës duhet pajtë me të jetë pjesë e integrimeve regjionale dhe globale dhe duhet të jetë një pjesë atraktive e ofertës turistike sidomos për turistët nga regjioni, nga Evropa, Amerika dhe vendet Aziatike. Integrimi i industrisë turistike të Kosovës në këto iniciativa dhe trende është interes jetik i zhvillimit të gjithëmbarshtëm ekonomik të vendit, faktor i rëndësishëm i rritjes së imazhit të vendit tonë në botë si dhe një faktor shumë i rëndësishëm për njohtë të reja.

Për të qenë pjesë e të gjitha këtyre zhvillimeve vendi ynë duhet pajtë: Të krijojë Strategjinë adekuate zhvillimore afatgjatë, Të adoptojë infrastrukturën adekuate ligjore e cila bazat e saj duhet t'i ketë ne parimet Evropiane të zhvillimit të turizmit gjegjësisht në Direktivat Evropiane. Të krijojë Autoritetin Kombëtar për Turizëm (AKT), Të imponojë dhe subvencionojë shkollimin akademik dhe profesional të kuadrove në fushën e menaxhimit të kapaciteteve turistike.

Fjalët kyçe : *Turizëm i qëndrueshëm, Strategjia e zhvillimit të Turizmit, Autoriteti i Kombëtar i Turizmit, Shkollimi i Kuadrove*

HYRJE

Ekonomia e Kosovës në tranzicion mundohet që të gjejë rrugën më të mirë të zhvillimit të saj ku ky zhvillim duhet të jetë në harmoni me trendët e zhvillimeve regjionale dhe atyre Evropiane. Këto trende e përcjellin edhe zhvillimin e hovshëm edhe të industrisë turistike sidomos në vendet e Bashkimit Evropian, ndërsa tek ne ky trend nuk është në rrugë të njëjtë të zhvillimit të saj. Prandaj orientimi i institucioneve shtetërore do të duhej të orientohet drejtë krijimit të infrastrukturës së nevojshme juridike dhe ekonomike që edhe ky sektor të ketë vendin e saj si pjesë përbërëse e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik.

Industria turistike mund të jetë një gjenerator shumë i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të vendit tonë, që të arrihet kjo në duhet që të kemi një koordinim më të mirë të të gjithë akterëve relevant të cilët mund të ndikojnë dhe ndihmojnë që kjo industri të ketë vendin e merituar në ofertën regjionale e më gjerë.

Orientimi i vendit tonë do të duhej të ishte në trend me zhvillimet evropiane të zhvillimit të turizmit pasi që vendi ynë pretendon që të jetë pjesë e BE-së. Shfrytëzimi i modaliteteve dhe strategjisë zhvillimore të turizmit evropian do të duhej të jetë themelimi i zhvillimit të strategjisë dhe vizionit të zhvillimit të industrisë turistike në Republikën e Kosovës.

Bashkimi Evropian viteve të fundit ka marrë disa hapa shumë të rëndësishëm se si do të duhej të zhvillohej turizmi në vendet e saj, ky zhvillim përcillet edhe me krijimin, adoptimin dhe përshatjen e infrastrukturës ligjore të nevojshme që ky trend të ketë sukses.

Strategjia afatgjate zhvillimore e Industrisë Turistike ne Republikën e Kosovës

Orientimi dhe zhvillimi adekuat i turizmit ne harmoni me interesat e shtetit te Kosovës dhe ne harmoni me planet strategjike zhvillimore te përgjithshme duhet dhe ka nevojë për një strategji te zhvillimit te turizmit ne nivel shteti jo sikur deri tani ku ky zhvillim është përqendruar ne nivele regionale brenda Kosovës sepse zhvillimi i ndarë nëpër regjione mund të ketë divergjencë dhe pengesa në zhvillimin e përgjithshme të turizmit. Rol të rëndësishëm për krijimin e kësaj strategjie duhet të kenë institucionet shtetërore, bota akademike e cila ka në vetvete programe të menaxhimit të turizmit si dhe të gjitha resurset turistike potenciale në Republikën e Kosovës.

Plani strategjik zhvillimor do të duhej që të përgatitej për periudha afatgjatë mbi dhjetëvjeçare ku në kuadër te kësaj strategjie do të duhej të bëhej SWOT analiza e cila pastaj do të vlerësonin kapacitetet aktuale, mundësitë zhvillimore, inkorporimi i industrisë turistike në ofertën turistike rajonale dhe atë evropiane, format dhe mënyrat e intervenimit të shtetit përmes formave të ndryshme subvencionuese, përshtatjes së infrastrukturës ligjore, krijimit të institucioneve adekuate shtetërore të cilat do të përcillnin, përkrahnin dhe zhvillonin industrinë turistike në drejtime të njëjta me trendët bashkëkohore të zhvillimit të turizmit.

Pavarësisht nga dilemat dhe problemet të cilat i shoqërojnë vendet në tranzicion, në veçanti ngeçjet në lëmin e ekonomisë, sot vlerësohet se turizmi dhe hoteleria janë veprimtari ekonomike sa interesante aq edhe fitimprurëse për subjektet e specializuara biznesore të cilat tërësinë e aktiviteteve të veta e kanë të bazuar në destinacione potenciale turistike¹.

Rëndësia ekonomike e këtyre veprimtarive jo vetëm që po reflekton efekte pozitive për buxhetin e individit, ndërmarrjeve dhe vendit ofrues por, ajo tani ka marr një dimension të ri, respektivisht vlerë të re, që ka të bëjë edhe me krijën e punësimit.²

¹ De Sci. Anand Krasnig, VËSHITËRËSITË E ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT POZITIV JURIDIK NË VEPRIMTARIËN E TURIZMIT DHE HOTELIERISË NË VENDET E EVROPËS JUGLINDORE - me theks të veçantë në Kosovë -

² Sipas Institutit Ekonomik të Zagrebit - Krceni fq. 79 (Ekonomski Institut Zagreb), i cili ka bërë një përkthim në anglisht të titullit të origjinalit në U.E. Përgj. e të autorit ekonomike (Prishtinë Evropë) Ushje - Očekivani ekonomski učinci) e publikuar në internet në web: <http://www.izg.hr>, e datës

Është i njohur fakti se ndryshimet e sistemeve ekonomike – shoqërore janë procese të vështira e të ndërlikuara të cilat kërkojnë dhe kanë kosto të pashmangshme e që kompensohen me përfitime që rrjedhin nga fitorja e rendit të ri.¹

Adoptimi i infrastrukturës ligjore të Republikës së Kosovës në harmoni me Direktivat Evropiane

Njëri nga qëllimet e Traktatit mbi funksionimin e Unionit Evropian është heqja e barrierave për funksionimin e tregut të brendshëm të UE-së. Në mënyrë që të arrihet kjo, Traktati parashih dy mënyra të ndryshme për heqjen e këtyre barrierave: së pari kemi ndalimin e masave shtetërore, që pengojnë lëvizjen e lirë brenda UE-së, dhe mundësia e dytë për heqjen e barrierave për lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve, personave dhe kapitalit (katër liritë themelore) është ajo përmes harmonizimit të legjislacionit në raste të caktuar². Vendet anëtare të UE-së si dhe vendet pretendente për anëtarësim në union obligohen që një pjesë të madhe të legjislacionit ta harmonizojnë me direktivat e UE-së sipas Traktatit mbi Funksionimin e Unionit Evropian. Përveç atyre masave legjislative të cilat janë të obligueshme për inkorporim në legjislacionin e vendit anëtar, për aspektet tjera legjislative shtete vendosin vet në bazë të sovranitetit të cilin e posedojnë por gjithherë këto akte normative nuk duhet të aplikohen në mënyrë të ndryshme apo diskriminuese ndaj mallrave, subjekteve ekonomike të vendeve tjera në raport me ato vendore. Për këtë arsye vendet potenciale për anëtarësim duhet në vazhdimësi të harmonizojnë legjislacionin me direktivat e UE-së, në mënyrë që të tregohet përkushtimi për anëtarësim në radhë të parë pastaj edhe të përmbushen obligimet kontraktuale me UE-në. Në kategorinë e harmonizimit të legjislacionit hynë edhe fusha e Turizmit dhe Hotelarisë. Në Republikën e Kosovës fusha e turizmit dhe hotelarisë rregullohet me Ligjin për Turizmin dhe Shërbimet Turistike Ligji Nr. 03/L-168, i cili në masë të madhe është i harmonizuar me direktivat e UE-së dhe i plotëson standardet evropiane. Për zbatimin e këtij ligji Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

20.07.2007, qartë konsistohet se turizmi është njëra ndër veprimtaritë ekonomike më dinamike në Republikën e Kosovës e cila në vlerë e fitimit ka shënuar një rritje relativisht domethënëse si për kalimtarët e turistëtve ashtu edhe faktor më rëndësorë pozitiv që ka pasur në GDP e këtijje vendi. Sipas kësaj publikimi prezantim i ndërtimit të këtijje vendi të UE ka ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike të turizmit.

¹ Dr. Hans I., Dr. Telo L., Traditicioni në Shqipëri: origjine dhe sfida, Akademia e Shkencave të Shqipërisë – Institut i Ekonomisë, Tiranë 2005, fq. 40

² Jelen Bytyqi: "Uryje në të Drejtë e Tregut të Brendshëm të Bankimit Evropian", Qendra Juridike e Kosovës, Prishtinë 2011, fq. 93-94

e Republikës së Kosovës ka aprovuar dy udhëzime administrative: Udhëzimi Administrativ Nr. 2010/17 për Klasifikimin dhe Kategorizimin e Objekteve Hoteliere si dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 2010/12 për Veprimtarinë e Agjencive Turistike. Ligji për Turizmin dhe udhëzimet administrative të përmendura sipas mendimit tonë nuk janë të mjaftueshme për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit,

Përveç përafimit të legjislacionit me deklaratat promovuar nga Organizata Botërore e Turizmit të cilat i referohen zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit⁵ duhet të realizohen edhe këto detyra⁶:

- ✓ Aktet ligjore nënligjore nga lëmi i turizmit dhe hotelerisë të rishikohen, plotësohen më mënyrë që në këtë fazë të jenë profesionale, reale dhe fleksibile në mënyrë që t'u përshtaten rrethanave vendore,
- ✓ Që turizmi dhe hoteleria, edhe pse kanë ngjashmëri dhe i shërbejnë të njëjtit mision, për interes të cilësisë, duhet rregullohen me ligje të veçanta e assesi siç janë tani kur këto të dyja janë të rregulluara vetëm me një Ligj;
- ✓ Mungesa e ligjeve sistemore, të cilat veçanërisht do të rregullonin turizmin dhe hotelerinë, të rregullohet me nxjerrje të ligjeve të tjera të cilat do të garantonin një fazë tranzicioni të suksesshëm e që të cilat pas një periudhë kohore do të zëvendësoheshin me ato të UE – së;
- ✓ Nga instancat e caktuara profesionale, shoqatat profesionale dhe grupe të interesit të identifikohen, sistemohen, kodifikohen dhe publikohen uzansat që i përkasin vendit dhe prioritetet t'u epet atyre të cilat janë kompatible me standardet e larta të vendeve të UE – së;
- ✓ Që në grupe parlamentare të futën edhe anëtarë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit të cilët përfaqësojnë interesin e biznesit dhe qytetarëve në mënyrë që aktet e caktuara ligjore për turizmin e qëndrueshëm të jenë të zbatueshme në terren;
- ✓ Aktet e caktuara ligjore, nënligjore, uzansat, kontratat ndërkombëtare të mos jenë bllokuese për biznesin vendas vetëm pse janë në përputhje me aktet, standardet dhe kontratat e UE – së, përkundrazi;

⁵ Deklarata e Manriës për turizmin botëror me 1980; Deklarata e Akapahüks për të drejtën në pushim vjetor me 1982; E drejta turistike dhe kodi turistik, Sofje 1985; Deklarata e Hagës për turizmin me 1990; Karta për turizmin e qëndrueshëm në Lanzarote me 1995 (e bashkuar me UNEP, UNESCO dhe BEI); Deklarata e Berlinit për turizmin e qëndrueshëm në mars të vitit 1997; Karta për turizmin e qëndrueshëm; Kodi i përgjithshëm citik për turizmin me 1999; Deklarata nga Harina – Turizmi i qëndrueshëm në shtet e azisë dhe pacifikut 2002; Deklarata për dotarizimin nga Kvebeku 2002; Deklarata mbi turizmin dhe ndryshimet klimatike

⁶ Dr.sc. Armand Krasniqi, prof. Ass. NEVOJA E KRIZIMIT TË BAZA LEGJISLATIVE PËR TURIZEM TË QËNDRUESHËM NË KOSOVË

- ✓ Që Qeveria e Kosovës respektivisht Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë në themelohë Zyrën Turistike të Kosovës e cila do të luaj rol in që i takon në kuadër të bashkëpunimit dhe zhvillimit nacional, ndërkombëtar dhe promovimin e konceptit për zhvillimin e qëndrueshëm;⁷
- ✓ Të stimulohen dhe inkurajohen Organizatat Joqeveritare që krijojnë dhe zbatojnë projekte për edukimin, vetëdijesimin dhe arsimimin e subjekteve biznesore dhe qytetarëve për turizëm të qëndrueshëm në bazë të Agjendës 2010;
- ✓ Të shikohen mundësitë nxjerrjes dhe zbatimit të lehtësirave tatimore për subjektet të cilat janë të suksesshme për format e turizmit të qëndrueshëm, në veçanti të respektohen, stimulohen dhe ndihmohen ato subjekte të cilat janë të orientuara në zhvillimin e kapaciteteve eko – turistike;
- ✓ Në veçanti nuk do të ishte fare gabim sikurse të formohen një trup miks ndërqeveritar TASK FORC i cili me përgjegjësi dhe autoritet do të kontribuonte në zbatimin e strategjive zhvillimore dhe mënjanimin e vështirësive në zbatimin e legjislacionit.

Institucionet relevante do të duhej të formonin një grup pune apo Autoritet i cili do të në kuadër të aktiviteteve të tij do të duhej të :

- Shpallte aktivitetin apo aksionin “Ditët Kosovare të Turizmit” ku në këtë aktivitet do të duhej të përfshiheshin të gjithë akterët relevant të kësaj industrie.
- Puna e këtij organi do të duhej të bazohej në këto principe⁸:
 - Të ketë qasje Holistike dhe te integruar
 - Të planifikojë në afatgjatë
 - Të arrijë ritmin e duhur të zhvillimit.
 - Të involvojë të gjithë akterët
 - Të shfrytëzojë të gjitha njohuritë e mundshme
 - Të minimizojë dhe menaxhojë rreziqet
 - Të reflektojë mbi impaktet dhe koston

⁷ Vlerëtojmë se themelimi i Organizatës Turistike të Kosovës nga ana e Qeverisë së Kosovës – Ministrisë për Tregti dhe Industri është një hap i rëndësishëm në rrugën e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe promovimit të turizmit të qëndrueshëm në Kosovë. Përveç kësaj kjo organizatë në bazë profesionale do të arrijë që në planin ndërkombëtar të kryejë në një mënyrë të cekta me organizatat shtetërore, do të bashkëpunojë me Organizatën Botërore të Turizmit dhe do të krijojë kualitet për shfaqjen e identitetit të lirisë.

⁸ Prof. Cristina Novatecchio, European Sustainable Tourism, Content, concepts and Guidelines for action, Brussels 2007

- Të krijojë limite adekuate
- Të ndërmerr monitorime kontinuele

Formimi i Grupit apo Autoritetit

BE për të realizuar vizionin e saj ka krijuar disa grupe pune ku secili grup ka detyrat dhe përgjegjësitë e saj dhe atë si ne vijim :

- Grupi A – i cili është i ngarkuar të punojë në lidhje me sigurimin e informacioneve të nevojshme dhe teknologjive adekuate
- Grupi B – është i ngarkuar të menaxhojë dhe krijojë programe mbi aftësimin e resurseve njerëzore në harmoni me strategjinë e tyre për Turizëm të qëndrueshëm.
- Grupi C – punon në lidhje me krijimin dhe zhvillimin e produkteve Turistike në harmoni me strategjinë për zhvillim të qëndrueshëm të Turizmit.
- Grupi D – punon në lidhje me mbrojtjen e mjedisit e cila duhet të jetë në harmoni me Strategjinë për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, dhe tani vonë është krijuar edhe
- Grupi E – i cili kryesisht merret me impaktin e teknologjive të reja në industrinë turistike.

Autoriteti adekuat do të mund të imitonte dhe të punonte në këto parime sikur të BE-se pasi që edhe ne jemi pretendent për të qenë një ditë vend i integruar në kuadër të BE-se.

Shkollimi dhe profesionalizimi i kadrove në Menaxhimin bashkëkohor të kapaciteteve turistike në Republikën e Kosovës

Hap tjetër shumë i rëndësishëm është edhe përshtatja e programeve edukative në të gjitha nivelet si ato profesionale dhe akademike në harmoni me nevojat e industrisë si dhe në harmoni me strategjinë e përgjithshme zhvillimore. Rol të rëndësishëm në përkrahje, edukim dhe shkollim të kuadrit të nevojshëm, adekuat do të luajnë të gjitha institucionet të cilat në vetvete kanë programe të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e turizmit. Nëse programet aktuale nuk janë adekuate apo të përshtatshme me trendët atëherë këto insitucione do të duhej të përshtatnin, adoptonin programet e tyre në harmoni me strategjinë dhe trendët bashkëkohore të turizmit në

vendin tone ashtu edhe trendëve që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në rajon dhe me gjere.

Përfundimi

Nga të gjithë aktorët që merren shkencërisht dhe profesionalisht me turizmin, bazuar edhe nga të dhënetë të cilat i ofrojnë vendet e caktuara dhe Organizata Botërore e Turizmit, akordohen që turizmi dhe hoteleria janë veprimtari ekonomike specifike, dinamike dhe heterogjene të cilat bizneseve dhe buxhetit të vendeve të cilat e kultivojnë u siguron të hyra domethënëse. Kjo për shkak se turizmi është i përshtatshëm që t'i adaptohet secilës veprimtari shoqërore dhe të shndërrojë atë në veprimtari biznesi turistik. Që përfitimet nga këto veprimtari të jenë optimale është e domosdoshme vendet e caktuara janë të detyruara të nxjerrin legjislacionin i cili në instancë të fundit duhet të jetë garant i zhvillimit në bazë të ekonomisë së tregut. Megjithatë, jo të gjitha vendet kanë mundësi që t'i realizojnë synimet e parashtruara. Procesi i integrimi në Evropë ballafaqohet edhe disa vende të cilat karakterizohen me zhvillim me të dobët ekonomik. Kjo rrethanë institucionet kompetente të vendeve i ka qitur para një sprove e cila jo rrallë është duke u shndërruar në pengesë serioze të zhvillimit ekonomik. Mungesa e një strategjie reale e racionale e cila do të kishte për qëllim që t'u jepte zgjedhje dëshirës për integrim dhe mungesa e kapaciteteve për këtë synim është problemi më serioz. Po ashtu veprimet e vendeve që ta modernizojnë dhe harmonizojnë legjislacionin e vet me atë të UE – së pa u mbështetur në kapacitetet dhe burimet vetanake subjektive dhe objektive është treguar si gabim pasi që ky legjislacion as që mund të implementohet në vend. Më qëllim të zvogëlimit dhe mënjanimi të këtyre defekteve kërkohet marrja e një seri masash në mënyrë që procesi i integrimi të jenë proces i ndarë në faza si në planin nacional ashtu edhe rajonal. Pra, zhvillimi i veprimtarive hoteliere dhe turistike kërkon qasje shumë disiplinore me pjesëmarrje të gjerë të aktorëve të cilët kanë aftësi profesionale dhe dëshirë që t'i përkushtohen zhvillimit të këtyre lëmenjve. Për plotësimin e kuadrit ligjor dhe institucional në Republikën e Kosovës me qëllim të zhvillimit të turizmit në rekomandojmë këta hapa për institucionet relevante:

- Legjislacioni vendor në fushën e turizmit në Republikën e Kosovës duhet të Harmonizohet plotësisht me Direktivën e Këshillit të Unionit Evropian Nr.

95/57EC, e 23 nëntorit 1995 "Mbi mbledhjen dhe raportimin e informacionit statistikor në fushën e turizmit" dhe Direktiva e Këshillit 90/314 EEC e 13 qershorit 1990 "Mbi paketën e udhëtimeve, pushimeve dhe të tureve";

- Fusha e Turizmit dhe Hotelerisë duhet të mbulohet nga Ministria e Turizmit si e veçantë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë departamenti i Turizmit të kalojë dhe të Bashkohet me Kulturën dhe rininë;
- Krijimi i Agjencionit kombëtar për Turizëm është nevojë imediate;
- Të punohet në Promovimin e Trashëgimisë Kulturore, kur dihet se vendi ynë ka një të kaluar historike interesante dhe atraktive për vizitorë;
- Investimi në qendrat e rëndësishme të turizmit në Kosovë apo destinacionet kryesore të turizmit si Bjeshkët e Rugovës, Ujëvara e Mirushës, Prevalla, Bjeshkët e Nemuna, Shpella e Gadimes, etj. Modaliteti i Investimeve të përfshijë aktorët e ndryshëm për investime si në formë të partneritetit publiko – privat, ku dihet se këtë formë të investimeve edhe legjislati i ynë e lejon.
- Hartimi i Guidës Turistike të Kosovës dhe promovimi i saj në mediat e njohura ndërkombëtare, etj.

Referencat :

1. Prof. Cosimo Notastefano, European Sustainable Tourism, Context, concepts and Guidelines for action, Brussels 2007.
2. Dr. Hana L, Dr. Telo L, Tranzicioni në Shqipëri: arritje dhe sfida, Akademia e Shkencave të Shqipërisë – Instituti i Ekonomisë, Tiranë 2005;
3. Dr.sc. Armand Krasniqi, prof. Ass, Nevoja e Krijimit të Bazës Legjislative për Turizëm të Qëndrueshëm në Kosovë
4. Deklarata e Manilës për turizmin botëror me 1980; Deklarata e Akapulukës për të drejtën në pushim vjetor me 1982; E drejta turistike dhe kodi turistik, Sofje 1985; Deklarata e Hagës për turizmin me 1989; Karta për turizmin e qëndrueshëm në Lanzarota me 1995 (së bashku me UNEP, UNESCO dhe BE); Deklarata e Berlinit për turizmin e qëndrueshëm në mars të vitit 1997; Karta për turizmin e qëndrueshëm; Kodi i përgjithshëm etik për turizmin me 1999; Deklarata nga Hainana – Turizmi i qëndrueshëm në vëste e azisë dhe pacifikut 2002; Deklarata për ekoturizmin nga Kvebeku 2002; Deklarata mbi turizmin dhe ndryshimet klimatike;

5. Dr.Sci. Armand Krasniqi, Veshitresite e zbatimit te Legjislacionit pozitiv Juridik ne veprimtarine e turizmit dhe hotelierise ne vendet e Evropes Juglindore - me theks te veçantë në Kosovë;
6. Jeton Bytyqi, "Hyrje në të Drejtën e Tregut të Brendshëm të Bashkimit Evropian", Qendra Juridike e Kosovës, Prishtinë 2011.

INFRASTRUKTURA TURISTIKE NË KOSOVË

Agim Derguti, PhD kandidate, Ferizaj, Kosovë

Abstrakti

Turizmi përfshin të gjitha aktivitetet e personave që udhëtojnë për të qëndruar në vendet e preferuara të tyre. Në këto aktivitete ndërvepron oferta dhe kërkesa për mallra dhe shërbime, prandaj institucionet të cilat ofrojnë shërbime të tilla konsiderohen si pjesë e industrisë turistike. Disa sektorë të infrastrukturës si telekomunikacioni, aeroportet, hekurudhat, rrugët, furnizimi me rryme, sistemi i menaxhimit të mbeturinave, sistemi i kanalizimit, furnizimi me ujë, restaurantet, objektet përcjellëse rekreative, ambientet tregtare etj. janë të përfshira në këtë kategori. Planifikimi për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit përfshin gjithë sistemin e integruar të infrastrukturës bazë së bashku me të gjitha objektet e turizmit në një mënyrë të ekuilibruar. Ky sistem i integruar në Kosovë lë shumë për të dëshiruar.

Fjalët kyç: Turizmi, infrastruktura, menaxhimi, shërbimet.

Hyrje

Turizmi është veprimtaria ekonomike gjeneruar nga vizitorët që udhëtojnë për dhe qëndrojnë në vende jashtë mjedisit të tyre të zakonshëm për kohën e lirë, biznes, shërim, gara sportive dhe për qëllime të tjera. Turizmi ka domethënie të madhe dhe konsiderohet si një element thelbësor për qëndrueshmërinë dhe rritjen ekonomike të vendit. Turizmi lufton papunësinë, sidomos në kushte afatgjata, krijon punë jo vetëm në qytetet e mëdha e të vogla, por edhe në fshatra të largëta, në zona të thella ku zakonisht zhvillimi s'është shumë i reklamuar. Kosova ka një listë të gjatë gjërash për të bërë për të fituar një turizëm të mirë: ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës, rrugëve, sistemi i komunikimit, sistemi i tubacioneve, mbrojtja e mjedisit, ndërgjegjësimi i arenës botërore për Kosovën dhe e fundit do të ishte përmirësimi i krahut të punës në aspektin e shërbimeve.

Infrastruktura turistike

Infrastruktura turistike si element bazë për industrinë e turizmit përbëhet nga: telekomunikacioni, aeroportet, hekurudhat, rrugët, sistemi i furnizimit me rrymë, sistemi i menaxhimit të mbeturinave, sistemi i kanalizimit, sistemi i furnizimit me ujë, restaurantet, objektet përcjellëse rekreative, ambientet tregtare etj. Në Kosovë në përgjithësi nuk ka pasur përkushtim të mjaftueshëm në çështjen e infrastrukturës turistike, kështu që investimet kanë qenë simbolike në këtë drejtim. Në Kosovë sektori i turizmit vazhdon të injorohet nga institucionet e vendit do të thotë mungon trajtimi institucional i këtij sektori të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit. Kosovës i mungon një strategji e mirëfilltë e turizmit ku fokusi i kësaj strategjie do të ishte kompletimi i infrastrukturës ligjore turistike, hartimi i politikave për kompletimin e ofertave turistike të Kosovës, lehtësimi i investimeve në turizëm, zhvillimin e marketing promocionit turistik dhe mbështetja e resurseve humane në sektorin e turizmit. Ndjehet nevoja e hartimit të strategjisë lokale të zhvillimit të turizmit në secilën komunë në veçanti dhe pastaj këto plane të jenë pjesë integrale e strategjisë së përgjithshme të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Kosovës përkatësisht departamentit për turizëm dhe hoteleri. Ndjehet nevoja edhe për formimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit e cila do të merrej ekskluzivisht me çështjet e turizmit dhe do të ishte hartues i politikave zhvillimore turistike në nivel vendi që synim do të kishte rritjen e cilësisë së ofertës turistike në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Duhet pasur parasysh që gjithnjë e më shumë turizmi po shndërrohet në furnizuesin kryesor të ekonomisë me të ardhura. Kosova ka shumë zona

dhe vende të cilat vizitohen nga vendasit dhe të huajt. Vendet më të frekuentuara janë: Prekazi, Çarshia e Gjakovës, Manastiri i Deçanit, Manastiri i Graçanicës dhe Patriarshia e Pejës, Teqeja e Bektashinjve, Xhamia e Sinan Pashës, Xhamia e Hadumit, Xhamia e Madhe në Prishtinë, muzeu në Prishtinë, Gazimestani dhe Tyrbja e Sulltan Muratit, Novobërda, Kisha e Letnicës, etj. Atraksionet më të vizituara janë: Gryka e Rugovës, Parku i Gërmisë, Lugina e Zhupës, Brezovica, Shpella e Memmertë e Gadimes, etj. Të gjitha këto vende gjenden në 10 908 km² të hapësirës së Kosovës që në vete ngërthen një rrjet të tërë rrugësh automobilistike e hekurudhore, rrjete të sistemeve të tubacioneve, rrjete telefonike etj., të cilat i përkasin infrastrukturës turistike e që duhet të jenë në nivel të kënaqshëm për një zhvillim turistik të qëndrueshëm.

Infrastruktura rrugore

Mungesa e infrastrukturës rrugore në zonat turistike bëhet pengesë kryesore e zhvillimit të turizmit. Në Kosovë viteve të fundit është investuar në përmirësimin e gjendjes së rrugëve ekzistuese por edhe ndërtimin e rrugëve të reja. Ky zhvillim i hovshëm i ndërtimit të rrugëve ka pasur ndikim edhe në sferën e zhvillimit të turizmit. Megjithatë mbetet ende shumë për të dëshiruar, duke pasur parasysh se zonat rurale shumë pak janë të prekura nga investimet në infrastrukturën rrugore. Përkundër përparimeve të dukshme, shqetësuese është niveli i ndërtimit të rrugëve si në aspektin e projektimit po ashtu edhe të kualitetit. Rrugët nuk plotësojnë kushtet për një zhvillim të sigurt të komunikacionit sepse nuk plotësojnë kushtin e përmasave gjeometrike, janë të rrezikshme për qarkullim për shkak të mungesës së sinjalizimeve vertikale dhe horizontale, mungesës së ndriçimit, mungesës së vend parkingjeve, dëmtimeve që lindin për shkak të kualitetit të dobët të punimeve, mirëmbajtja jo e mjaftueshme etj. Mbetet barrë e Komunave dhe Ministrisë së Infrastrukturës që të angazhohen për sanimin e rrugëve ekzistuese dhe ndërtimin e rrugëve të reja me një kualitetit të duhur duke respektuar rregullat dhe standardet në fuqi. Joshja e turistëve ndërkombëtarë nuk mund të bëhet me peizazhin e rrugëve të Kosovës të cilat janë shumë të pasigurta për qarkullim sidomos gjatë të reshurave atmosferike dhe gjatë orëve të mbrëmjes. Jetëgjatësia e rrugëve luan rol të konsiderueshëm në tërheqjen e vizitorëve sepse në mënyrë direkte ndikon në shpenzimet e udhëtimit, sigurinë e njetit transportues dhe sigurinë personale. Ndërtimi i Autostradës Morinë-Merdare shpresoj t'i përmbush kriteret dhe standardet ndërkombëtare dhe kështu Kosova të ketë një rrugë e cila do të ketë rol të madh në nivelin lokal, rajonal e kombëtarë e cila padyshim do të jetë një arterie lidhëse e Kosovës me regionin e cila do të ketë impakt edhe në zhvillimin e turizmit.

Sistemet e furnizimit me ujë

Një nga kërkesat më të rëndësishme për zhvillimin e objekteve turistike është furnizimi adekuat dhe i vazhdueshëm i ujit të sigurt për pije, përdorim shtëpiak dhe rekreativitet. Nevojat e ujit janë të ndryshme dhe çdo herë janë në rritje. Furnizimi me ujë në zonat ku zhvillohet turizmi përfshinë kërkesat për qëllime shtëpiake, hotele e restorante, pishina, pastrim të rrugëve, ujtje, shërbime të zjarrfikëse etj. Duke konsideruar kërkesat e mëdha për furnizimin me ujë për kryerjen e të gjitha këtyre shërbimeve, vlerësimi i kapacitetit të sistemeve është paqartë i nevojshëm. Në Kosovë rrjeti i sistemit të ujësjellësit kryesisht është i shtrirë në zonat urbane, ndërsa zonat rurale shumë pak janë të përfshira në këtë rrjet. Në shumë qytete të Kosovës rrjeti i ujësjellësit është i vjetërsuar dhe gypat nuk i plotësojnë kushtet sipas standardeve të cilat aplikohen në ditët e sotme. Në vendet rurale, sistemi i ujësjellësit mirëmbahet me vështirësi pasi që në këto vende për shkak të konfiguracionit të terrenit, rrjeti është shumë i shpërndarë me çka kërkon angazhim të një numri të madh të punëtorëve në mirëmbajtje për shkak të defekteve që paraqiten në rrjetin e ujësjellësit. Prandaj kërkohen një angazhim maksimal në hartimin e një plani për përfshirjen në rrjetin e ujësjellësit të gjitha vendet rurale, në rend të parë për banorët rezident e pastaj të njëjtat burime do të shfrytëzohin edhe vizitorët. Kërkohet që në vendet e larta turistike të shfrytëzohen burimet

natyrore të ujit, të bëhet grumbullimi në rezervuare dhe të bëhet shpërndarja në rrjet. Vëndndodhja e rezervuarëve patjetër duhet të përfshihet në planin e integruar të infrastrukturës.

Sistemi i menaxhimit të ujërave të zeza

Kosova ka trashëguar nga e kaluar një sistem të dobët të rrjetit të kanalizimit i cili është jofunksional dhe tërësisht i konsumuar. Rrjeti i ndërtuar shumë vite më parë nuk plotëson kushtet teknike sepse është i ndërtuar me gypa të llojeve të ndryshme të materialeve të cilat nuk përdoren në ditët e sotme. Rrjetet e sistemit të kanalizimit në qytetet e Kosovës pothuajse nuk janë funksional për shkak të lëvizjeve të mëdha të popullatës nga fshati në qytet, janë ndërtuar shumë objekte, kështu që prurjet në sistem janë të papërbalueshme për shkak të kapaciteteve të gypave ekzistues. Investimet e hovshme në rrjetin e kanalizimit si në zonën urbane po ashtu edhe atë rurale, kanë filluar në mileniumin e ri. Megjithatë problematike në menaxhimin e ujërave fekale është përfshirja jo e mjaftueshme e ujërave të zeza në rrjetin e kanalizimit dhe derdhja e tyre pa trajtim adekuat në lumenj. Synimi kryesor i autoriteteve përgjegjëse duhet të jetë përfshirja e gjithë vendit në rrjetin e kanalizimit, duke ndërtuar infrastrukturën e trajtimit të ujërave të zeza duke përbushur kështu kriterin elementar të mbrojtjes së lumenjve dhe ambientit nga ndotja.

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave dhe deponimit

Spektori i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë menaxhohet nga organet e qeverisjes qendrore dhe Lokale. Kompania për Menaxhimin e Deponive (KMD) është përgjegjëse për menaxhimin e pajisjeve për hedhjen përfundimtare të mbeturinave në Kosovë. Pajisjet për hedhjen përfundimtare të mbeturinave përfshijnë deponitë e mbeturinave dhe stacionet e transferimit. Momentalisht katër deponi të mbeturinave janë nën menaxhimin e KMD-së (Prizren, Gjilan, Prishtina dhe Podujeva) dhe një stacion transferimi (Ferizaj). Spektori i menaxhimit të mbeturinave është i rregulluar aktualisht nga Zyra e Rregullatorit të Ujit dhe Mbeturinave dhe Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Shqetësuese është fakti se përgjithësisht ekziston një nivel i ulët i kënaqësisë në Kosovë sa i përket efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave nga të gjitha kompanitë. Asgjësimi i llojeve të ndryshme të mbeturinave është një çështje tjetër e shqetësimit, duke qenë se asgjësimi i mbeturinave të lëngshme dhe mbeturinave të ngurta luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e shëndetit të turistëve dhe të komunitetit rezident. Destinacionet turistike mund të mbajnë atraktivitetin nëse mjedisi është i pastër i këndshëm dhe pa ndotje. Prania e mbeturinave në ambientet turistike, ndikon në reduktimin e vizitave turistike, përveç kësaj do të ketë degradim mjedisor i cili do të jetë i papranueshëm edhe për komunitetet lokale. Objektivat kryesore të të gjitha sistemeve të deponimit të mbeturinave duhet të kenë synim eliminimin e rreziqeve shëndetësore dhe mbrojtjen e mjedisit. Problem në vete paraqesin mbeturinat si: vajrat e përdorura, bateritë, akumulatorët, mbeturinat spitalore, barnat e skaduara, mbeturinat e gomës dhe plastikës, pesticidet e skaduara etj. Në Kosovë ende nuk funksionon në formën e duhur sistemi i grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave. Akoma nuk bëhet selektimi i mbeturinave sipas llojit të materialit ku pastaj do të bëhet riciklimi i tyre.

Energjia

Furnizimi adekuat dhe i besueshëm me rrymë është thelbësor për një shoqëri moderne sepse pa energji nuk do të ketë zhvillim industrial, nuk funksionojnë shkollat, nuk ka trajtim adekuat për të sëmurët në spitale, rrugët janë të errëta etj. Kjo gjendje në Kosovë është pasojë e viteve të neglizhencës, politikave të dështuara ekonomike, sanksioneve dhe konfliktit që sollën sektorin energjetik në prag të kolapsit. Sistemet ekzistuese të prodhimit dhe të furnizimit me energji elektrike janë në këtë gjendje si pasojë e mungesës shumëvjeçare të investimeve dhe ato nuk mund të përbushin kërkesat e tanishme ose ato që priten në të ardhmen. Që nga përfundimi i luftës Kosova ka investuar miliona euro në sistemin energjetik, investime të cilat kanë ndihmuar në

eliminimin e deficitit të madh energjetik që ka ekzistuar në Kosovë, por nuk kanë arritur të ndihmojnë në stabilizimin e gjendjes energjetike. Janë analizuar dhe studiuar shumë alternativa nga ekspert vendor dhe ndërkombëtarë për të dal nga kriza energjetike por ende pa rezultate. Një gjendje e tillë e sistemit energjetik padyshim do të ndikoj negativisht në joshjen e turistëve të huaj. Vizitorët ndërkombëtarë duan standardin e shërbimeve të nivelit që kanë në vendet e tyre, prandaj i rëndësishëm është plotësimi i kërkesave dhe ofrimi i shërbimeve të kënaqshme. Për çdo objekt turistik sistemet publike duhet të jenë të dizajnuara në mënyrë që të përmbushin kërkesat e zhvillimit të turizmit si:

- Furnizimi me ajër të kondicionuar i cili ka funksion lidhës me sistemin energjetik;
- Pishinat - sistemet e qarkullimit të ujit përmes pompave;
- Ashensorët, përgatitja e ushqimit, televizioni, radio, diskotekat dhe shërbimet tjera.

Në Kosovë sistemi energjetik nuk i plotëson kushtet në aspektin e përmbushjes së kërkesave për shërbimet e nevojshme në kuadër të turizmit për shumë arsye:

- Ndërprerja e shpeshtë e furnizimit me energji elektrike
- Në vendet rurale rrjeti i shpërndarjes është i dobët dhe jofunksional
- Fuqia elektrike jo stabile
- Menaxhimi i dobët në sistemin e pagesave etj

Posta dhe telekomunikacioni

Qasja e shërbimeve të postës dhe telekomunikacionit është vendimtare, sidomos në pikëpamje të madhësisë së rajonit. Besueshmëria e komunikimeve ka një rol të veçantë të të gjithë qytetarët sidomos të komuniteti i biznesit. Sistemi i shërbimeve në infrastrukturën e postës dhe telekomunikacionit përfshin shërbimet postare, telefonat, telefax etj. Planet e infrastrukturës për këtë grup të shërbimeve kanë nevojë për të identifikuar rrugët e shkëmbimit të transmetimit, sistemet e antenës etj. Kjo përbën fushën e infrastrukturës që është e ndjeshme ndaj ndryshimeve të shpejta teknologjike, çka do të thotë se progresi në fushën e teknologjisë kërkon afërsi të reja në menaxhim dhe operim. Kosova ka trashëguar një sistem të vjetër të teknologjisë që i përkasin shërbimeve të postës dhe telekomunikacionit. Në Kosovë momentalisht operon një numër i madh i operatorëve të telefonisë mobile, mirëpo shumë operator janë ilegal dhe përveç që janë të jashtëligjshëm krijojnë edhe pengesa në sistemet e transmetimit tek operatorët legal. Të gjithë operatorët kanë një të metë të përbashkët sa i përket afrimit të shërbimeve në vendet e larta malore pikërisht për shkak të mungesës së infrastrukturës së nevojshme, përkatësisht sistemeve të antenave dhe transmetuesve. Shërbimet e telefonisë fikse dhe mobile ende nuk janë në nivelin e kënaqshëm. Telefonja mobile ende nuk ka kapacitete teknike për të mbuluar mbingarkesën në rastet e festave me çka ndikon në cilësinë e shërbimit.

Objektet turistike dhe shërbimet

Përveç ofrimit të infrastrukturës publike, sukcesi i çdo destinacioni turistik është i varur në një shkallë të madhe mbi natyrën e objekteve dhe shërbimeve që janë në dispozicion për vendet turistike. Në Kosovë janë bërë shumë investime në ndërtimin e objekteve turistike që kryesisht i përkasin sektorit privat. Llojet e reja të akomodimit, të tilla si vetë-hotelierike, kanë evoluar për të përmbushur kërkesat e tregut në fushën e turizmit. Ndryshime të dukshme kanë ndodhur në vitet e fundit në preferencat e turistëve ndërkombëtarë dhe vendor në lidhje me objektet e restoranteve të formës së vjetër ku servohen ushqime tradicionale. Në Kosovë ka shumë restorante të tilla që bazohen në kuzhinë vendore dhe përdoren produkte vendore. Në Kosovë ekziston një ligj, qëllimi i të cilit është zbatimi i standardeve të shërbimeve turistike dhe shërbimet tjera që lidhen me turizmin. Ekziston edhe ligji i ndërtimit, mirëpo shumë pak respektohet dhe ndërtimet nisnin e përfundojnë pa respektuar kriteret e caktuara në këtë ligj. Kjo dukuri është më e theksuar në zonat rurale të Kosovës.

Mjedisi

Ruajtja e një mjedisi të pastër është e domosdoshme. Në përgjithësi, shkalla e pastërtisë së mjedisit, shkalla në të cilën mjedisi (veçanërisht uji dhe ajri) është pa ndotje, dhe shkalla në të cilën mjedisit në pikëpamje estetike është i këndshëm ndikon në tërheqjen e një destinacioni turistik. Nëse objektet adekuate dhe infrastruktura nuk mund të përballojnë produktet e mbeturinave të ngurta dhe të lëngëta, dhe nëse mekanizmat e kontrollit janë joadekuate, pritjet e vizitorëve ndërkombëtarë nuk do përmbushen. Rrjedhimisht përfitimet turistike potenciale dhe të pritshme ekonomike do të reduktohen. Kështu që ndotja e mjedisit jo vetëm që ul përfitimin ekonomik nga turizmi (nëpërmjet humbjes së atraktivitetit dhe reduktimi i numrit të vizitorëve), por cilësia e mjedisit do të ketë rënie për të gjithë përdoruesit, duke përfshirë edhe komunitetet lokale. Në Kosovë edhe pse ka shumë pak industri të zhvilluar, ndotësit më të madh janë pikërisht ato pak fabrika që funksionojnë sepse nuk i plotësojnë kushtet minimale teknike të funksionimit të sistemit të mbrojtjes së ambientit për faktin se mbetjet e lëngshme të fabrikës i derdhin në lumenj, pastaj nuk funksionojnë filtrat e pastrimit të ajrit në tymtarët fabrikave etj.

Shërbimet mjekësore

Kosova ende nuk ka arritur ta ndërtojë një sistem shëndetësor adekuat dhe të aftë për t'iu përgjigjur sfidave dhe obligimeve. Shëndetësia në Kosovë është degraduar në shkallë të madhe si pasojë e joprofesionalizmit, menaxhimit jo të mirë dhe konfliktit të interesave. Renovimet e objekteve shëndetësore të bëra çdo vit si dhe ndërtimi i shumë objekteve të reja shëndetësore nuk kanë ndikuar në masën e duhur në krijimin hapësirave të mjaftueshme për objektet shëndetësore sipas standardeve. Sistemi shëndetësor përfshinë të gjitha aktivitetet që kryhen në objektet shëndetësore në funksion të kujdesit për qytetarët. Në kuadër të këtij sistemi funksionojnë qendrat e mjekësisë familjare, spitalet dhe qendrat emergjente. Në Kosovë, ka shumë qendra spitalore, qendra emergjente dhe qendra të mjekësisë familjare kështu që niveli i shtrirjes së objekteve shëndetësore mund të konsiderohet i kënaqshëm. Shqetësuese është niveli i shërbimeve mjekësore si pasojë e mungesës së barnave dhe mos angazhimi i duhur i stafit mjekësor në kryerjen e detyrave që i takojnë.

Referencat

- Adams D. (1994): *Urban Planning and the Development Process*, Routledge: London and New York
Demneri, F. (2004) – Menaxhimi & Ndryshimi - Menaxhimi dhe Evoluimi i tij , ITAPI , Tiranë.
Ekolevizja (2009): Analiza cilësore e Vlerësimit të ndikimit në mjedis të TEC-it të Porto Romanos, Ekolevizja, Prill 2009.
Juan Falconi, (2003) *Measuring the Economic Contributions of Tourism: A Proposal for some Basic Indicators*, document published in the UNWTO publication "Enzo Paci Papers on Measuring the Economic Significance of Tourism, volume 3".
Kelly J., Williams P. (2007): 'Modelling Tourism Destination Energy Consumption and Greenhouse Gas Emissions: Whistler, British Columbia, Canada', in *Journal of Sustainable Tourism*, Vol.15.
Lindberg, K., and R. L. Johnson. (1997). "Modeling Resident Attitudes toward Tourism." *Annals of Tourism Research*
MWH (2003): *Final Environmental Impact Assessment*, Vlora Combined, Montgomery Watson Harza Consulting, October 2003.

RSH (Republika e Shqipërisë) (2008): Strategjia kombëtare për zhvillimin dhe integrimin 2007-2013, Këshilli i Ministrave, Mars 2008.

RSH (Republika e Shqipërisë) (2007a): Strategjia kombëtare e energjisë, 2006-2020, Draft Dokument Sheldon, P. J., and T. Var. (1984). "Resident Attitudes to Tourism in North Wales." Tourism Management.

Referenca ligjore:

Ligji Nr.03/L-025 datë 26.02.2009, "Për Mbrojtjen e Mjedisit"

Ligji Nr.03/L-168 datë 11.02.2010, " Për turizmin dhe shërbimet turistike"

MARKETINGU I INTEGRUAR NË NDËRMARRJET E HOTELEVE NË RAJONIN E STRUGËS DHE OHËRIT

Mr.sc. Isak Ajruli

isak.ajruli@unite.edu.mk

Universiteti Shtetëror i Tetovës-Fakulteti Ekonomik Tetovë, R. e Maqedonisë.

Mr.sc. Fluturim Saliu

fluturim.saliu@unite.edu.mk

Universiteti Shtetëror i Tetovës-Fakulteti Ekonomik Tetovë, R. e Maqedonisë.

Dr.sc. Raman Ismaili

raman.ismaili@unite.edu.mk

Universiteti Shtetëror i Tetovës-Fakulteti Ekonomik Tetovë, R. e Maqedonisë.

APSTRAKT

Sektori i industrisë së hoteleve në Republikën e Maqedonisë përfaqëson shtyllën kryesore të zhvillimit të turizmit. Kjo industri gjithashtu paraqet një nga participantët më me relevancë në pjesën receptive të ofertës turistike të vendit.

Struktura organizative e kompanive të hoteleve në Maqedoni në fakt, jo çdo herë jep mundësi për aplikim të marketingut të integruar, me qëllim të njëjti mund të gjeneron efekte të dykrahëshme, të karakterit të ekstremeve të ndryshme mbi plasimin e produktit hotelier. Pra, jo çdo strukturë organizative e kompanive të hoteleve ofron mundësi që në politikën afariste të bazuar mbi konceptin e marketingut të praktikohen koncepte të marketingut të integruar.

Punimi ka karakter empirik, pra, i njëjti trajton problematikë të dijshe në sferën e akomodimit të turistëve të vendit. Gjithashtu në këtë punim meren parasysh dhe trajtohen efekte të disa faktorëve relevant të cilët shkenca turistike nga njëra anë ata i njeh si mundësi stimuluese, ndërsa, nga ana tjetër si kufizime të mundshme që ndikojnë në shitjen e produktit dhe shërbimit hotelier.

Në fund, me këtë punim ofrohet zgjidhje e cila bazohet në hulumtimin empirik të përvojës praktike të afarizmit të sektorit hotelier të regjionit të Strugës dhe Ohrit.

Fjalë kyçe: marketingu i integruar, sektori i industrisë së hoteleve, Republika e Maqedonisë dhe regjioni i Strugës dhe Ohrit.

HYRJE

Koncepti i marketingut të integruar në turizëm ka të bëjë me integrimin e aktiviteteve të marketingut në makro nivel (vendi dhe destinacioni), mezo nivel (rajon ose vend turistik) si dhe në mikro nivel (ndërmarrje turistike).

Pra, bazë për realizimin e këtij lloji të integrimit është koordinimi i tërësishëm i aktiviteteve të marketingut brenda dhe jashtë ndërmarrjes, edhe atë: të gjitha aktivitetet e marketingut duhet të koordinohen mes tyre, sektori i marketingut duhet të koordinohet me sektorët tjerë të ndërmarrjes si dhe sektori i marketingut duhet të përputhë koordinimin e ndërmarrjes si tërësi me ndërmarrjet tjera.

Kjo bëhet me qëllim që sektori i marketingut të sigurohet në ata se të gjitha aktivitetet e ndërmarrjes janë të orientuara drejt një qëllimi të përbashkët të kënaqjes së nevojave të turistëve dhe realizim të profitit.

Që të mund të veprohet „integralisht“, në rrethana të një konkurrence të ashpër dhe të fuqishme, bartësit kryesor të ofertës turistike midis tjerëve edhe kompanitë e hoteleve, janë të detyruara që në politikën e tyre afariste të realizojnë të gjitha funksionet e marketingut, pa marr parasysh se në strukturën e tyre organizative kanë ose jo departamente për të gjitha funksionet e marketingut, por, ato një pjesë të shërbimeve duhet ti realizojnë me ndërmjetësim të ndonjë ndërmarrjeje tjetër.

Por, për të realizuar këto qëllime shumë kompani të hoteleve shpesh herë hasin në vështirësi të ndryshme, nga shkakut se ato janë të kufizuara nga kapacitetet e tyre, potenciali ekonomik dhe struktura organizative. Kjo le të kuptohet se, kapacitetet e hoteleve determinojnë strukturën organizative të ndërmarrjes, argument ky që kufizon realizimin e të gjitha funksioneve të marketingut brenda përbrenda strukturës së tyre organizative. Pra duke u bazuar në mundësitë e brendshme të kompanive, kjo edhe justifikon realizimin e funksioneve të marketingut edhe jashtë ndërmarrjeve hoteliere.

Mirëpo duhet potencuar se koordinimi i aktiviteteve të marketingut paraqitet edhe ndërmjet bartësve të ofertës turistike si që janë ndërmarrjet dhe organizatat turistike, niveli lokal ose destinacioni si dhe niveli qendror. Duke realizuar aktivitetet e tyre, këto participantë krijojnë sisteme të përbashkëta të marketingut. Nisur nga kjo, edhe pse një pjesë e aktiviteteve realizohet jashtë ndërmarrjeve megjithatë është me rëndësi që vendimet merren nga marketing menaxhmenti i ndërmarrjes përkatëse.

Nevoja e koordinimit të aktiviteteve në disa nivele në turizëm gjeneron nevojën për koordinim vertikal dhe horizontal të të gjitha subjekteve pjesëmarrëse në tregun turistik.

Koordinimi vertikal në turizëm ndër bartësit kryesor të ofertës turistike në mikro plan njih hotelet, agjencionet turistike, agjencionet e udhëtimit, kompanitë ajrore dhe turoperatorët. Andaj, kooperimi ndërmjet këtyre subjekteve, mundëson që marketing aktivitetet në çdo element të marketingut të zhvillohen në një ndërmarrje, ose këto aktivitete të jenë të shpërndara ndërmjet këtyre subjekteve.

Edhe pse një pjesë e aktiviteteve shpërndahen ndërmjet subjekteve të lartpërmendura, aktivitetet ruajnë karakterin e tyre integruar. Nga kjo del se, marketingu i integruar, ruan konceptin e tij, sepse ai paraqitet si rezultat i kooperimit në marketing aktivitete të niveleve të ndryshme, të subjekteve turistike që paraqiten si bartës të ofertës turistike, qofshin ato të organizuara edhe si ndërmarrje tjera të specializuara.

Këtu buron edhe roli i marketingut të integruar dhe roli i tij kooperativë ndërmjet ndërmarrjeve me veprimtari të ndryshme, por çdo herë në funksion të shfaqjes së efekteve sinergjike në drejtim të realizimit të plasimit të prodhimit dhe shërbimit hotelier.

Për arsye të koordinimit më të tërësishëm në mes të bartësve të ofertës turistike në mikroplan dhe aktiviteteve të hartuesit të politikës turistike në nivele të ndryshme në makroplan, themelohen dhe institucione të ndryshme me detyra konkrete në këtë proces me qëllim të koordinimit sa më të suksesshëm të dy politikave që sillen nga këto nivele.

GJENDJA DHE ZHVILLIMI I INDUSTRIË SË HOTELEVE

Republika e Maqedonisë posedon një numër solid të hoteleve të kategorizuara. Mirëpo, kronologjia e zhvillimit të kësaj industrie përfshinë dy periudha kryesore, si, periudha e parë deri në vitin 1992 që është e njohur si periudha deri në tranzicion, dhe periudha e dytë prej vitit 1992 e deri më sot ose periudha e post-tranzicionit.

Deri në vitin 1992 Republika e Maqedonisë ka disponuar me 82 objekte hotelesh, ndërsa në vitin 2010 ky numër u rit në 124 objekte, trend ky që tregon një rritje të konsiderueshme të numrit të hoteleve. Mirëpo, kjo rritje e numrit të hoteleve nuk korrespondon me rritjen e numrit të dhomave dhe shtretërve.

Në fakt, periudha e dytë e post tranzicionit në industrinë e hoteleve në Maqedoni karakterizohet me rritje të numrit të objekteve të hoteleve por zvogëlimin e numrit të dhomave dhe shtretërve në këto kapacitete. Pra, numri i hoteleve nga 91 hotele që ka numëruar Maqedonia në vitin 2006, në vitin 2010 numri i objekteve ritet në 124 njësi.

Viti	Numri i hoteleve	Numri i dhomave	Numri i shtretërve
2006	91	6086	14538
2007	93	6222	14832
2008	95	4747	10364
2009	110	5142	11307
2010	124	5651	12734

Tabela nr.1: Numri i hoteleve në Republikën e Maqedonisë

Nga numri i përgjithshëm prej 124 hoteleve që ka Republika e Maqedonisë, 52 prej tyre, ose 42% gjenden në rajonin e Strugës dhe Ohrit. Pra është ky rajoni ku kryesisht janë të koncentruar objektet e hoteleve të kategorive të ndryshme.

Gjithashtu, karakteristikë e hoteleve të rajonit të Strugës dhe Ohrit viteve të fundit është ajo se, edhe pse rritet numri i hoteleve numri i dhomave dhe shtretërve zvogëlohet.

Arsyet e një disproporcioni të tillë mund të sqarohen me atë se, hotelet e reja që janë ndërtuar viteve të fundit janë hotele me kapacitete të vogla, ndërsa një numër i konsiderueshëm i hoteleve me kapacitete më të mëdha me kapital shoqëror, pësuar nga privatizimi jo i drejtë i tyre.

Por, përshtatja e politikës afariste ndaj trusnive të jashtme dhe adaptimit të mundësive të brendshme të kompanive të hoteleve ndaj mjedisit turbulent biznesor paraqet bazën mbi të cilën hotelet e këtij rajoni arrin avantazhin e tyre në tregun turistik. Kjo njëherit bazohet në koordinimin e aktiviteteve marketing në ndërmarrjet e hoteleve, dhe gjithashtu

koordinimin aktiviteteve të hoteleve në lidhjet e tyre vertikale dhe horizontale në marketingun e vendit si destinacion turistik.

E gjithë kjo që u lartëcek, determinon që politika afariste e hoteleve të jetë e bazuar mbi konceptin e marketingut, jo vetëm të hoteleve, por të gjithë pjesëmarrësve në përpilimin e produktit integral turistik.

2. AKTIVITETET E MARKETINGUT NË KOMPANITË E HOTELEVE

Pasi që në Republikën e Maqedonisë hotelet kryesisht janë me kapacitete të vogla, ato nuk kanë mundësi që të aplikojnë marketingun në të gjitha elementet e tij, por shpesh herë janë të detyruar që aktivitetet e marketingut t'i zhvillojnë vetëm në disa elemente të marketingut. Ndërsa, një numër i vogël i hoteleve në Maqedoni janë hotele me kapacitete të mëdha, ata mund të zhvillojnë marketing të tërësishëm në shërbimet e politikës së prodhimit, çmimeve, promovimit dhe distribuimit brenda mundësive të strukturës organizative të tyre.

Aplikim të marketingut të plotë	Numri i hoteleve	Përqindja e hoteleve
Po	11	55%
Jo	9	45%
Gjithësejt	20	100%

Tabela numër 2: Aplikimi i marketingut në kompanitë e hoteleve

Si që shihet nga tabela nr.2, të dhënat e studimit empirik rreth aplikimit të marketingut në hotelet e rajonit tregojnë se 55% të hoteleve aplikojnë marketing të plotë në kompanitë e tyre, ndërsa 45% të tyre nuk praktikojnë të zbatojnë marketing të plotë.

Aplikim të marketingut të plotë zbatojnë kryesisht hotelet që janë me kapacitete të mëdha, derisa hotelet me kapacitete të vogla aplikojnë marketing të pjesërishëm.

Aplikimi i disa elementeve të marketingut	Numri i hoteleve	Përqindja e hoteleve
Produkti	2	10%
Çmimi	7	35%
Shitja	9	45%
Promocioni	9	45%
Gjithësejt	20	100%

Tabela numër 3: Aplikimi i marketingut në disa elemente të marketingut në kompanitë e hoteleve

Nga tabela nr. 3, shihet qartë se hotelet me kapacitete të vogla kryesisht aktivitetet e marketingut i kanë të koncentruar në shitje, promovim dhe çmim. Kjo ndodh për arsye të strukturës së tyre organizative si rrjedhojë e mos aplikimit të modeleve të drejtimit të ndërmarrjeve, që faktikisht paraqesin komponentë frenuese mbi aplikim të marketingut të tërësishëm (tabela nr.4).

Aplikimi i modeleve të drejtimit	Numri i hoteleve	Përqindja e hoteleve
Po	6	38%
Jo	10	62%
Gjithësejt	16	100%

Tabela numër 4: Aplikimi i modelit të drejtimit nga kompanitë e hoteleve

Mirëpo edhe pse 62% të hoteleve nuk përdorin model drejtimit, ato, çdoherë aktivitetet e marketingut i realizojnë me anë të ndërmjetësimit të kompanive të tjera në varshmëri të fushës se ku ato aktivitete paraqiten si të nevojshme qofshin ato të karakterit të lidhjeve vertikale ose horizontale.

Ndërsa kompanitë që praktikojnë implementim të modelin të udhëheqjes përfshinë 38% të hoteleve, por të njëjtët implementojnë njërin nga modelet më të thjeshta, pra modelin funksional.

E gjithë kjo që u cek më lartë paraqet bazë për të analizuar gjithashtu mundësinë e kooperimit të ndërmarrjeve të hoteleve të këtij rajoni me nivelin e mesëm dhe atë të lartë, me qëllim të realizimit të funksioneve të marketingut. Kjo paraqitet si nevojë për shkak të strukturës së kombinuar të përpiluesve të ofertës turistike, mirëpo duhet theksuar atë se, që të shfaq implikime të marketingut të integruar koncepti afarist i të gjithë pjesëmarrësve duhet bazuar mbi konceptin e marketingut.

Ki koncept si tërësi e integruar e aktiviteteve të koordinuara të marketingut të të gjithë niveleve të bartësve të produktit turistik paraqet shumë aktivitete të nevojshme për plasimin e produktit hotelier (figura nr.1).



Figura numër 1: Nivelet e bartësve të produktit turistik

Hotelet e regionit të Strugës dhe Ohrit në nivel të destinacionit turistik koordinojnë aktivitete e tyre me të gjitha nivelet përkatëse. Në nivel të destinacionit turistik ose të atij lokal realizohen aktivitete promotive si organizimi i propagandës së përgjithshme, përfaqësim i hoteleve në panairt kombëtare dhe ndërkombëtare.

Koordinimi i aktiviteteve të marketingut gjithashtu realizohet në lidhjen horizontale të hoteleve nëpërmjet themelimit të asociacionit të hoteleve të Maqedonisë i cili më tej koordinon aktivitetet me nivelin qendror.

Në kuadër të vendit gjithashtu vepron edhe Agjencioni për promovim dhe përkrahje të turizmit në Republikën e Maqedonisë, aktivitetet e të cilit ndikojnë në promovimin e turizmit në tregun turistik ndërkombëtar.

PËRFUNDIM

Duke u bazuar në analizën dhe interpretimin e të dhënave empirike mbi gjendjen dhe zhvillimin kompanive të hoteleve në Republikën e Maqedonisë, mund të konstatojmë se trendi i zhvillimit i kësaj veprimtari rezulton me ndërtimin e objekteve të hoteleve me kapacitete të vogla, që vjen si rrjedhojë e përshtatjes kundrejt tregut me lojtar të ridefinuar që në fakt mund të quajmë si „ pjellë e çthurjes së ish bllokut socialist„. Ndërsa hotelet me kapacitete më të mëdha të cilët i mbijetuan procesit të tranzicionit, u privatizuan dhe sot kanë titullarët e tyre.

Nga analiza mund të konstatojmë se hotelet me kapacitete të vogla janë trend i arsyeshëm për tregje të vogla turistike, sepse mundësia e implementimit të marketingut të integruar paraqet element kyç në zvogëlimin e shpenzimeve fikse, gjë që arsyeton strukturën organizative dhe mos inkorporimin e të gjitha elementeve të marketingut në ndërmarrje.

Ndërsa hotelet me kapacitete të mëdha edhe pse janë hotele të cilat kanë të instaluar marketing të plotë, ata mbijetojnë nga se aktivitetet e marketingut i koordinojnë me të gjitha përpluesit e ofertës turistike, aspekt që ndikon në afarizmin e tyre gjatë tërë vitit kalendarik.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Bakić O., "Strategija planiranja turističkog prizvoda", Beograd,1995.
2. Galičić V., Ivanović S., Lupić M., "Hotelska prodaja i recepcisko poslovanje", Fakultet za turistički i hotelski menadžment Opatija,Opatija, 2005.
3. Miladinovski S. i S.> "Marketing vo turizmot", FTON - Ohrid, 2006.
4. Kosar Lj., "Hotelijerstvo teorija i praksa", Viša hotelijska škola, Beograd, 2002.
5. Tuntev Z., "Turisti-ka destinacija", FTU- Ohrid, 2007.
6. Kotler Ph., "Upravljanje marketingom", Informator, Zagreb,1988.
7. Radičić Berć B., "Marketing u hotelijerstvu", Sveučilište u Rijeci, Opatija, 2004, god
8. Radičić Berć B., "Promocija u hotelijerstvu", Sveučilište u Rijeci, Opatija, 2005.

RENTABILITETI NGA TURIZMI TRANZITOR

Doc.Dr.Zija Zimeri

Hyrje

Rentabiliteti nga aktivitetet turistike është me rëndësi të madhe për çdo ekonomi, nga shkakut se industria ekonomike sot ka marrë një hovë më shumë vende të botës. Qasja me një plan për zhvillimin e të gjitha llojeve të turizmit e posaçërisht të turizmit tranzitor, për Maqedoninë është me një rëndësi të veçantë. Mu për këtë egzistojnë destinacione hapsinore antropogjene dhe natyrore - gjeografike kompleksiteti i së cilave dhe llojllojshmëria duhet të ngritet në nivelin më të lartë eksplotativ. Që e gjitha kjo të arrihet, gjithsesi duhet të egzistojnë kushte të caktuara, për një zhvillim sa më dinamik të ofertës turistike për turistët tranzitor, respektivisht të turizmit tranzitor. Duke u nisur nga këto paragjykime, me rëndësi është që të dijmë problemet dhe po të njëjtët ti vëmë në plan për zhvillimin e turizmit tranzitor i cili do të mundësonë një kompleksitet të llojllojshëm, pra me një seriozitet të përgaditen plane konkrete akcionare për realizimin e tyre. Për zhvillimin e turizmit tranzitor si dhe të gjitha llojeve të turizmit, me rëndësi është që të determinohen të gjitha institucionet e përbashkëta shtetërore se dhe të gjitha subjektet nga sektori qytetar me qëllim të vetmën që të arrihen strategjit të parumenduar për zhvillimin e këtij lloj turizmi. Më pas do të analizojmë problemet që kanë të bëjnë me gjendjen e konsumit turistik dhe të mundësive për zhvillimin dhe për rritjen e prodhimit turistik dhe konsumit turistik, karakteristikat tyre të përgjithshme dhe specifikat të konsumit turistik. Të gjitha këto probleme sot në Maqedoni janë probleme e të përditshme të cilat mund për zgjidhjen e tyre, posaçërisht të objekteve infrastrukturore të cilat janë me rëndësi të madhe ekonomike, e kjo do të thotë edhe për zhvillimin e aktiviteteve turistike.

Konsumi turistik

Turizmi si një dukuri mjaft e komplikuar dhe komplementare shoqërore ekonomike, posaçërisht turizmi tranzitor, sot me një dinamik shumë të madhe është përhapur në shumë vende të hotës. Kjo dukuri është karakteristike edhe për vendin tonë, mu për pozitën e saj gjeostrategjike e cila ka një pozitë qendrore në Evropën juglindore dhe nëpër territorinë saj kalojnë një numër i madh udhëtarësh edhe turistësh. Nënkuptoet që destinacionet turistike për gjatë rrugëve më të rëndësishme dhe koridoreve zhvillimor të vendit tonë janë mjaft me rëndësi për intensifikimin e këtij lloji turizmi (turizmi tranzitor), kur veç më janë të qarta definicionet për turizmin tranzitor të koridorit 10 dhe degës së koridorit 10, pastaj koridorit 8 dhe koridorit qendror në hapsirën e Maqedonisë, atëherë është e qartë për çfarë destinacionesh turistike bëhet fjalë dhe secilen nga këto ka specifikat e saja si nga aspekti i motiveve natyrore për ashtu edhe atyre dhe antropogjene. Kjo do të thotë se destinacionet turistike paraqesin gjeo hapsirë të caktuar e cila disponon me faktor anaktiv, receptivë dhe komunikativ, me qëllim që të plotësohen nevojat e turistëve por edhe të vet udhëtarëve. Të gjitha këto karakteristika janë mjaft me rëndësi për të gjitha llojet e turizmit, e kjo do të thotë edhe për turizmin tranzitor me të gjitha përmbajtjet e lartë përmendura. Pra mundë të themi ofertat turistike, e posaçërisht


kërkesat turistike kanë karakter kompleks në procesin e formimit dhe realizimit të nevojave turistike , me çka në këto procese hyjnë edhe disa veprimtari ekonomike dhe joekonomike, karakteristike të ceket se në këto aktivitete turistike rëndësi të madhe kanë kapacitetet prodhuese ekonomike të cilat janë të lidhura me vendosjen dhe ushqimin e turistëve tranzitor , mundësimin e shërbimeve të nevojshme (shërbime trafikore , shëndetësore , shitjen e artikujve të ndryshëm , etj) , zbatimjen , vendparkimin etj. Kuptohet se për të gjitha turisti tranzitor ka nevojë që në rrugët tona magjistrale të vendit ti ketë këto shërbime por siç kemi cekur edhe më herët në rrugët magjistrale tona gati se edhe nuk egzistojnë, me përjashtim të ndonjë shërbimi të cilit mund tija mundësoj të punësuarit në ndonjë pikë karboranti , ose në ndonjë motel të vogël të cilat ndodhen në rrugët tona magjistrale.

Pra destinacionet turistike tranzitore duhet të disponojnë me materialet më të rëndësishme, resurset hapsinore dhe njerëzore.

Si karakteristikë është edhe zhvillimi intensiv turistik dhe ekonomisë turistike themelore në zhvillimin intensiv të turizmit të sotshëm , me çka nga njëra anë sot sjell probleme të mëdha në lidhje me organizimin e veprimtarive të ndryshme shërbimore në vet mjediset qytetare, kurse nga ana tjetër mjediset rurale demografikisht mbesin hapsir e zbrazët , me çka sjellin pasojë të mëdha për zhvillimin proporcional dhe transformimin e hapsirës , me çka mjediset fshatare pësojnë probleme të mëdha organizative me çka zvoglohet edhe aktiviteti turistik.


Promocioni i globalizmit , si filozofi moderne dhe si mënyrë e funksionimit në drejtimet filozofike më të mëdha botërore , sigurisht që do të sjell gjer tek proceset e mëdha të modernizimit duke filluar nga mënyra e prodhimit të produkteve bujqësore të dedikuar për furnizimin e konsumatorëve si të jashtëm ashtu edhe të mbrendshëm. Sot edhe qytetari i Maqedonis veç më është kyqur në biznes destinacionet e ashtequajtura ballkanike evropane dhe botërore , me çka edhe vendi ynë hyn në hallkën e biznes konsumatorëve , me çrastë kanë dobi dhe nevojë jo vetëm qytetarët e Maqedonisë, por edhe turistët e huaj të cilët qëndrojnë në vendin tonë ose kalojnë në mënyrë tranzite nëpër vendin tonë. Njeriu modern në jetën e sotme dinamike në mënyr është në kundërtënie permanente me ligjet e në rrethin e ti si dhe me kundërtënie ekstreme në relacion pushim-punë dhe e kundërta. Pohimet shkencore rekreacionin e konsiderojnë si pjesë përbërëse të procesit të prodhimit dhe hapsira e cila ndikon në jetën e përgjithshme të njeriut të sotshëm , me cka pushimi sot nuk është me luks ,por nevojë e patjetërsueshme e çdo njeriu që të lirohet nga problemet e përditshme që i has në vendin e punës ose të ketë pushim psikofizik.

Turizmi si veprimtari polifunksionale ndikon në rritjen e prodhimit të përgjithshëm nacional , përmirësimin e bilansit pagesor , në rritjen e punësimeve të reja e me të edhe në rritjen e standartit jetësor të popullatës. Gjithashtu duhet cekur se turizmi si veprimtari e përgjithshme ekonomike , posaqërisht turizmi tranzitor ndikon drejtpërdrejt edhe në rritjen e investimeve në destinacionet turistike, e me atë rritet numri i funksioneve ekonomike siç janë procesi i prodhimit i cili lehtë absorbohet nga ana e fuqisë blerëse të turistëve ,balansohen mardhëniet para-mallra , si dhe këmbimi ndërkombtar turistik-ekonomik.



Funksioni ekonomik i turizmit me së shumti vërehet në bartjen e të ardhurave nga një vend në vendin tjetër si dhe e kur bëhet fjalë për lëvizjet turistike ndërkombëtare , gjatë levizjes e së të ardhurave nga një shtet në një shtet tjetër. Kjo lëvizje e të ardhurave për vendet turistike ka një ndikim të rëndësishëm për zhvillimin e veprimtarive ndjekëse që janë mjaft me rëndësi për zhvillimin e turizmit tranzitor.

Qarkullimi i udhëtarëve tranzitor dhe turistëve tranzitor në vendkalimet kufitare të Maqedonisë me vendet fqinje, një për vendin tonë dhe qytetarët e saj që sjellë një fitim të konsiderueshëm, para se gjithash kjo ka të bëjë me konsumin shtesë i cili është prezent mu për shkak të qarkullimit turistik , respektivisht qarkullimi i cili realizohet nga ana e turistëve tranzitor.



Si shtesë konsumatorit (pra turist) kërkon prodhime të llojllojshme i , posaqërisht nga fusha e prodhimeve bujqësore të cilat përdoren si ushqim direkt për udhëtarët tranzitor dhe turistët tranzitor , dhe këto nevoja janë të rëndësishme edhe për popullatën rezidenciale , të cilët janë turist tranzitor potencial nga një vend në vendin tjetër , respektivisht në destinacione të ndryshme turistike. Për këto shkaqe rritja e qarkullimit të jashtëm turistik kërkon nga bilanset nacionale te prodhimit qe te llogarrit për plotësimin e nevojave edhe të këtij lloji të konsumit , pa marrë parasysh se trallë bëhet fjalë për prodhimin e artikujve ushqimor apo të artikujve të tjerë, të cilët janë të rëndësishëm për stabilizimin e konsumit turistik.

Karakteristikat e përgjithshme dhe specifike te konsumit turistik

Konsumi turistik karakterizohet me gjërë specifkash të cilat janë të shumta tëpërgjithshme dhe të veçanta.Si dukuri modern quhet edhe " Industri turistike pa industri " kërkon kushte dhe rrethana të posaçme , kështu që turisti paraqitet si konsumator nga

njera anë , kurse nga ana tjetër paraqiten një varg i veprimtarive të posaçme ekonomike dhe jo ekonomike të cilat ofrojnë mallra dhe shërbime. Kjo gjithësi do të thotë se oferta turistike përbëhen mallra të shumta dhe shërbimeve të ndryshme, të cilat plasohen në tregun turistik dhe më pas përmes saj përcaktohet edhe shkalla e konsumit të përgjithshëm dhe specifik i prodhimeve të caktuara si për nga sasia ashtu edhe për nga struktura e prodhimit , si dhe nevoja për definimin e llojeve të shërbimeve turistike.

Aspektet specifike për zhvillimin e turizmit si veprimtari ekonomike duhet të shiqohen në politiken dhe strategjinë e investimit në veprimtari të caktuara të cilat pa parakusht paraqesin bazë për intensifikimin e aktivitetit turistik në zonat turistike , e në shembullin tonë në objektet potenciale turistike në afërsi të koridoreve trafikore të vendit tonë , posaçërisht të koridorit 10 dhe koridorit 8 , përshkak se në afërsi të tyre egzistojnë bukuri natyrore , vendbanime antike etj. Me investimin në turizëm duhet të nënkuptohet investimi jo vetëm në kapacitetet për shërbim , për vendosje por edhe në veprimtaritë shërbimore ekonomike të cilat janë në favor të ekonomisë turistike , me çka fitohet oferta e nevojshme e përgjithshme turistike.

Me interes të veçant vlen të ceket edhe fakti se turizmi si veprimtari moderne ekonomike veç më hynë në shumë sfera me interes të përgjithshëm dhe specifik të jetës ekonomike dhe shoqërore , posaçërisht në zona të caktuara turistike dhe lokalitete të cilat kanë traditë shumë vjeçare dhe në të cilat zona popullata kryesisht merret me atë veprimtari. Përgjatë koridoreve trafikore në Republikën e Maqedonisë egzistojnë tendencë e kapitalit privat në investime serioze në sferën e objekteve për vendosjen e turistëve , objekteve hoteljerike , orijentimin e disa prodhimeve të veprimtarisë artizanate të cilat i tërheqin vëmendje turistëve e huaj edhe ata Maqedonisë , me çka përmirësohet heterogjiniteti turistik në regjione të caktuara turistike në zona apo lokalitete.

Trafiku , agjensionet turistike , kapacitetet për vendosje , tregtia , llojet e shërbimeve komerciale gjithësi hynë në aktivitet direkte me çka përmirësohet mobiliteti turistik në zonat dhe lokalitetet turistike. Në suaza të këtyre karakteristikave për zhvillimin e turizmit në përgjithësi e posaçërisht të turizmit tranzitor hynë edhe një varg i aktiviteteve të tjera jo ekonomike , kulturo artistike , sportive dhe manifestime të cilat kanë traditë të tyre dhe fizionomi të formuar e të cilat mund të kenë organizim lokal regional , nacional dhe karakter ndërkombëtar.

Siç çë cekem edhe më herët , funksionet jo ekonomike të turizmit paraqesin pajtete]ërsueshmëri për realizimin me sukses të këtij aktiviteti. Në këtë drejtim në mënyrë direkte dhe indirekte ndikon tek turistët kurse të njëjtat funksione jo ekonomike në mënyrë direkte apo indirekte janë të lidhura me inter ndikimet në vet veprimtaritë ekonomike dhe orijentimin e tyre kah avansimi , racionalizimi dhe ekonomizimi i aktiviteteve të përgjithshme turistike. Nëpër territorin e Maqedonisë nga të gjitha pikat kufitare kalojnë mesatarisht rreth 5,8 milion udhëtarë të cilët japin një kontribut të madh për zhvillimin e madh tranzitor me çka akoma nuk egzistojnë kushte të volitshme në rrugët magjistrale për qëndrimin sa më të gjatë të udhëtarëve tranzitor , duke filluar nga vend parkimet moderne , objektet për shërbim sipas kriteriumeve dhe standardeve të vendeve evropiane ,të vetmin me qëllim që të mbahet valuta e huaj në ato hapsira. Për shkak të dinamikës së përgjithshme të zhvillimit turistik në shumë vende në botë, posaçërisht në vendet tona fqinje, të cilat tregojnë një interes më të madh në zhvillimin e turizmit tranzitor , duhet të ceket se dhe vendi ynë duhet të investon mjete të shumta në këtë drejtim. Shteti duhet të marrë pjesë në formimin e zonave të posaçme në të cilat qytetarët

do të jenë të interesuar që ti investojnë mjetet e tyre për organizimin e rrjetit me tërë aktivitetet në lidhje me transformimin e hapsirës turistike për gjatë rrugëve magjistrale të Maqedonisë. Në vendin tonë sot egzistojnë zona bukur mirë të formuara turistike por kryesisht ato janë të koncentruara në pjesën jugperëndimore të Maqedonisë nëpër të cilat kalon koridori 8 dhe koridori qendëror në të cilat udhtarët tranzitor dhe turistet mund të harxhojnë kohë dhe mjete në ato lokalitete (regjioni Strugë –Ohër dhe Prespë) kurse përgjat korridorit 10 gati se edhe nuk ka asfarë kushte që të ndodh kjo përveç në disa kafiteri substandarde , shitore të vogla e jo të rregulluara , kiosqe.

Vendi dhe roli i turizmit tranzitor ne zhvillimin turistike

— Turizmi paraqet aktivitet ekonomik për regjione të vecanta hapsira dhe vende turistike në vendin tonë. Turizmi në vendin tonë gjithashtu paraqet veprimtari të rëndësishme ekonomike , e cila mundet pozitivisht të kontribuojnë në mbushjen e buxhetit të shtetit si dhe buxhetit të ekonomive individuale të cilat merren kryesisht me këtë aktivitet (përmes dhënjeve të shërbimeve për vendosje ,ushqim etj) Sot turizmi i plotëson nevojat themelore dhe vlerat e njeriut modern , kërkesë turistike si proces afatgjat , përshkak se ajo paraqet një nga veprimtarit më stabile. Mes qëllimeve themelore të politikës turistike , e njëkohsisht edhe krijimin e mundësive për organizim racional dhe ekonomik të gjeohapsirave të caktuara për aktivitete ekonomike nga fusha turistike , duhet të potencial se koridoret themelore nuk i plotësojnë kërkesat themelore dhe kriteriumet për mbajtjen e turistëve tranzitor për gjatë rrugëve magjistrale në Maqedoni për shpenzimin e parave të tyre gjatë udhëtimit , gjatë pushimeve të shkurtëra nëpër vend parkime , pompave të benzines , motele , shitore etj.

Për plotsimin e nevojave të turistëve bëjnë pjesë edhe veprimtarit e ndryshme ekonomike dhe jo ekonomike të cilat mund të ofrojnë prodhime të tyre dhe shërbime për konsum të përgjithshëm e posaqërisht në konsumin e përgjithshëm turistik. Njëkohësisht në zonat tona turistike dhe lokaliteteve turistike përveç turistëve të cilët janë me qëndrim të përkohshëm në vende turistike pjesë nga të ardhurat e tyre dhe nga pjesët tjera të vendit dhe nga vendet eksterno , duhet të merret parasysh se konsumi turistik paraqet edhe një zgjerim momental të tregut për të gjitha prodhimet nga veprimtarit e ndryshme ekonomike dhe jo ekonomike.

Për shkak të strukturës së përgjithshme të komplikuar të turizmit dhe aktiviteteve turistike , shpesh definohet se turizmi duhet të kuptohet si dukuri e cila inicon kërkes të llojllojshme me çka mundëson krijimin e tregut të ri dhe nëpërmjet këtij proces stimulohet zgjerimi dhe avancimi i prodhimit në gjitha veprimtarit në të cilat mbahet monedha vendore dhe ajo e jashtme nga konsumi turistik. Roli ekonomik i turizmit është i madh vetëm atëherë kur egzistojnë aktivitete turistike saktësisht të definuara, e për këtë paraprakisht duhet të definohe një strategji për radhitjen e transformimit dhe ekipimin e të gjitha kushteve paraprake si nga fusha e veprimtarive ashtu edhe të atyre jo ekonomike.

Pjesmarrja e turizmit tranzitor ne fitimin e përgjithshëm turistik

Në literaturën shkencore shpesh përmendet fakti se sot turizmi paraqet veprimtari mjaft të rëndësishme ekonomike , e cila me një organizim të mirë dhe racionalizim mund

të bart një shumë të mjeteve të cilat mund të veben në funksion të zhvillimit të saj të mëtuqjeshëm. Turizmi tranzitor mundëson bartje të konsumit nga një vend në një vend tjetër , me kusht që në atë vend të ketë destinacione interesante për pushim të shkurt dhe rekreacion për gjat rrugëve magjistrale në koridorin 10 dhe koridorin 8 , ku për fat të keq nuk paraqitet në rrugët tona magjistrale. Përveç pompave të benzinës në vet rrugët magjistrale janë mjaft të rralla objektet të cilat ofrojnë produkte adekuate për turistët tranzitorë.

Turistët e jashtëm në vendin tonë sjellin shuma të mëdha të devizave. Prioritet i vendit tonë , si dhe prioritet i shumë vendeve nëpër botë pa marrë parasysh shkallën e zhvillimit , madhësinë është akumulimi i kapitalit devizor me të cilat vendi ynë ka qëllime të caktuara për mbylljen e pyetjeve të caktuara që vijnë nga fusha e zhvillimit të ekonomisë turistike.

Në Maqedoni në vitin 1994 kanë qëndruar 240 514 turist të huaj të cilët kanë realizuar 489 611 fjetje. Kjo do të thotë se vendi ynë nga turizmi i huaj ka realizuar të ardhura devizore rreth 60 milion euro , e ne në krahasim me vitin 1981 kur janë realizuar 25 milion euro paraqet rritje prej 140 % .

Në vendin tonë numri i organizatave të regjistruara të cilat merren me veprimtari turistike është mbi 120 , nga te cilat 33 prej tyre janë pastër shërbimore pritëse.

Në vendin tonë egziston shpërndarje e pritjes komerciale , me çka çdo agjension turistik vet paraqitet para organizatave për pritje , për huazimin e krevateve dhe pa të njëjtat vet i ofron në tregun turistik.

Fitimi i paramenduar i udhëtarëve tranzitor dhe turistëve në koridorin 10 dhe degën e koridorit 10 dhe koridorit 8 është real kur ke parasysh madhësia e masës së turistëve tranzitor. Mundësit e paramendura janë mjaft reale përshkak se vetëm në rampat për pagesë të cilat egzistojnë në rrugët magjistrale të përmendura të karakterit ndërkombtarë mesatarisht shpenzohen nga ana e klientëve tranzitor nga 5 deri me 10 euro , por nëse udhëtarët e njëjtë harxhojnë mjete devizore edhe për qëllime të tjera (si ushqim , kafe, suvenire , pije etj) , atëherë realisht është të pritët se fitimi material është edhe më i madh. Kështu përshembull në koridorin 10 së bashku me degën e koridorit 10 nëse udhëtarët tranzitor dhe numri turistet që shumën rreth 5860900 harxhojnë vetëm nga një euro , fitimi do të ishte 5, 9 milion euro , kurse në qoftë se të njëjtit harxhojnë nga 5 euro atëherë fitimi i përgjithshëm do të ishte shuma rreth 29,3 milion euro , këto janë harxhime reale në rrugët tona magjistrale.

Sipas variantit të tret nëse udhëtarët tranzitor dhe turistët shpenzojnë nga 10 euro , atëherë fitimi rela arrin shumën 58,6 milion euro dhe varianti i katërt nëse se çdo udhëtar tranzitor dhe turist në rrugët e përmendura magjistrale të koridorit 10 (degës së koridorit 10) harxhon nga 20 euro atëher fitimi i përgjithshëm do të arrinte shumën rreth 117,2 milion euro.

Analizat e bëra për koridorin 8 nëpër të cilën magjistrale kalojnë gjithsej 4797598 udhëtar tranzitor dhe turist , sipas principit të njëjt do ishte si ne vijim : numri i përgjithshëm i udhëtarëve tranzitor dhe turistëve të shumzohet me faktorin 1 euro , fitimi vjetor do ishte 4,8 milion euro përball , me faktorit 5 euro atëher shuma do arrinte 24 milion euro , me faktorin 10 euro fitimi do të ishte 48 milion euro , çka paraqet konsum real, por edhe patjetërsueshëm për masën e përmendur të udhëtarëve tranzitor dhe turist. Në qoftë se në koridorin 8 do egzistoni objekte adekuate infrastrukturore ky numër i turistëve me siguri do shpenzojnë edhe gjerë më 20 euro , kurse fitimi mesatarisht do të

arrinte shumën 96 milion euro. Në bazë të këtyre paragjyqimeve reale të dy koridoreve (koridorit 10 dhe koridorit 8) , nëse merret konsumi real (pa konsumin e karborantit të Maqedonisë për veturat e tyre) ,një faktori 10 euro , Republika e Maqedonisë nga ky lloj turizmi do të kishte njëshumë reale prej 106,6 milion euro.

Këto procese pozitive të cilat janë reale sot për turizmin modern paraqesin veprimtari të rëndësishme profitabile ekonomike e cila është e lidhur me faktor të tjerë dhe elemente të cilat nga njëanë e përbëjnë kompleksitetin e aktivitetit turistik nga ana tjetër e konsumit. Sot egzistojnë më varg teorish që lidhen me proffitabilitetin turistik e cila luan një rol të madhë në lidhje me mbushjen e buxhetit të shtetit në vendin tonë ,dhe drejtpërdrejt në buxhetin e vet ndërmarrjeve turistike. Përveç efekteve ekonomike dhe funksioneve nga turizmi , shpesh përmendet edhe rëndësia e funksioneve jo ekonomike të cilat fillimisht grupohen në të ashtuquajturat aktivitete turistike në veprimtari rekreative ,shëndetësore kulturore ,zbavitëse,politike etj. Kjo do të thotë se funksionet e fundit nuk kanë ndonjë dinamik ekonomike profitabile në lidhje me kategorin e funksioneve ekonomike turistike. Kjo gjithashtu ka të bëjë edhe me proceset moderne me rritjen e lëvizjeve turistike, dhe kjo arrihet nëpërmjet aktiviteteve ekonomike të cilat kanë mundësi dhe potencial adekuat për tu mundësuar shërbime të nevojshme turistëve gjatë udhëtimit të tyre dhe turistëve në kohën e udhëtimit të tyre nëpër rrugët kryesore magjistrale nëpër vendin tone , me çka po të njëjtit mund të kalojnë disa ditë për pushim dhe rekreacion në lokalitetet afër rrugëve magjistrale të vendit tonë.

Që të arrihen qëllimet pozitive në profitabilitetin ekonomik nga turizmi tranzitor gjithsesi është e nevojshme që të intensifikohen investimet në turizmin e vendit tonë, ashtu siç bëhet në shumë vende kontinentale në Evropë dhe në Botë. Investimi si proces i patjetërsueshëm për rrethin më të gjërë të ndërmarrjeve të interesuara dhe kompanive turistike paraqet problem të caktuar , posaqerisht në lidhje me investimin në lokalitete turistike në të cilat akoma nuk janë të zgjidhura mardhënjet pronësore. Kjo me të vërtet paraqet problem , dhe të tilla probleme të ekzistojnë jashta viseve më të rëndësishme turistike të Maqedonisë , posaqerisht në fushgrupën e Ohrit –Strugës, ku aty paraqiten edhe problemi me të ashtuquajturën mafi urbane e cila uzurpon lokalitete jo të definuara në afërsi të bregut të liqenit .

Konsumi i turistëve qart mund të ndahet në atë të mbrendshëm dhe të jashtëm. Konsumi i jashtëm paraqet burim shtesë i mjeteve i që ndikon në rritjen e të ardhurave nacionale në regjionin turistik , dhe në tërë vendin, sepse kjo paraqet bartje të mjeteve nga një shtet tjetër , çka kontribon për forcimin e ekonomisë turistike.

Efektet pozitive ekonomike të konsumit turistik pa marrë parasysh se nga cila anë vijnë (nga turist te mbrendshëm apo të jashtëm) në rradh të parë kjo varet nga masa e turistëve dhe fuqia e tyre ekonomike , respektivisht potenciali i tyre për konsum turistik në vende turistike. Megjithatë duhet të cekin se numrin I madh dhe që përbëja turistët e huaj , sjellin edhe shumë të larta përfitimet të përgjithshme ekonomike. Nëse ndjekim e mjete të cilat vijnë nga viset eksterne dhe vendet që qarkullojnë në zona të posaçme turistike të Maqedonisë e rrisin mundësinë potenciale për finansim të mëtutjeshëm të veprimtarive turistike. Efektet indirekte të cilat lujn nëpërmjet mjeteve që i shpenzojnë turistët e huaj janë mjaft të rëndësishme për ndryshimin e strukturës turistike, jo vetëm në prodhimet, por edhe në fizionominë e zonës turistike apo të regjioneve. Tipologjia dhe kuantifikimi i efekteve ekonomike janë parametra të rëndësishme për bilansin e përgjithshëm të mjeteve në mjedisin lokal , por edhe për tërë vendin , të cilat reflektohen

në lidhje me dinamikën e nomenklaturës turistike të aktivitetëve për këtë veprimtari ekonomike.

Turizmi tranzitor sot për Republikën e Maqedonisë paraqet një potencial të ri dhe të rëndësishëm, sepse ajo mundëson pozitën e volitshme gjeostrategjike, gjeotranzitore të vendit tonë në suaza të Evropës juglindore. Tranzitimi i cekur i udhëtarëve dhe turistëve nga vendet Europës perëndimore dhe qendrore kah vendet e Lindjes së Afërt, pothuajse vazhdimshëm udhëtojnë nëpër vendin tonë, posaçërisht ato të cilët kanë vendosur të kalojnë pushimet vjetore në Greqi, ky aty bëjnë pjesë edhe një varg i udhëtimeve për ekskurzion, udhime për vikend, si nga vendi ynë nga vendet fqinje dhe e anasjelltas. Në dekadën e fundit Gjevgjelia me rrethinën e saj është në rritje të madhe dhe të rëndësishme për qytetarët dhe biznesmenet grek, duke i përdorur hotelet luksoze dhe kapacitetet për vendosje. Për qytetarët grek kjo veç më është një nevojë e përditshme, e posaçërisht gjatë kohës së vikendeve të cilat kryesisht i përdorin hapsirat e hotelit Flamingo në Gjevgjeli dhe objektet tjera në atë hapsirë në të cilën janë vendosur edhe salone të posaqme për lojra të llojllojshme etj.

Zhvillimi i turizmit tranzitor në vendin tonë është e lidhur ngushtë dhe me të ashtuquajturin turizëm urban, i cili ka të bëjë me shkallën e lartë të përdorimit të kapacitetëve për vendosje nëpër qytetet në të cilët kalojnë rrugët nderkombëtare magjistrale, dhe kualiteti i tyre përgjatë rrugëve magjistrale. Egzistojnë të dhëna se fitim më i madh ekonomik nga turizmi tranzitor ka qyteti i Shkupit si dhe qytete të tjera përgjatë rrugëve magjistrale. Megjithatë shoqëria jonë, respektivisht shteti dhe kapitali privat më shumë duhet të determinohet nga ky lloj turizmi, përshkak se efektet ekonomike janë mjaft të rëndësishme.

Modelimet e mëtutjeshme, projektimi dhe menaxhimi i turizmit tranzitor

Idea për modelimin dhe projektimin e shërbimeve turistike në ekonominë e vendit tonë është e patjetërsueshme përshkak të zhvillimit të turizmit tranzitor, si dhe ngritjen e aksioneve për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik. Në këtë drejtim inicoohen problemet që kanë të bëjnë me inicimin e shërbimeve për vendosje ose shërbimeve që kanë të bëjnë me informimin, rekreacionin, edukimin etj. Kuptohet këto aktivitete në mënyrë permanente janë të ndjekura me ndryshimet e rregullativës juridike dhe udhëheqjen e politikës turistike, organizimin e shërbimeve komerciale dhe shërbimeve për marketing me qëllim që të përmirësohet kualiteti i të gjitha llojeve të turizmit tranzitor.

Me interes të veçantë se oferta turistike duhet të ngritet edhe në fushën e bujqësisë dhe në llojet e prodhimeve bujqësore. Në shumë kompani turistike apo ndërmarrje, egzistojnë strategji të pamvarura për zhvillimin e aktivitetëve turistike të cilat mes tjerash parashikojnë një sërë aktivitetesh që kanë të bëjnë me zhvillimin e aktivitetëve primare të cilat kanë pika të përbashkëta në lidhje me prodhimet bujqësore të cilat harxhohen në masë të madhe në zonat dhe vendet turistike. Gjithashtu duhet të ceket se në turizmi tranzitor, përveç këtyre prodhimeve hyjnë edhe prodhime të tjera arti zanale, suvenire etj, të cilat i paraqesin shenjat nacionale të vendit tonë, mjedisin ambientel dhe kulturën e cila ka rrënjë të thella në historinë e egzistimit të civilizimit tonë në mesin e Gadishullit Ballkanik, kuptohet se faktorët ekonomik të cilët hynë në determinantet e lëvizjeve aktuale në veprimtaritë e shërbimeve dhe në sistemin e konsumit, të cilat

procese sjellin arsytim ekonomik dhe dobi ekonomike , respektivisht profitabilitet ekonomik. Në rrugët kryesore magjistrale të vendit tonë , posaçërisht ato bartëse të udhëtarëve dhe turistëve tranzitor , gjithësesi sot dhe në të ardhmen me menaxhim të mirfillt mund të kontribuojnë në revitalizimin e një varg rrjedhave pozitive të bilansit pagesor , e gjithashtu edhe në mënyrën e plotësimit të buxhetit shtetror , nëpërmjet përeaktimit të dhënave themelore të parashtruara me aktet pozitive të vendit tonë. Në çdo strategji të zhvillimit të turizmit tranzitor, duke marrë parasysh numrin e udhëtarëve dhe turistëve tranzitor të cilët i kalojnë kufijt maqedonas janë të mundshme definime strategjike të fitimit ekonomik.

Parashtrohet pyetje përse nevojitet menaxhimi dhe se sip o i njejtë mund të vëhet në funksion të realizimit të qëllimeve themelore në procesin e zhvillimit të turizmit në përgjithësi ,posaçërisht te turizmit tranzitor. Siç kemi konstatuar edhe më herët procesi i menaxhimit të turizmit tranzitor është me rëndësi të madhe duke pasura parasysh madhësin e qarkullimit të njerëzve në pikat kufitare të vendit tonë me vendet fqinje , në të cilën përparësi kanë katër pikat kufitare edhe atë Bogorodica në Gjevgjeli në kufirin Maqedono- Grek, Tabanovca në Kumanovë në kufirin Maqedono-Serb , Devbair në Kriva pallank në kufirin Maqedono –Bullgar dhe Qafë thanë në Strug në kufirin Maqedono-Shqiptar. Duhet të ceket se përveç këtyre pikave kufitare , qarkullim i madhe i njerëzve dhe mallrave kryhet edhe nëpërmjet pikave tjera kufitare ,mes të cilave dallohet Bllaca në kufirin Maqedono –Kosovar, Novo sello në Strumic në kufirin Maqedono Bullgar, Megjiliv në Manastir , Bllato në Dibër etj.

Në këto kushte , nëse pajtohemi me teorinë se menaxhmenti është aktivitet i cili është i determinuar kah arritja e qëllimeve të parashtruara , atëherë duhet të konstatojmë se nuk është lehtë që të bëhet një strategji për organizimin e këtij aktivitetit , përshkak se duke filluar nga definimi se menaxhmenti duhet të kuptohet si aktivitet i determinuar kah arritja e qëllimeve paraprakisht të vendosura , munde të thuhet se në thelb ai paraqet një kordinim bukur mirë organizuar dhe vendosje në disponim të gjitha të mirave materjale respektivisht të vendosen në disponim prodhimet dhe shërbimet me qëllim që të arrihen rezultatet e pritura. Menaxhmenti duhet të kuptohet si kordinim i problemeve që janë të vendosura para definimit të rrugëve më të shkurtëra në lidhje me realizimin e qëllimeve të parashtruara në zhvillimin efikas dhe racional të turizmit tranzitor , e me atë që të parashikohen edhe mjetet profitabile nga ky aktivitet. Sot në shumë vende evropiane edhe me gjerë , turizmi tranzitor paraqet aktivitet të rëndësishem ekonomik i cili kontribon për përmirësimin e standartit jetësor të atyre të cilët merren me këtë veprimtari të cilat jetojnë përkaj rrugëve kryesore strategjike. Kështu përshembull nëse analizohen vetëm shërbimet në suaza të turizmit i cili paraqet një nga shtyllat e rëndësishme të ekonomis në regjione turistike por edhe të tërë shtetit , kjo mundë të arrihet në qoftë se të punsuarit turistik të cilat i udhëheqin dhe i organizojn aktivitetet turistike duhet të vendosin përmbajtje të reja , kreativitet të përmbajtjeve në objektet shërbimore. Përveç asaj duhet të ceket

Duhet përmendur se kohëve të fundit nëpër vendin tone tranzitojnë një numër dhe kjo paraqet numër i madhë udhëtarësh nëpër vendin tonë, në kohën e fundit paraqiten edhe një lloj i turizmit tranzitor tjetër ajo është turizem stacionar. Kjo ka të bëj me udhëtarët dhe turistet nga evropa e zhvilluar , pensionierë , industrialist të mëparshëm dhe të pasur të cilët në moshë shprehin dëshir ti vizitojn jo vetëm qytete Maqedonase por edhe vendet në fqinjë, dhe ata janë mjaft të interesuar edhe për përmendoret historike ,

lokalitete arkeologjike, ngjarjet e ndryshme kulturore, manifestimet kulturore, simpoziumet nga fushat e ndryshme, ekskurzionet e studenteve dhe nxënësve, nga vendi dhe nga jashtë.

Turizmi tranzitor karakterizohet me osilime të shprehura sezonale. Kjo varet edhe nga masa e udhëtarëve të cilët ndodhen me punë të përkohshme në vendet euro-perëndimore dhe dëshira e tyre për të vizituar të afërmit të tyre në vendin e lindjes, si dhe nga numri i të punësuarve jashtë (nga Turqia , Greqia, Bullgaria etj), të cilët ndodhen me punë të përkohshme në vendet e përmendura të zhvilluara nga njëra anë dhe të turistëve nga ana tjetër. Kjo dinamik e lëvizjes së masës së udhëtarëve dhe turistëve në realizimin e shërbimeve turistike, posaqërisht shprehet në procesin e punës dhe në kapacitetin për vendosje për shërbime etj dhe paraqesin një nga bartësit më të rëndësishëm të ofertës turistike.

Gjendja e sotshme socio-ekonomike e qytetarëve të Maqedonisë, papunësia dhe problemet të tjera që kanë të bëjnë me aktivitetin e popullatës së përgjithshme tregojnë se rend pjesa më e madhe e popullatës të inkuadrohet në aktivitete turistike. Sipas disa analizave të bëra nga ana e entit shtetëror të statistikës numri më i madh i cili merr pjesë në udhëtim dhe në aktivitete turistike është nga qendrat urbane. Gjithashtu duhet të ceket fakti se për shkak të tyre dhe shkaqeve të tjera kapacitetet për vendosje që punojnë gjatë tërë vitit pësojnë osilime më të mëdha dhe më të vogla në përdorimin e kapaciteteve. Në gjendje më të vështirë janë numri më i madh i kapaciteteve hotelierike të cila sot e luajnë funksionin e kapaciteteve shërbimore sezonale. Këto objekte mundën me sukses të punonjë vetëm për gjysmën e vitit respektivisht gjatë sezonit turistik.

Intervencat për përmirësimin e këtyre problemeve shkohet kah promovimi i strategjive dhe politikave të reja në lidhje me shfrytëzimin e pushimeve vjetore dhe pushimeve shkollore, të turistëve tranzitor gjatë dhe jashtë sezonit etj. Në këtë drejtim për shfrytëzim jashtësezonial mund të nxiten grupet specifike të turistëve potencial sic janë turizmi i penzionerëve, i cili këtë vit ishte i promovuar nga ana e qeverisë së Republikës së Maqedonisë, pastaj turizmi social, shkollor, studentor, i cili gjithsesi duhet të ndiqet me politikën e çmimeve më të ulëta dhe përmbytjeve adekuat gjatë qëndrimit nga ana e agjensioneve turistike , ndërmarrjeve dhe kompanive turistike.

Të gjitha këto aktivitete gjithsesi kërkojnë aktivitete plotësuese si dhe aksione konkrete për shkak se specifika e punës hotelierike qëndron në qasjen në treg , çka shpesh here në kushtet tona nuk korenspondojnë me fuqinë reale ekonomike të klientelës turistike. Prej këtu si nevojë rrjedhin aktivitetet nga ana e punëtorve turistik të kyqen në këtë aktivitet ndërmjetësues të numërt, që të mund të vendosin marëdhënje sa më të komplementuar mes ofruesit dhe konsumuesit të shërbimeve turistike. Sot në Republikën e Maqedonisë këto aktivitete i zhvillojnë i avansojnë dhe i realizojnë në mënyrë direkte apo indirekte agjensionet turistike , organizatorët e udhëtimeve , menaxherët turistik apo ndonjë tjetër agjension e cila më mirë i njeh përparësit dhe ligjshmërit e tregat vendor dhe atë të jashtëm turistik.

Nevojat për një kontakt indirekt janë të cekura edhe nga kompleksiteti i prodhimit turistik në përgjithësi. Ndërmjetësuesit e krijojnë kompoziumin e përgjithshëm me shërbime të tjera ndjekse dhe shtesë me çrast oferta turistike bëhet me atraktive për konsumatorët. Me këtë u jepet hapësirë dhe kohë prodhuesve të këtyre shërbimeve për koncentrimin sa më të madh në punën e tyre. Që të realizohet kjo strategji dhe politikë duhet të kihen parasysh këto aktivitete organizative:

Planifikimi është funksion themelor dhe përfshin vendosjen e qëllimeve dhe aksioneve për realizimin e tyre. Me fjalë të tjera plani përfshin themelimin e asaj që duhet të bëhet dhe mënyrën më të mirë që të bëhet. Rëndësia e egzistimit të këtyre funksioneve janë qartë të pranuar në menaxhimin e ekonomisë rurale turistike. Në këtë drejtim kontrollimi do të thotë që të merren hapa të suksesshme rreth planifikimit me qëllim të përcaktimit të perceptcionit real të karakteristikave të tyre në lidhje me qëllimet dhe përfundimisht të definohen aktivitetet dhe masat që janë të nevojshme për arritjen e qëllimeve dhe tejkalimin e problemeve të identifikuar.

Planifikimi i zonave rekreative brenda dhe jashtë vendbanimeve paraqet komponent të rëndësishme në politikën e rregullimit hapsinor. Zonat rekreative konsiderohen si pjesë e zonave qytetare, më saktë për zonat periferike dhe luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe social të qytetit. Rëndësia e tyre themelore ka të bëjë me përmirësimin e mikro klimës dhe gjendjes sanitare të ajrit mbi qytet dhe mundësojnë rekreacion masovik të popullatës qytetare. Gjatë planifikimit dhe diferencimit të zonave rekreative nisët nga këto principe:

- ndarja e zonave për rekreacion
- ndërtimi i lidhjeve gjerë tek vendet rekreative
- koncentrimi i shërbimeve turistike rekreative
- zgjedhja e zonave rekreative në afërsi të rrugëve dhe vendbanimeve,
- zonat rekreative dhe shërbimet që në të do të realizohen të jenë bazë nxitëse për aktivizimin e zonave tjera
- mbrojtja gjeoekologjike e mjedisit jetësor.

Duhet të ceket se karakteristika themelore të regjioneve turistike, zonave dhe vendeve duhet të jenë në gjendje të plotësojnë nevojat rekreative të turistëve.

Në literaturën moderne turistike, sipërfaqet rekreative kryesisht klasifikohen në 5 kategori:

- sipërfaqe me kushte më të volitshme për rekreacion
- sipërfaqe me kushte mjaft të volitshme për rekreacion
- sipërfaqe të volitshme për rekreacion
- sipërfaqe me kushte të vogla për rekreacion
- sipërfaqe të pa volitshme për rekreacion

Kështu përshembull në planin hapsinor të kryqytetit të Shkupit në mes tjerash qëndron edhe fakti se, gjerë sa ndarja e sipërfaqeve kryesisht bëhet në bazë të inventarizimit dhe valorizimit të elementeve në disponim atraktivo rekreative, përcaktimi i kapaciteteve për vendosje, numri i vizitoreve akoma nuk ka disa principe në përgjithësi të pranuar. Ai numër kryesisht përcaktohet në bazë të përqindjes së caktuar nga numri i përgjithshëm i popullatës që mund të paraqitet në ndonjë zonë ose në bazë të shkallës së parashikuar të përdorimit të mundshëm të kapacitetit rekreativ në atë zonë. Në rastin e parë për shembull në planin hapsinor të Shkupit është e parashikuar kur qyteti të arrijë madhësinë prej 460 mij banorëve të pritet sipërfaqe rekreative në ditët e vizitës maksimale të përdorin rreth 150 mijë vizitor. Nga ky numer 140 mijë vizitor parashihet të jenë banorë të qytetit kurse 10 000 të tjerë të jenë nga vendet tjera.

Organizimi do të thotë aktivitet dhe funksion i cili duhet të zgjedhë dhe të organizojë aktivitetet e nevojshme me qëllim që të vendosen marrëdhënie në realizimin dhe zbatimin e detyrave të parashtruara. Për dallim nga kompanit më të mëdha ku organizimi e përcakton madhësin dhe kompleksitetin e organizatës, në rast të funksionit turistik rural

organizimit duhet ti bëhet qasje më ndryshe për dallim nga mjediset qytetare, e shumë më ndryshe në hapsirat për gjatë shtrirjes së rrugëve magjistrale me karakter ndërkombëtar.

Menaxhimi me aktivitetet e turizmit në politikën e ekonomisë turistike, turisti tranzitor ka nevojë për shumë shërbime. Segmenti i zbatimit të aktiviteteve të caktuara të cilat e krijojnë vlerën e shtuar , gjithësesi fillon me vendimin që të udhëtojnë , me çka vihen në funksion të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me organizimin e aktiviteteve turistike të turistëve tranzitor. Edhe udhëtari tranzitor ka nevojë që të informohet për destinacionet turistike për shërbimet për fjetje për ushqim , për pije, përdorimi i programeve të ndryshme etj. Furnizuesit e shërbimeve të turizmit tranzitor ndikojnë në të gjitha fazat dhe pjesët në zhvillimin e turizmit tranzitor , procesi i cili qartë është i definuar si kënaqësi e përgjithshme për klientin. Kështu për shembull vetëm me disa përjashtime kualiteti i shërbimeve për turistët në drejtime trafikore kryesore ndërkombëtare si dhe në drejtimet regjionale nvalet nga informatat që i ka në disponim , mundësit për tu furnizuar me shërbime të ndryshme , infrastruktura turistike e rrugës kah destinacioni etj. Standardizimi i kualitetit të objekteve dhe shërbimeve janë vetëm disa nga format e mundshme të cilat do të kontribuojnë në rritjen e kualitetit të ofertës turistike dhe rezultateve financiare. Këto aktivitete përfshijnë marketing , shitje dhe informata ,aktivitete për bashkëpunim të mundshëm në krijimin e websajteve të posaçme , pastaj udhëheqësve (harta të ndryshme) ,promosimi i prodhimeve lokale, ndjekja e nevojave të turistëve ,reklamimi i përbashkët i hoteleve, zhvillimi i promociioneve speciale për tur operatorët dhe grupet ,kordinimi i sektorit privat dhe publik, përdorimi i prodhimeve lokale dhe kuzhinave lokale , prezentimi i prodhimeve të shumta etj.

Udhëheqja paraqet funksion të rëndësishëm të menaxhmentit dhe në të duhet të kyqen të gjithë kryerësit, fillimisht menaxheri është ai që kyqet në procesin e realizimit të shërbimeve ose realizimit të qarkullimit të prodhimeve dhe shërbimeve që janë të ndryshme të nevojshme për turistët. Udhëheqja, përveç tjerash përfshin edhe procesin e motivimit dhe komunikimit ndërsa menaxheri duhet të ketë shkathësi për përdorimin racional dhe ekonomik të të gjitha aktiviteteve lidhur me menaxhmin.

Kontrollimi duhet të kuptohet si funksion themelor i menaxhmentit dhe i cili i bashkon të gjitha detyrat më parë të parashtruara me realizimin e qëllimeve. Me anë të kontrollimit duhet të kuptojmë se këtu përfshihen karakteristikat themelore për krahasimin e rezultateve të arritura respektivisht sipas planit të përcaktuar për realizim, si dhe reagim të shpejtë në mangësit eventuale gjatë procesit të zbatimit të aktiviteteve ose rreth organizimit të punës në rritjen e standardeve të parashtruara dhe të planit vjetor apo sezonal.

Menaxherët të cilët e zbatojnë planin dhe strategjin e parashtruar për organizimin dhe kontrollën e zhvillimit të turizmit, posaçërisht si në shembullin tonë të turizmit tranzitor , duhet të bashkëpunojnë me më shumë faktorë si brenda në vend ashtu edhe jashta me qëllim që të avansohen dhe në mënyrë më kualitative të zbatohen detyrat e parashtruara , si dhe analizimin dhe kontrollimin e fitimit financiar nga tërë kjo. Në këtë drejtim është e qartë se nuk mund të ketë rezultate pa realizimin e fitimit financiar nga ky aktivitet.

Kontrolla e kualitetit është një nga karakteristikat më të rëndësishme dhe elementet e menaxhimit të cilat janë orientimi themelor në planin afatgjatë në realizimin e fitimit financiar. Kjo është e nevojshme që të krijohet kapital i caktuar me qëllim që të ngritet në

nivelin sa më të lartë funksionimi turistik me qëllim të plotësisimit të nevojave të turistëve tranzitor.

Zhvillimi intenziv i turizmit (të gjitha llojet e aktivitetit turistik) mundëson zhvillimin edhe të aktiviteteve të tjera ekonomike dhe jo ekonomike. Sot në shekullin 21, i cili karakterizohet si kohë për zhvillimin e fuqishëm teknologjikë industriale, automatizimin dhe urbanizimin e përsheptuar në njërën anë, paraqiten disa procese negative siç janë zgjerimi hapsinor i sipërfaqeve të punuara (Shkupi, Kumanova, Veles, Tetova, Manastiri) kurse ana pozitive e kësaj vërehet nga aspekti i prodhimit të ushqimit të shëndetshëm, kontrollimi më i madh sanitarë i produkteve bujqësore dhe produkteve të tjera si nga vendi ashtu dhe nga jashtë, klasifikimi i tyre për shpenzim më të gjerë, ambalazhimi modern , standardet hallall dhe hasap etj. Gjithashtu duhet të cekim se në Maqedoni ndërmiren një varg i aktiviteteve në lidhje me mbrojtjen e prodhimeve nëpërmjet sistemit të zhvillimit, efektuimit të prodhimeve dhe modernizimin e ambalazhës për paketim të të njejtëve etj.

Mënyra moderne e jetës dhe profesionalizimi i një varg veprimtarive ekonomike dhe jo ekonomike e kanë ndryshuar aktivitetin fizik të njeriut. Sot, lirisht mund të themi se është koha e marrëdhënjëve të fuqishme njeri – teknologji, njeri – automatizim, koha e kompjuterizimit të prodhimitarëve me çka njeriu lirohet nga aktivitetet fizike. Megjithatë për shkak të kësaj dinamike të ndryshimeve të njeriut kah proceset prodhuese, tek njeriu paraqitet një ngarkesë më e madhe psikike, ku së bashku me ndotjen e mjedisit jetësor në mënyrë jo të vulltshme ndikojnë në organizimin e njeriut dhe tendenca e cila vazhdon me një dinamikë akoma më të madhe.

Nga vetë shema për formimin e strategjisë klasike, për zhvillimin e aktiviteteve turistike vërejmë se fillimisht kërkohet formulimi i qëllimeve, detyrave, aktiviteteve etj, me qëllim që sa më lehtë, me racionalisht dhe në mënyrë më ekonomike që të merren me qëllimet dhe detyrat e parashtruara në lidhje me implementimin e tyre. Duket filluar nga këto gjykime rekreacioni konsiderohet si pjesë aktive e procesit turistik dhe i cili direkt ndikon në jetën organizative të njeriut modern. Ajo në thelb paraqitet si dukuri moderne e cila është e menduar, organizuar dhe me plan e zbatuar për pushimin aktiv të njeriut nëpërmjet aktiviteteve të zgjedhura në mënyrë të pavarur. Përshkak të kompleksitetit të rekreacionit, turizmi në përgjithësi, e posaçërisht turizmi tranzitor në procesin e vendosjes së nevojave objektive duhet të merren parasysh edhe këto parime të llojeve respektivisht ndarje edhe atë sipas formës: rekreacion pasiv dhe aktiv, sipas kohës së realizimit në: rekreacion, gjat vikendeve dhe rekreacion vjetor; sipas vendit të realizimit: në vendin e banimit të punës dhe jashtë vendbanimeve; sipas formës organizative në rekreacion individual dhe masovik etj.

Ndikimi i turizmit tranzitor në bruto prodhimin nacional dhe zhvillimin e ekonomisë turistike

Turizmi është bërë një nga aktivitetet ekonomike më interesante, i cili ngusht është i lidhur me faktor të shumtë si për nga baza natyrore ashtu edhe për nga llojlloshmëria shoqërore socio - kulturore. Investimet turistike në kohët më të reja janë të patjetërsueshme por në të njëjtën kohë edhe problem në qoftë se po të njëjtat nuk mund të kthehen në kohën e parashikuar nga ana e investitorit, me qëllim që të ndërmerren hapa

të mëtejshëm për rumbullaksim e aktiviteteve të përgjithshme në lidhje me modernizimin, efikasitetin, si dhe ngritjen e fitimit ekonomik nga aktiviteti i njejtë.

Për efikasitet më të madh dhe tërheqje të udhëtareve dhe turistëve tranzitor të cilët kalojnë nëpër vendin tonë nëpër koridoret kryesore është me rëndësi jo vetëm të definohet strategjia për zhvillim të këtij lloj turizmi por edhe të planifikohet dhe të zbatohet në të njëjtën kohë procesi i modelimit dhe definimit të objekteve infrastrukturore të dedikuara për këtë lloj turizmi, me qëllim të tërheqjes sa më të madhe po të njejtëve për harxhimin e mjeteve të tyre materiale.

Me qëllim të njoftimit sa më të mirë të gjendjeve dhe trendit të transformimit të disa njësive të posaçme hapsinore përkaj rrugëve magjistrale të cilat kalojnë nëpër vendin tonë, e të cilët janë të ngarkuara me turist dhe udhëtar tranzitor, të cilët udhëtojnë me vetura të lehta autobus etj, është e patjetërsueshme që fillimisht të bëhet inventarizimi i objekteve të tanishme, të konstatohet gjendja e tyre, të përcaktohen funksionet e veprimtarisë së tyre, asortimani i shërbimeve, formimi i bankës me të dhëna rreth funksionit të tyre të tanishme, e nëpërmjet asaj gjithësesi duhet të bëhet program aksionar operativ për transformimin e objekteve të tanishme nëpërmjet renovimit dhe ndërtimit të objekteve tërësisht të reja të dedikuara për këtë lloj turizmi.

Turizmi më shpesh definohet si shumë e marrdhënjeve dhe ngjarjeve të cilat rrjedhin nga udhëtimi dhe qëndrimi i vizitorëve nga vendet tjera, nëse gjatë këtij qëndrimi nuk bazohet qëndrim i përhershëm dhe nëse po të njejtit nuk lidhen me qëndrim për kryerjen e aktiviteteve ekonomike.

Gjatë investimit në turizëm në shumë raste dominojnë karakteristikat ekonomike. Konsumi turistik paraqet lloj të posaçëm dhe i njëjti karakterizohet me varg specifikash. Me rëndësi është të ceket se turizmi nuk harxhohet por edhe nuk shitet dhe si ndonjë produkt tjetër, nga shkaku se nga njëra anë paraqitet turisti si konsumator e nga ana tjetër paraqiten një varg veprimtarish të cilët e përbëjnë shërbimin turistik. Oferta turistike bëhet nga shumica e shërbimeve dhe prodhimeve të llojllojshme prej ku rrjedh se turizmi direkt manifestohet në shpenzime e jo në prodhimin e produkteve të caktuara.

Tregu turistik është i lidhur ngusht me konsumatorët, me një spektër të komplikuar të prodhimeve dhe shërbimeve të llojllojshme me cka përbëjnë shërbim të veçantë turistik.

Pajtueshmëria hapsinore e investimeve për zhvillimin e turizmit tranzitor sipas resurseve natyrore dhe shoqërore në rrugët kryesore të vendit.

- politika hapsinore duhet të mundësojë një zhvillim dhe konkurrencë të ekonomisë turistike, respektivisht ekonomisë e cila do të plotësojë nevojat e klientelës turistike
- zhvillimi turistik duhet të jetë i përhershëm në raport me resurset me të cilat disponon një tërësi e caktuar gjeografike
- përcaktimi i prioriteteve themelore në pajtueshmëri me zhvillimin e përgjithshëm regional, me cka do të përfshiheshin edhe njësi të veçanta hapsinore përgjatë rrugëve magjistrale të Maqedonisë.

Turizmi si veprimtari ekonomike, hyn thellë në të gjitha sferat e jetës ekonomike dhe shoqërore dhe në mënyrë direkte apo indirekte në nomenklaturën e së cilës bëjnë pjesë gjithësej apo ndaras: shërbimet për mikpritje, trafiku, agjensionet turistike, tregtia me pakicë dhe llojet e ndryshme komerciale. Duhet të cekim se në suaza të veprimtarisë turistike posaqërisht të turizmit tranzitor hyjnë edhe një numër i madh aktivitetesh jo ekonomike, kulturo artistike, sportive dhe manifestime të tjera, si dhe organizata të llojllojshme turistike dhe organe të karakterit lokal regional, nacional dhe ndërkombëtar.

Sipas rezultateve nga qëndrimi i turistëve vendor dhe të huaj në lokalitete turistike të vendit tonë rrjedh se mbizotërojnë turistët vendor si për nga numri i tyre ashtu edhe për nga fjetja e tyre. Numri i përgjithshëm i turistëve në vitin 2007 është 10,9 % në krahasim me vitin 2003, kurse numri i përgjithshëm i fjetjeve të realizuara është në rritje për vetëm 0,6 %. Siç kemi cekur, dallime egzistojnë edhe sipas strukturës dhe se prej nga vijnë turistët kështu : turistët vendor marrin pjesë me 57,1% kurse turistët e jashtëm me 42,9%. Nga ana tjetër raporte të ngjajshme egzitojn edhe në strukturën e realizimit të fjetjeve. Kështu përshembull turistët vendor në realizimin e fjetjeve kanë marrë pjesë me 74,3 % , kurse turistët e huaj me vetëm 25,7 %.

LITERATURA

1. Andonovski, T. & Malevski, I. (2001): Geomorfolo[ki karakteristikimi na Kumanovskata Kotlina, Geografski razgledi, kn.36, MGD, Skopje, 39-41.
2. Allmendinger P., Prior A., Reamaekers J.(2000): Introduction to Planing Practice, Willey, Chichester.
3. Budinski, M. (1998): Prirodnite resursi edni od osnovnite determinanti vo odreduvaweto na optimalen region za razvoj na turizmot. Zbornik od trudovite na Meunarodniot nau-en sobir "Perspektivi i unapreduvawe na planiraweto i ureduvaweto na prostorot", Ohrid: Ministrstvo za urbanizam, grade'ni[tvo i za[tita na `ivoinata sredina.
4. Dimovski, A.(1968): Biogeografski i ekolo[ki karakteristikimi na Skopska Kotlina. God. zbo. na PMF,
5. Daskalovski, V.(1999): Demografskiot razvoj na ruralnata populacija vo Skopskata kotlina, Godi[en zbornik na PMF, Institut za geografija, Skopje
6. Gerasimovski, D., (2002): Razvoj i dene[ni karakteristikimi na turizmot vo Republika Makedonija. Magisterski trud. Skopje.PMF, str.64.
7. DZS: Kapaciteti za smestuvawe vo ugostitelstvoto, sestojba 01. 08. 2006 godina.
8. Gramatnikovski, V.(1976): Razvoj na soobrajajot I turizmot vo Prespanskata kotlina, Godi[en zbornik, kn.22, Skopje
9. Ga[evski M (1979): Osnovni hidrografski osobenosti na glavnite pritoki na Vardar vo SRM, Geografski razgledi kn. 17, Skopje.

10. Gali], R.(1968): Skopje-Urbanisti-ki plan, Skopje.
11. Godfrey K., Clarke J. (2000): The Tourism Development Handbook, Cassell, London.
Joint transport Committee European community-R. Macedonia, Sixs meeting. Ministry of Transport and Communication Brussels, 12 May 2004.
12. Karaman, S.(1931): Zoolouke prilike Skopske Kotle, Glasnikl Skopskog Nau-nog Druutva, kw.X, Skopje.
13. Karaman, S.(1937): Fauna Ju`ne Srbije. Spomen. dvadesetpetgod. oslob Ju`ne Srbije, Skopje.
14. Lazarevski, A.(1993): Klimata na Makedonija, Kultura, Skopje
15. Lazarevski, A.(1971): Klimata na Makedonija-vrne'i vo SR Makedonija, Geografski razgledi, kn. 8-9, Skopje.
16. Lazarevski, A.(1972): Klimata na Makedonija-re'im na vetrovi vo SR Makedonija. Geografski razgledi, kn.10, Skopje.
17. Lukovi], M.(1938): Geolouki sostav i tektonika isto-nog dela planine Crne gore (Karadaga). Vesnik Geol. inst, kr. Jug. kw. VII, Beograd.
18. Manakovi], D., et al.(1998): Tolkuva- za geomorfolouukata karta na Republika makedonija, Skopje,
19. Markovi], V.(1957): Paleografski odnosi dijabaz-ro'na-ke formacije trijaske i jurske starosti na teritoriji Srbije i Makedonije. II Kongres geol. Jugosl. Sarajevo.
20. Panov, N. (1998): Turisti-ka varorizacija na manastirite vo Republika Makedonija, Bato i Divajn, Skopje.
21. Prostoren plan na Republika Makedonija, Skopje, 1998.
22. Panov, N., (1989): Turistp-ka valorizacija na Tikvef koto ezero. Sojuz na geografskite zdru'snija na SR Makedonija. Geografski razgledi, knjiga 27, Skopje. str. 1 17.

TRENDËT NË ZHVILLIMIN E TURIZMIT DHE HOTELERISË NË KOSOVË

Hysen Sogojeva

Abstrakt

Në këtë punim janë analizuar faktorët determinues të zhvillimit, që janë bazë për zhvillimin e ofertës turistike, duke përfshirë të gjitha elementet, që janë me rëndësi për kushtet dhe rrethanat e vendit tonë, me qëllim të plotësimit të standardeve turistike. Turizmi në vendet e zhvilluara, por edhe në disa shtete në tranzicion është produkt i rëndësishëm eksporti dhe gjenerator i punësimit. Zhvillimi i turizmit në ekonominë e një vendi mund të ketë ndikime të drejtpërdrejta, indirekte dhe multiplikative. Funksionet konverzive të turizmit, dhe të mirat e caktuara materiale ku bëjnë pjesë disa faktorë të shquar si: detet, liqenet, malet, shpellat, pyjet, zonat natyrore të gjera, burimet termominerale, ishujt dhe problematika turistike mund të themi që paraqet një rrafsh kompleks të pakufizuar të shkaqeve të cilat ushtrojnë ndikim si në fazën fillestare të fenomenit në hapësirë, ashtu edhe në fazën e metutjeshme zhvillimore, pa mundësi të parashikimeve të përfundimit në suaza botërore. Shkalla gjithnjë më e lartë e zhvillimit shoqërore-ekonomik dhe në përgjithësi e standardit jetësor e njerëzve, kanë krijuar kushte për zhvillimin e turizmit kështu që potenciali i shfrytëzuesve krijon kushte për masivizimin gjithnjë më të madh të çarkullimeve turistike në bote duke formësuar dhe rritur vlerën e tij në rrafshin shoqëror dhe ekonomik.

Fjalë kyçe: Turizmi, determinantet e turizmit, Kosova, Wto-ja, Sustainable, tregu turistik, ofertë turistike

Hyrje

Zhvillimi i turizmit në Kosovë është i lidhur ngushtë me faktorët determinues, të cilët ndikojnë qarkullimin turistik. Faktorët determinues kryesor që ndikojnë në zhvillimin e trendëve turistike janë:

- Pozita gjeografike e Kosovës, me vendet fqinje, sidomos me të cilat lidhet me rivierën e detit Egje dhe Adriatik.
- Pozita qendrore e Kosovës me Gadishullin Ballkanik, paraqet përparësi dhe ndërlidhje me vendet e regjionit, në të cilat ndërtimi i rrugëve është në evolucion.
- Zhvillimin e turizmit malor me të gjitha specifikat,
- Potencialet të mëdha turistike, të cilat vetëm duhet shfrytëzuar
- Shfrytëzimi i kapaciteteve receptive dhe përmirësimi i kushteve, sipas standardeve turistike, dhe vënia e tyre në funksion të ofertës turistike.
- Begatitë e shumta kulturore dhe historike.
- Zhvillimi i turizmit bazohet në burimet atraktive të kësaj hapësire të cilat paraqesin resurse burimore të tij në anën tjetër oferta sekondare turistike e plotëson ofertën burimore duke mbështetur tekniken e aktivitetit turistik.
- Tregu turistik përcakton masën e nevojave turistike rekreative, kulturore dhe zbavitëse të cilat nuk janë elemente dhe faktorë ekonomikë. Tregu turistik i përket sektorit terciar, sepse edhe vetë turizmi i takon këtij segmenti të aktivitetit njerëzor.

Vlerat turistike të Kosovës përbëjnë numër relativisht të madh të motiveve, si për nga heterogjeniteti po ashtu edhe për nga prejardhja. Motivet e pasura turistike dhe pozita (radhitja) adekuate (e përshtatshme) e tyre në mënyrë lineare dhe grupore dëshmojnë se territori i Kosovës paraqet motive specifike turistike e cila përbëhet prej ulëtësirës së Kosovës dhe rrafshit të Dukagjinit dhe motiveve të Sharrit, Bjeshkëve të Nemuna (Alpeve Shqiptare) dhe bjeshkëve të Kopaonikut.

Zhvillimi i trendëve turistike dhe hoteliere ne Kosovë

Turizmi është një nga veprimtaritë më komplekse të shoqërisë së sotme moderne. Në vendet e zhvilluara, por edhe ne disa shtete në tranzicion është produkt i rëndësishëm eksporti dhe gjenerator i punësimit. Përfshinë një gërshetim të gjerë dukurish dhe raportesh që lindin gjatë kohës së udhëtimit turistik, ndërsa në realizimin e tij futet thellë jo vetëm në aspektin ekonomik, por edhe në aspektin ekologjik, social dhe kulturor të jetës.

Turizmi është një nga veprimtaritë më komplekse të shoqërisë së sotme moderne. Në vendet e zhvilluara ai ka marrë formën e një industrie të plotë, me të cilën ndërveprojnë dhe janë të lidhura ekonomia, politika, kultura dhe të gjitha veprimtaritë njerëzore.

Në bazën e rëndësisë ekonomike të turizmit ndodhet konsumi i turistëve në vendet që vizitojnë. Zhvillimi i turizmit në ekonominë e një vendi mund të ketë ndikime të drejtpërdrejta, indirekte dhe multiplikative. Në lëmin e ndikimeve direkt që bën turizmi në ekonomi, ndër më të rëndësishmet janë ndikimi në produktin shoqëror dhe të ardhurat nacionale; në zhvillimin e veprimtarive ekonomike që përbëjnë ekonominë turistike (hoteleria, transporti, tregtia, institucionet kulturore, për argëtim, etj.); në inkuadrimin e banorëve në punë dhe nivelin e standardit të jetësor; në aktivitetin investiv dhe strukturën e investimeve; në ekuilibrimin e shkëmbimeve me jashtë; dhe në zhvillimin e vendeve dhe rajoneve të pazhvilluara.¹

Turizmi ka edhe efekte indirekte, sidomos në ato veprimtari ekonomike, të cilat nuk marrin pjesë në shërbimet direkt të vizitorëve, por furnizojnë ekonominë turistike. Këto ndikime shfaqen para se gjithash, në veprimtari të ekonomike siq janë: bujqësia, ndërtimtaria, industria, rrjeta e madhe tregtare, etj.

Funksioni konverziv i turizmit paraqitet me ndikimin e ti ne rrafshin e përfshirjes te shume pasurive te cilat nuk jane ne pergjithësi te karakterit te mallrave qe kane vlera ekonomike, por ai mund te inkuadrohet ne procesin ekonomik. Ne këtë funksionet konverzive te turizmit konvertohen ne faktorë si resurse ekonomike.

Me funksionet konverzive te turizmit faktorët ne fjale paraqesin "mallrat", apo te mira te caktuara materiale ku bëjnë pjese disa faktorë te shquar si: detet, liqenet, malet, shpellat, pyjet, zonat natyrore te gjera, burimet termominerale, ishujt etj. Kuptohet qe ne formimin e këtyre te

¹ Dr. M. Gashi, Vepra: "Bazat e Turizmit" Universiteti i Kosovës, Prishtinë, 1986

mirave natyrore nuk ka qene e angazhuar puna e njerëzve. Por,veprat artistike respektivisht monumentet kulturore-artistike te cilat njerëzia i ka krijuar,ne turizëm mund ta gjejnë valorizimin e tyre ekonomik,kuptohet bazuar ne vlerësimet reale te tyre.

Si kategori shoqërore turizmi paraqet një aktivitet te kategorisë shoqërore-ekonomike i cili i nënshtrohet studimeve interdisciplinare shkencore dhe asaj praktike. Zhvillimi i turizmit bazohet ne burimet atraktive te ndonjë hapësire te cilat paraqesin resurse burimore te tij ne anën tjetër oferta sekondare turistike e plotëson ofertën burimore duke mbështetur teknikën e aktivitetit turistik.

Problematika turistike mund te themi qe paraqet një rrafsh kompleks te pakufizuar te shkaqeve te cilat ushtrojnë ndikim si ne fazën fillestare te fenomenit ne hapësire,ashtu edhe ne fazën e metutjeshme zhvillimore, pa mundësi te parashikimeve te përfundimit ne suaza botërore. Në konstelacion te paraqitjes ne suaza botërore turizmi tregon kahe te përqendrueshme për te gjitha kohërat ne avenirin e botes. Mu për këtë dukur te qëndrueshme ka fituar epitetin Sustainable (ang i qëndrueshëm) ose Souttenable(freng.)² Si kategori shoqërore turizmi paraqet një aktivitet te kategorisë shoqërore-ekonomike i cili i nënshtrohet studimeve interdisciplinare shkencore dhe asaj praktike. Zhvillimi i turizmit bazohet ne burimet atraktive te ndonjë hapësire te cilat paraqesin resurse burimore te tij ne anën tjetër oferta sekondare turistike e plotëson ofertën burimore duke mbështetur teknikën e aktivitetit turistik.

Shkaku dhe qëllimi i këtij fenomeni kryesisht përqendrohet ne vete njeriun-turistin,te cilin shkencat turistike e ka pagëzuar Homoturisticus,si vizitor specifik i dëshirave dhe i sjelljeve te cilit i nënshtrohet i tere mekanizmi turistik sidomos ai i agregatit te ofertës turistike.³ Ne këtë drejtim përkatësisht njeriu behet blerës dhe konsumatore i shërbimeve dhe i prodhimeve turistike.⁴

Shkalla gjithnjë me e larte e zhvillimit shoqërore-ekonomik dhe ne përgjithësi e standardit jetësor e njerëzve, kane krijuar kushte për zhvillimin e turizmit kështu qe potenciali i

¹ Dr.M.Gashi , Vepra: "Bazat e Turizmit"Universiteti i Kosovës, Prishtinë, 1986

² M. Gashi , Vepra: "Vlerat turistike ne Kosove" Plani regji hapësitor i KSAK Prishtinë 1969

⁴ N. Muhaxheri,Vepra : Ekonom dhe Menaxhmenti në Turizëm-Prishtinë 2005.

shfrytëzuesve krijon kushte për masivizimin gjithnjë më të madh të qarkullimeve turistike në bote duke formësuar dhe rritur vlerën e tij në rrafshin shoqëror dhe ekonomik.

Masivizimi i qarkullimeve turistike në botën aktuale është sidomos i dalluar edhe para 20 viteve të shekullit të kaluar. Sipas WTO-se, vizioni i turizmit botëror në periudhën e ardhshme deri në vitin 2020, edhe pse parashikohen trendet e mundshme negative në zhvillimet ekonomike në pjesët e ndryshme të botes, turizmi do të tregojë gati gjithnjë një rritje me oscilime të vogla negative. Shkak kryesor i trendit pozitiv, përqendrohen në faktin se në botën aktuale jetojnë rreth shtatë miliardë njerëz të cilët frekuentojnë mundësitë e krijuara të zhvillimit enorm sidomos rritjes së zhvillimit të industrisë së mjeteve të transportit të cilat lidhin gati të gjitha pikat gjeografike të botes. Në anën tjetër ky masivizim i industrisë së mjeteve të transportit ka ndikuar në pikëpamjen e ndërtimit të llojeve stacionare të objekteve receptive turistike prej atyre rurale deri në ato luksoze marramendëse neper bote. Qarkullimet turistike sot në bote i takojnë 51% pushimeve të rekreacionit dhe fundjavës, 27% të arsyeve shëndetësore, fetare, 15% bizneseve dhe atyre profesionale. Sipas WTO-se prej 50 milionë udhëtimeve në 1950, në vitin 2010 ka arritur në 930 milionë kurse, në vitin 2020 parashikohet që do të arrijë në 1.6 miliardë udhëtare turistike, me një shkallë mesatare mbi 5% rritje gati në çdo vit dhe parashikimeve për 1 deri në 3% më i lartë se bruto prodhimi shoqëror. Turizmi gjithnjë do të ketë virtytet e zhvillimit ekspansiv dhe disperziv në mbare botën dhe ky epitet i tij do të mbetet si fenomen botëror i quajtur SUSTENABLE.

Vlera turistike si kuptim i shfrytëzimit të një ambienti të ruajtur natyror paraqet një pasuri determinonte natyrore, e cila mund të konsiderohet si vlerë ekonomike e rrallë, sidomos në kushtet aktuale jetësore të degradimit masovik të natyrës në mbare globin tokësor. Në mënyrë kauzale, për arsye mirë të njohura të shkalles së ndryshimeve klimatike në bote, fondi i ruajtur i shume hapësirave në bote tregon zvogëlimin në shkallë substanciale të kushteve në hapësira për zhvillimin e turizmit.⁵

Në këtë situatë shkalla e atraktivitetit turistik i shume hapësirave tregon në bote degradim të ambienteve natyrore.

Ndikimin degradues i proceseve të natyrës së ruajtur mjerisht, gjithnjë më tepër, mund ta presim në të ardhmen edhe nga ndikimi i turizmit, më tepër edhe për arsye të mungesës kulturore të

⁵ S. i Z. Marković, Vepra: "Ekonomika turizma", Zagreb, 1967.

klienteles turistike, por edhe mungesës shoqërore-politike për rregullativat urbanistike, planifikimin hapësinor të duhur për zonat ambientale turistike ku humbet funksioni rekreativ turistik i qendrës ambientale.

Këto procese negative me herët, janë manifestuar edhe në Evropë madje edhe në SHBA, Kanada etj, por aty janë ligjet e rrepta dhe rregullativat laksative, ligjore për kushte të ndërtimit të objekteve për turizëm dhe rekreacion. Pra sot kërkohet angazhim shumë i madh në rrafshin e investimeve në nivele shtetërore dhe ndërkombëtare, në domene shkencore, teknike, teknologjike dhe politike shoqërore-ekonomike të secilit vend të botës.

Vlerat turistike të Kosovës përbëjnë numër relativisht të madh të motiveve, si për nga heterogjeniteti po ashtu edhe për nga prejardhja⁵.

Motivet e pasura turistike dhe pozita (radhitja) adekuatë (e përshtatshme) e tyre në mënyrë lineare dhe grupe dëshmojnë se territori i Kosovës paraqet motive specifike turistike e cila përbëhet prej ultësirës së Kosovës dhe rrafshit të Dukagjinit dhe motiveve të Sharrit, Bjeshkëve të Nemuna (Alpeve Shqiptare) dhe bjeshkëve të Kopaonikut.

Në pjesë të tilla janë të koncentruar numër i madh i motiveve antropogjenë, motiveve kulturore dhe historike, vendbanime të vjetra dhe motive etnografike-etnologjike me specifika të tyre. Të gjitha e përbëjnë të kaluarën specifike dhe historike të kësaj hapësire.

Kosova është e pasur me fondin e vlerave turistike, të cilat në përbërjen e tyre përmbajnë shkallë të gjerë të motiveve natyrore, morfologjike, hidrografike, biogeografike dhe antropogjenë me motivet ambientale, qytetet, vendbanimet dhe objektet tjera, përmendoret historike dhe muzetë si dhe motivet etnografike - etnologjike.

Në sipërfaqen prej 10 887 km² janë të pranishme mbi 370 motive dhe objekte turistike të cilat mund të igrupohen në shkallë të lartë të mundësisë relative të valorizimit duke marrë për bazë si pjesë të fondit të motiveve të tilla mund të paraqesin motive të përbashkëta dhe të pavarura.

Prej numrit të motiveve dhe objekteve turistike, pjesa më e madhe i përket objekteve kulturore dhe monumenteve historike mbi 160, të atyre me motive natyrore 40, në lokalitetet e vjetra dhe arkeologjike 44, monumente nga lufta e dytë botërore 68 si dhe numër i madh i

⁵ Raporti i gjendjes së natyrës 2006 – 2007, AKMM/IKMN, Prishtinë, 2008.

përmendoreve dhe monumenteve të luftës së UÇK - se me Prekazin heroik dhe legjendën e kombit Adem Jashari, ne te cilin lokalitet vlen të theksohet se Kompleksi "Adem Jashari" i cili prinë me numrin e vizitorëve në Kosovë, edhe është hapësira me e vizituar në Kosovë.

Deri në vitet e shtatëdhjeta në mungesë të rrugëve të mira , në Kosovë kishte pak lëvizje turistike Pas viteve të shtatëdhjeta me ndërtimin dhe modernizimin e rrjetit rrugor automobilistik dhe përmirësimin e gjendjes ekonomike , fillojnë lëvizjet turistike te shtohen.

Qarkullimet turistike lokale, individuale, familjare e grupe me qëllim pushimi e rekreacioni bëhen sidomos gjatë verës për t'u freskuar pran baseneve, lumenjve, liqeneve, ose gjatë stinës së dimrit në qendrat e skijimit (Brezovicë e Rugovë) e gjetcë.

Në Kosovë turizmi duhet te jete degë e rëndësishme ekonomike. Industria Turistike e Kosovës ka realizuar 8-10% të produktit shoqëror vendor ,varësisht nga fakti për cilin vit është fjala dhe a janë marrë parasysh të gjithë faktorët e drejtpërdrejtë (industria hoteliere, gastronomia) ose faktorët indirekt (bujqësia , ndërtimtaria, etj.)

Planifikimi cilësor i hapësirës është një ndër parakushtet më të rëndësishme për zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të turizmit në Kosovë.

Prandaj territori i Kosovës paraqet hapin me të shkurtër në mes zonave më atraktive turistike. Në këtë hapësirë prehen tri drejtimet kryesore „Magjistralla e Adriatikut, Magjistralla e Ibrit, Transferzalet qe lidhen me Evropën Lindore.

Me rëndësi te veçantë e kemi **Autostrada Durrës – Morinë – Prishtinë - Merdar** e cila do të jetë në funksion të qarkullimeve turistike për territorin e Kosovës, rëndësia e saj do të jetë e shumëfishitë dhe e ndërsjellë për qarkullimet me shtetin amë dhe shtetet e rajonit. Zhvillimi ekonomik është një ndër përgjegjësitë më të rëndësishme të Qeverisë së Kosovës. Në kushtet e vendit tonë, turizmi mundë të jetë një sektor veprimtarie me një raport shumë të favorshëm për të bërë investime. Në Kroaci,Slloveni, Bullgari, Maqedoni dhe Shqipëri turizmi është një nga degët që ka thithur investitorë të huaj dhe të qëndrueshëm. Edhe Kosova me mundësi të konsiderueshme turistike kërkon shumë investime për një zhvillim më të suksesshëm të turizmit. Në planin afat shkurtër, kryesisht mendohet në restaurimin, modernizimin dhe rekonstruimin e objekteve hoteliere për vendosje të dëmtuara, dhe ndërtimin e objekteve të reja të turizmit stacionar dhe atë të biznesit. Nevoja për turizëm tashmë është e dukshme dhe i jep jetë një kërkesë të qëndrueshme, e cila bazohet pos tjerash edhe në komunitetin e madh të huaj të vendosur në Kosovë.

Megjithëse, ekonomia turistike në periudhën e pas luftës ka arritur një zhvillim të konsiderueshëm të bazës materiale, ky zhvillim ka qenë stilik dhe i përcjellur me probleme në përmasa brengosëse. Materiali synon të paraqesë ide Qeverisë së Kosovës për drejtimit e mundshme që do të ndikojnë në evitimin e problemeve të shfaqura, konsolidimin, dhe nxitjen e zhvillimit më harmonik të turizmit në Kosovë.

Shfrytëzimin e mundësive që ka Kosova do të rezultojë në rritjen e numrit të turistëve të huaj, shfrytëzimin e kapaciteteve turistike, rritjen e punësimit, realizimin e të hyrave si dhe do të krijojë kushte për zhvillimin e sektorit të turizmit konform parimeve që ka industria turistike bashkëkohore .

Qarkullimet fizike turistike në Kosovë dhe problemet e tregut turistik janë evidente, pra tregu nënkupton kontaktin e individëve në mes shitësit dhe blerësit si një formë e lidhjes teknike, e cila në një hapësirë dhe në kohë të caktuar ofrojnë ose kërkojnë llojin e mallrave të caktuara dhe shërbimet me anë të parasë dhe kjo paraqet një hapësirë ekonomike ku krijohen kushtet e kërkesave dhe të ofertës, pra edhe ky është një vend ku formohen çmimet. Lidhur me tregun turistik si treg specifik, ka definicione të shumta.

Te gjitha definicionet janë të bazuara në lidhje në mes ofertës dhe kërkesave, por në të nuk dominojnë prodhimi dhe shërbimet. " Ana specifike e tregut turistik përqendrohet në faktin e specifikave të kërkesave dhe të ofertës,pikësëpari për arsye se prodhimi dhe shërbimet turistike takohen në vendin e vetë prodhimit".

Kjo dallon prej prodhimit të ofertës së mallrave ose të mirave, të cilat takohen në treg, jashtë vend prodhimit të tyre, të cilat u ofrohen blerësve. Blerësit në turizëm përkundër kësaj vijnë në vendin e prodhimit dhe të shërbimeve turistike."

Tregu turistik përcakton masën e nevojave turistike rekreative, kulturore dhe zbavitëse të cilat nuk janë elemente dhe faktorë ekonomikë.Tregu turistik i përket sektorit terciar, sepse edhe vetë turizmi i takon këtij segmenti të aktivitetit njerëzor. Në tregun turistik, lënda e kërkesave turistike nuk mund të jetë vetëm prodhimi dhe shërbimet, por elementet specifike të shërbimeve, të cilat janë cilësore në përcaktimin e fizionomisë së tregut turistik, të bazuara në shkallën e atraktivitetit të faktorëve natyrorë, antropogjenë, ku është ngritur shkalla e ofertës turistike, e paraqitur me kapacitetet turistike.

Për të vlerësuar ndikimin e tregut turistik gjithnjë duhet të kemi parasysh bazën e ofertës, të përqendruar në masën e elementeve atraktive, qofshin ato natyrore apo të krijuara nga njeriu, me

të cilën mund të shpjegohen motivet e kërkesave turistike, që kanë për bazë rekreacionin dhe zbatimin (argëtimin).

Në mekanizmin e tregut turistik të gjitha të mirat transformohen në mallra prandaj tregu njih vetëm kategoritë e mallrave.

Ne bazë të kriterëve të ndryshme tregjet ndahen në disa grupe: Në tregun lokal, rajonal, ndërkombëtar, në tregun e përgjithshëm të specializuar, në tregun e lirë dhe të dirigjuar, në tregun e organizuar dhe të paorganizuar.

Statistikat kufitare në shërbim të Turizmit të Republikës së Kosovës

Ne pikat kufitare në periudhën nga viti 2008 deri në fund të tremujorit të vitit 2011 kanë hyrë gjithsejtë 18.333.562 ndërsa kanë dalë 16.166.160 persona. Gjatë kësaj periudhe nëse krahasohet ecuria e hyrje daljeve, shihet se ka rritje të vlerave të numrit të pasagjerëve edhe në hyrje edhe në dalje⁷.

Gjithsejtë

Emri i Stacionit	Pasagjerë të kontrolluar	
	Hyrje	Dalje
Aeroporti	2071918	2156089
Regjioni Perëndimor	5323819	4823763
Regjioni i Veriut	4601818	3196031
Regjioni i lindjes	6336007	5990277
Gjithsejtë	18.333.562	16.166.160

Lufta konkurrencte ndërmjet vendeve udhëheqëse receptive në tregun ndërkombëtar turistik kërkon mundësinë e përshtatjes së shpejtë të kushteve tregtare. Ajo mbi të gjitha e ka theksuar rëndësinë e njohjes së atyre shërbimeve turistike dhe mallrave, të cilat shfrytëzuesit e tyre më së miri dhe së pari do t'i pranojnë.

⁷ Te dhëna nga Departamenti i turizmit dhe hotelerisë në MTI

Tregu turistik për turizmin dhe qarkullimin turistik ushtron rëndësi të madhe. Pa treg nuk ka turizëm, e po ashtu pa turizëm nuk ka treg. Turizmi është një bashkësi e shumë elementëve ekonomike dhe joekonomike, të cilat me intensitetet e ndryshme krijojnë turizmin bashkëkohor. Rreth turizmit ndikojnë elementet e përmendura ndërsa elementet joekonomike të rrethiës turistike varen nga kushtet shoqërore dhe politike, resurset natyrore, situata demografike, etj⁸

Sipas turizmit, dukuritë e turizmit kanë përafërsisht vlerë të njëjtë si funksionet ekonomike, të turizmit të cilët i konsiderojmë si mekanizëm i funksionit të tregut.

Konsumi turistik me shumë rëndësi i jep funksionit ekonomik. Në raste të shumta si pasojë e funksioneve joekonomike të turizmit, kryhet edhe konsumi ekonomik dhe në bazë të tyre krijohen kushtet për zhvillimin e degëve të ndryshme ku realizohen të ardhurat⁹.

Deri me tani janë sajuar shumë funksione turistike sepse kjo është dukuri shumë funksionale. Pothuaj se nuk është e mundur të ndahen funksionet ekonomike dhe joekonomike të turizmit, sepse të dyja realizohen në aktivitetet rekreative të turizmit.

Turizmi dhe aktivitetet turistike paraqiten si prodhim i zhvillimit bashkëkohorë shoqëroro-ekonomik. Qarkullimet turistike ende ngecin pas këtyre fenomeneve, edhe pse janë krijuar kushtet materiale dhe teknike për masivizimin e turizmit.

Përfundime dhe sugjerime

- Duke u bazuar në analizën e gjendjes ekzistuese, është konstatuar se struktura e objekteve të vendosjes ende nuk është në nivel të kënaqshëm .
- Kapacitetet e tyre kryesisht i përgjigjen kërkesës individuale turistike ose të grupeve të vogla të turistëve. Krijimi i kushteve për ngritjen e kapaciteteve të reja për vendosje dhe krijimi i një produkti turistik konkurrent, është pikësynim i Strategjise së propozuar dhe materialeve të tjera.

⁸ Te dhëna nga Departamenti i policisë kulturore

⁹ M. Gashi, Drejtimit kryesor turistik evropian dhe pozita e Kosovës ndaj tyre.

- Për këtë qëllim synimet e parashtruara janë orientim i qartë, drejt ngritjes së nivelit të ofertës turistike dhe zhvillimit të një turizmi të qëndrueshëm dhe konkurrent.
- Me këtë ndihmon sektorin e turizmit , të menaxhojë rritjen e zhvillimit të turizmit në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëri afatgjate;
- të identifikojë mënyrat e menaxhimit të konflikteve nëpërmjet rritjes së zhvillimit të turizmit dhe vlerave mjedisore, sociale dhe kulturore që janë të rëndësishme për aferten dhe kërkesën turistike;
- të japë strukturën e përshtatshme brenda së cilës investimet dhe përfitimet e industrisë turistike mund të lehtësohen dhe të rriten, si dhe definimi i qartë i përgjegjësive dhe bashkëpunimi në mes të sektorëve relevant;
- të reduktojë vakuumet ekzistuese brenda sektorit;
- të identifikojë mundësitë për sigurimin e burimeve financiare për zhvillimin e turizmit nga institucionet qeveritare, investitorët strategjikë dhe donatorët;
- të krijojë lehtësira për komunitetin e biznesit në këtë sektor;
- të sigurojë integrimin e projekteve për arritjen e objektivave strategjike dhe realizimin e strategjive për turizëm dhe hoteleri.
- Në të ardhmën kërkohet që të bëjmë të pamundurën të mundar për krijimin e një ambienti të përshtatshëm dhe të një sistemi efektiv të përkrahjes së turizmit dhe hotelerisë në Kosovë;
- Harmonizimin e politikave vendore (legjislationit dhe rregulloreve) me ato të BE-së; Vendosijen e dialog-bashkëpunimit në mes të gjithë sektorëve qeveritarë dhe institucioneve që në mënyrë direkte apo indirekte të merren me zhvillimin e turizmit në Kosovë;
- Rritje afatgjate dhe zhvillim të qëndrueshëm të turizmit me theks të veçant sektorëve të tij nga pikëpamja e kontributit të tyre ndaj bruto-produktit kombëtar dhe hapjes së vendeve të punës;
- Strategjia e zhvillimit të turizmit në Kosovë;
- Hartimi i skemave dhe projekteve të reja për përkrahje të turizmit;
- Fushatë komunikative për çështje të turizmit;
- Rregullim fizik të ambientit për përkrahje të turizmit;

- Zhvillim i kapaciteteve trajnuese për këshilltarë afaristë;
- Dhënien e shërbimeve për përkrahjen e turizmit, etj.

Bazuar ne hulumtimet paraprake te cilat janë përfunduar nga institucionet relevante dhe praktikat e përvojat e fituar nga vendet që kanë kaluar periudhën e tranzicionit ose të atyre që janë në tranzicion e sipër por edhe të vendeve më të zhvilluara siç është Anglia, Italia, Gjermania e Austria dëshmojnë se nuk ka zhvillim të mirëfilltë të sektorit privat pa mbështetje substanciale të shtetit. Duke elaboruar pikat e nevojshme për këtë mbështetje institucionale , disa shtylla të kësaj mbështetje të cilat krijojnë një cikël

komplet të kësaj mbështetje dhe e cila mbështetje ndikon direkt për të përmbushur kete mision qe nuk është i vogël. Për çdo shtyllë janë zhvilluar programe dhe projekte që janë në funksion të realizimit të këtij misioni shume me vlere.

BIBLIOGRAFIA

1. M. Gashi , Vepra: "Vlerat turistike ne Kosovë" Plani regional hapësinor i KSAK Prishtinë 1969.
2. N. Muhaxheri, Vepra : Ekonomika dhe Menaxhmenti në Turizëm-Prishtinë 2005.
- 3.. M. Boyer, " Vepra : Le tourisme", Paris 1970.
4. Drejtimit kryesore turistike evropiane dhe pozita e Kosovës ndaj tyre. Prof Dr Musa Gashi.
5. J. Dumazdier, Vepra : "Vers une civilistaion de loisir", Paris, 1972.
6. Rudollf Bičanić: "Tipologija tržišta", informator, Zagreb, 1968.
7. S. i Z. Marković, Vepra : "Ekonomika turizma", Zagreb, 1967.
8. Plani hapësinor për Istog, Klinë, Rahovec dhe Suharekë EUP 1984.
9. Ligji Për mbrojtjen e natyrës Nr:02-L 18.
10. Raporti I gjendjes se natyrës 2006 – 2007, AKMM/IKMN, Prishtine, 2008
11. Analiza hapësinore e Komunës se Malishevës, M MPH/IPH/Mars 2008
12. Materiale nga interneti .

TURIZMI ALTERNATIV: SI DOMOZDOSHMËRI PËR NJË ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

Fabjana MAKSUTAJ, Msc
Kandidate ne PhD, Pedagoge e Jashtme
Fakulteti i shkencave Sociale
Universiteti i Tiranës, Shqipëri

Prof.Dr. Vjollca BAKIU
Pedagoge
Fakulteti i Ekonomisë
Universiteti i Tiranës, Shqipëri

Mimoza KOTOLLAKU, Msc
Kandidate ne PhD, Pedagoge
Fakulteti i Ekonomisë
Universiteti "Aleksander Xhuvani", Elbasan, Shqipëri

Sot është koha të flasim për një lloj tjetër zhvillimi të turizmit në një vend, atë të bazuar në burimet alternative të tij dhe në standarde botërore, pasi ai përbën domosdoshmëri për zhvillim të mëtejshëm të një vendi në shumë drejtime. Thënë kjo për faktin se sot shihen tendenca të shfrytëzimit të turizmit vetëm për prurjet ekonomike të tij, pa u shqetësuar aspak për dëmet e shkaktuara, pa u shqetësuar aspak për zhvillimin e tij të qëndrueshëm në të ardhmen, e aq më tepër për alternativa zhvillimi mbi bazë të eko-turizmit si model zhvillimi me norma e standarde, të cilat i kërkon koha dhe zhvillimi i të ardhmes.

Është momenti i "alarmit", në kërkim të modelit më të mirë të zhvillimit, që lidh burimet e shfrytëzuara me interesat njerëzore dhe me leverditë ekonomike. Është, pikërisht eko-turizmi, modeli më i mirë i kohës, i cili i kombinuar me Turizmin Alternativ duhet të merret në konsideratë nga institucionet kompetente në zbatim të llojeve të zgjedhura për zhvillim të turizmit në vend. Dikush mund t'a përcaktojë atë si model elitari, dikush si model të shtrenjtë, por asnjë s'mund t'a kundërshtojë atë si modelin më të mirë, që mund t'i rezistojë kohës, për zbatimin e të cilit brezat e ardhshëm do të n'a falënderojnë dhe nuk do n'a kritikojnë.

Sigurisht, ne duhet të ndajmë përgjegjësi, ndaj asaj që realizojmë sot, me qëllim që brezat e ardhëm të ndihen komod nesër. Dhe për këtë dëgjoni shkencëtarët: Midis shumë zgjidhjeve të propozuara, ai që tërheq më shumë vëmendjen sot është "turizmi alternativ" me theksin tek "eko-turizmi". Ai përbën një "marrëveshje" ambientale, social-kulturore dhe ekonomike, e tillë që në gjuhën popullore gjen shprehjen: "mishi të piqet dhe helli të mos digjet", pra thënë ndryshe: burimet turistike (natyrore, kulturore, historike, sociale, ekonomike, etj) mund të përdoren si alternativa zhvillimi të llojeve dhe formave të ndryshme të turizmit, por të mos shkatërrohen, me qëllim që, po në të njëjtën cilësi, ndofta më të lartë, produkti turistik të ofrohet edhe për të ardhmen. Specifika e këtij

zhvillimi, qëndron në "njohjen" e mjedisit si një element, jashtë të cilit nuk mund të mendohet zhvillimi i përgjithshëm i shoqërisë.

Prandaj kërkohet turizëm me standarde mbi bazë normash dhe kriteresh të domosdoshme të zhvillimit të qëndrueshëm të një vendi, si dhe harmonizim i përdorimit të tyre me zhvillimin mjedisor, ekonomik dhe social e kulturor, me synim kontributin e kësaj fushe në integrimin e vendeve tona në Evropë e më gjerë.

Fjalët Kyç: Zhvillim i qëndrueshëm, Turizëm i qëndrueshëm, Turizëm Alternativ, Norma dhe standarde për integrim, Eko-turizëm.

Hyrje

Turizmi tashmë është kthyer në një industri, e cila nga ana e saj një vetëm rritje në të gjithë botën. Por, sot zhvillimi dhe ruajtja e mjedisit vihen përballë me emergjencën e shqetësimeve sociale dhe ato ambientale, të cilat i krijojnë vetë kjo industri. Përkundrazi, Turizmi Alternativ me drejtimin eko-turistik shihet si zgjidhja e mrekullueshme për të siguruar zhvillimin ekonomik të vendit, ruajtjen e mjedisit dhe rritjen e mirëqenies së vendeve.

Edhe pse sot, tentohet që eko-turizmi të karakterizohet si "simbol i qëndrueshmërisë", janë të rrallë shembujt në zbatim të tij, sepse bota me eksperiencat e saj në fushën e turizmit, ka zgjedhur dhe zbatuar në të shkuar modele të ndryshme zhvillimi, si rezultat i të cilave ajo sot po ngre kambanat e alarmit, në kërkim të zgjidhjeve më të mira për të ardhmen.

Zgjedhja e modelit Alternativ më të mirë të Zhvillimit të Turizmit

Dihet që lidhjet ndërmjet turizmit dhe mjedisit natyror tentojnë të jenë konfliktuale, por që ekziston mundësia për lidhje simbioze, të bazuara në përfitime të përbashkëta.

Kështu:

- Turizmi Alternativ me theksin tek Eko-turizmi me normat dhe kriteret e shfrytëzimit të burimeve të ndryshme turistike, kontribuon në mënyrë aktive, në ruajtjen e tyre.
- Turizmi Alternativ me theksin tek Eko-turizmi bën që me normat dhe kriteret e shfrytëzimit të përfshihet edhe komuniteti lokal i cili merr pjesë në planifikimin dhe zhvillimin e burimeve turistike, duke bërë që ato të përdoren nga vetë komuniteti, duke kontribuar në rritjen e mirëqenies së tij.
- Një Turizëm Alternativ në theksin tek Eko-turizmi, me normat dhe kriteret e tij të shfrytëzimit, i propozon vizitorëve një lloj interpretimi ose më saktë, një lloj edukimi të tyre për burimet turistike në favor të zhvillimit dhe jo shkatërrimit të tyre.

Në thelbin e vet "Turizmi Alternativ" me theksin e "eko-turizmit" përfshin tre aspekte kryesore:

- Një lloj turizmi i drejtuar nga ruajtja e burimeve të përdorura
- Një lloj turizmi me elemente edukative në përdorim
- Një lloj turizmi si domosdoshmëri e qëndrueshmërisë së zhvillimit

Turizëm me Norma dhe Standarde si Domosdoshmëri e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Vendet tona më shumë se kurrë sot, kanë nevojë të ketë një qëndrueshmëri zhvillimi, ku pa dyshim një rol të rëndësishëm në këtë zhvillim do të luajë edhe turizmi, i ngritur dhe ndërtaur mbi baza të qëndrueshme, me synim rritjen e vazhdueshme cilësore të tij, gjë që do të thotë se ky zhvillim duhet të bëhet në rrugë të përcaktuara mirë, duke përfutur nga eksperiencat e vendeve më të zhvilluara, qofshin këto pozitive apo negative, duke bërë të mundur mos përsëritjen e këtyre të fundit në vendet tona. Prandaj, flitet sot për standarde zhvillimi, e për më tepër edhe për standarde në fushën zhvillimit të mëtejshëm të turizmit, pa të cilat nuk mund të kaptohet zhvillimi i vendit, pasi burimet natyrore, historike, kulturore, sociale dhe ekonomike të tij, flasin në favor të këtij zhvillimi, por meqë këto burime turistike njohin limite, ato kërkojnë edhe kujdes në përdorim.

Këto standarde theksin e vënë në:

- Përcaktimin e kapacitetit mbajtës të mjediseve fizike, të cilat luajnë rolin e burimeve natyrore të përdorura nga turizmi, të tilla p.sh. si rëra dhe deti në plazhe etj. Në se do t'i referoheshim disa treguesve në këtë drejtim sipas standardeve evropiane, mund të thoshim se për çdo frekuentues në plazhe ranore ose shkëmbore duhet jo më pak se 10 m² të sipërfaqes së saj për çdo përdorues, apo 6-8 m² të sipërfaqes së ujit për çdo notues, ose jo më pak se 2 m gjatësi bregdeti për çdo përdorues, etj.
- Përcaktimin e normave të ndërtimit të kapaciteteve akomoduese dhe të faciliteteve për turistët, si hotele, fshatra turistike, restorante, bar-kafe, etj, ku p.sh. kapaciteti i dhomave të hoteleve duhet të jetë në përputhje me kapacitetin e mjedisit fizik ku është ngritur hoteli apo struktura akomoduese, e të tjera të kësaj natyra. Kështu p.sh. densiteti i turistëve në një sipërfaqe prej 1 ha duhet të jetë jo më shumë se 50 turistë për hotelet e kategorive të luksit, dhe 90 turistë për 1 ha për hotelet e kategorive mesatare, etj.
- Ruajtja ndaj ndotjeve ekologjike, duke përcaktuar limite ndaj ndotjeve të ndryshme të mjedisit, si p.sh. përcaktimi i kufijve të ngarkesës bakteriale të ujit, ajrit, apo përcaktimi i CO₂, SO₂ në atmosferë, etj. Pra, kërkohen norma të përcaktuara mirë mbi bazë të studimeve konkrete të mjediseve përkatëse fizike të vendeve respektive, ndryshe zhvillimi do të degjenerojë në sensin negativ, duke krijuar probleme ambientale të ndotjeve ekologjike, apo probleme sociale me komunitetin.

- Kërkohen normat për infrastrukturën dhe mjetet e ndryshme të transportit të nevojshme për përdorim në fushën e turizmit. Mendohet të jenë të pranishme kudo në zonat turistike duke lehtësuar turistët dhe duke presupozuar se përdorimi i infrastrukturës dhe mjeteve të ndryshme të transportit bëhet mbi bazën e kritereve të përcaktuara. Të tilla mund të përmendim p.sh. jo më pak se 10 m shëtitore në breg të detit për person, jo më pak se 50 m rrugë për çiklist, jo më pak se 20 m rrugë për vrapist, jo më pak 100 m rrugë për kalërim, jo më pak se 1 ha për anije në vozitje, jo më pak se 0.5 ha për anije në lundrim, e të tjera si këto, të cilat rrisin së tepërmi cilësinë e turizmit, dhe mbrojnë mjedisin ku operon fusha përkatëse.
- Kërkohen norma të lidhura me çështjet social-kulturore, demografike dhe ekonomike, të cilat janë të rëndësishme për të krijuar bashkëpunim me komunitetin dhe jo probleme me ta, kështu mund të përmendim raportin ndërmjet rezidentëve dhe turistëve, i cili mund të shkojë në raportin 1:1.4, ose fuqia punëtore në hotele e cila mund të luhet nga 0.7 në 0.1 person për dhomë hoteli, raport i cili përcaktohet nga kategoria e hoteleve, ose p.sh vlefshmëria e një apartamenti mund të përcaktohet nga numri i turistëve të akomoduar në të, i cili mund të shkojë deri në 4 turistë për apartament, e të tjera si këto, të cilat duhet të merren në konsideratë nga institucionet përkatëse për të ngritur një turizëm cilësor dhe rezistent në kohë.

Përdorimi i Standardeve Turistike në Harmoni me Zhvillimin Mjedisor, Ekonomik e Social - Kulturor të Vëndit

Është Zgjedhja e Turizmit Alternativ të bazuar në modelin e Eko-turizmit ai që mund të bëjë fare mirë harmonizimin e përdorimit të standardeve në fushën e turizmit duke sjellë me veta impakte të rëndësishme në drejtime të ndryshme të zhvillimit të vendeve, *si në mjedis, në ekonomi, dhe në drejtim të zhvillimit social-kulturor të tij.*

Ai, shoqërohet me efekte pozitive mbi mjedisin natyror, ekonomik dhe social-kulturor. Kështu, nëse do të krahasonim kostot dhe përfitimet ekonomike, ekologjike dhe sociale të zbatimit të modelit alternativ të zhvillimit të turizmit me theks tek eko-turizmi, ato do të ishin shumë më të pranueshme nga ato të një modeli tradicional të turizmit apo të atij masiv. Po në këtë këndvështrim do të thoshim edhe për koficientet e rentabilitetit ekonomik të cilët duhet të vlerësohen në kontekst ndryshe, duke bërë vlerësimin e efekteve të modelit të eko-turizmit jo vetëm në terma të rentabilitetit financiar, por edhe në drejtim të impakteve që sjell ai mbi të ardhurat dhe mbi aktivitetet dhe kushtet sociale të popullsisë lokale në vite.

Impaktet mjedisore:

Turizmi është parë shpesh si një përgjegjës për degradimin e mjedisit natyror. Në fakt eko-turizmi paraqet një nga format e rralla të zhvillimit të turizmit i cili favorizon mbrojtjen e zonave natyrore, falë programeve dhe projekteve të ruajtjes të mjedisit mbi bazën e të cilave mund të bëhet financimi.

Pikërisht mbi këtë bazë sot, përcaktohen treguesit e përfitimeve ekologjike, të cilët janë tregues përbërës të rëndësishëm, që kufizojnë limitet e presionit të përdorimit të burimeve natyrore të zonave të ndryshme turistike. Kështu, OMT ka përcaktuar tre tregues përbërës të tillë, të cilët janë lehtësisht të adaptueshëm me vlerën që duhet të emetojnë burimet natyrore në përdorim dhe përfitimeve ekologjike të tyre. Bëhet fjalë për:

- *Treguesi e kapacitet mbajtës të mjedisit:* i cili përcaktohet si numër maksimal i turistëve për një zonë të përcaktuar në një periudhë të përcaktuar, duke mbajtur parasysh intensitetin e përdorimit në periudhën e pikut të saj. Në raste përdorimi mbi këtë limit, organizatat përgjegjëse duhet të japin alarmin në këtë drejtim.
- *Treguesi i ndotjes për një zonë të caktuar:* ky tregues lejon të bëhen marrëveshje në nivele të përcaktuara për zonën përkatëse, duke mbajtur parasysh veçoritë natyrore dhe ekologjike të saj. Bëhet fjalë për t'ju përgjigjur mjedisit natyror, deri në ç'masë ai ka një impakt negativ si rezultat i përdorimit të tij. Nga ana tjetër kjo tregon se cilat duhet të jenë masat që duhen të merren në funksion të intensitetit të ndotjes së zonës së përdorur nga turizmi.
- *Treguesi i interesit ekologjik:* Ky tregues duhet të tregojë veçoritë ekologjike të zonës përkatëse në një masë të tillë që, ato mbeten atraktive për turizmin edhe pas përdorimit. Ato mund të ndryshojnë me kohën dhe me frekuentimin turistik, por ideja është që përsëri ato duhet të mbeten atraktive edhe në të ardhmen, me qëllim që të sigurohet vazhdimësia e investimeve turistike.

Interesi i këtyre treguesve mjedisor është se, ato lejojnë të sigurohet një syrvejm i vërtetë ekologjik i produkteve të turizmit, duke krijuar një vizion global të këtyre produkteve në të njëjtën hapësirë gjeografike nga shumë operatorë.

Do të jetë shumë e mërzitshme për të përshkruar të gjitha efektet negative që mund të shkaktohen nga turizmi. Shkenca nëpërmjet studimeve të ndryshme i ka evidentuar ato, të cilat kanë ardhur si rezultat i veprime abuzive mbi mjedisin, si rezultat i aktiviteteve rekreative jo të kontrolluara mbi mjedis, si rezultat i prishjes së florës dhe faunës, i ndotjeve të ndryshme, erozionit, etj. Megjithatë është me interes për të theksuar që këto efekte pothuajse eliminohen në se vendosen dhe zbatohen treguesit korrekt mbi përdorimin e mjedisit.

Impaktet ekonomike:

Eko-turizmi mund të përbëjë një forcë të re për ekonominë e një vendi në vështirësi, duke dhënë mundësi të mëdha për përmirësim të ekonomisë lokale të tij, duke krijuar punësim për ta dhe rritje të ardhurash të vazhdueshme si dhe qëndrueshmëri ekonomike të tyre. Megjithëse ato në vitet e para nuk përbëjnë ndonjë "bum" të madh, aq sa të justifikojnë financimet për mbrojtjet e dëshiruara të mjedisit, por studimet tregojnë se efektet pozitive ekonomike të eko-turizmit mund të merren në konsideratë veçse pas disa vitesh, të cilat sigurojnë zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Shumë vende kanë zgjedhur të kthehen drejt eko-turizmit pas përvojave negative të tyre, dhe pse jo, vendet tona duhet të ndërtojnë një model të tillë, me qëllim që të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të komunitetit, duke mos haruar që kontributi i një turizmi alternativ me theks tek ekoturizmi në ekonominë lokale nuk varet vetëm nga paratë që hyjnë në rajon, por gjithashtu dhe mbi të gjitha, nga pjesa e këtyre parave që lëvizin në vend. Frytet e kapitalit të investuar janë paratë që vijnë nga zbatimimi i projekteve të zhvillimit turistik dhe një nga mënyrat më të mira për të evituar rrjedhjen e parave jashtë, do të ishte implikimi i komuniteteve lokale në të gjitha etapat e projekteve turistike me qëllim që ky kapital të shumëfishohet brenda tij, duke garantuar rritjen e mëtejshme ekonomike.

Impaktet social-kulturore:

Impaktet social-kulturore shpesh janë më të vështira për t'u identifikuar nga pikëpamja sasiore në krahasim me dy të parat. P.sh. duke u nisur nga ky moment a është duke parë një komunitet që për arsye të turizmit, traditat e tij janë duke u mohuar? Sipas Fox:

"Impaktet sociale dhe kulturore të turizmit janë mënyra mbi bazën e të cilave turizmi kontribuon në ndryshimin e sistemit të vlerave të njeriut, në sjelljet individuale, në marrëdhëniet familjare, në mënyrat e jetës kolektive, në nivelin e sigurisë, në anën morale, në shprehjet krijuese, në ceremonitë tradicionale, dhe në organizimin e komunitetit."

Analiza e impakteve social-kulturore e turizmit bëhet mbi bazën e tre elementeve kryesore të cilët janë:

- Turistët: kërkesa e tyre për shërbime, sjellja e tyre, qëllimet dhe veprimet e tyre;
- Komuniteti pritës: roli dhe sjellja e tyre përballë shërbimeve të kërkuara nga turistët dhe shqetësimi e tyre në lidhje me sjelljet e vizitorëve mbi mënyrën e jetës tradicionale të komunitetit.
- Lidhjet ndërmjet turistëve dhe komunitetit pritës: kjo lidhje duke qënë diku tranzitore, e kufizuar në kohë dhe në hapësirë, shpesh provon spontanitet dhe pabarazi.

Sipas autorëve të njohur në këtë fushë, një nga impaktet më të vjetra të turistëve me komunitetin lokal është pa asnjë lloj kundërshtimi, komercializimi i riteve kulturore tradicionale, si p.sh. vështrimi i ceremonive fetare. Kjo mund të quhet "efekt i kopshtit zoologjik", sepse nuk ka asnjë ndërveprim ndërmjet vizitorëve dhe të vizituarve. Ndodh që në disa rajone, turizmi përbën një instrument të rigjallërimit, ose të rivlerësimit të praktikave kulturore, ndonjëherë të harruara të autoktonëve, duke kontribuar kështu në një bashkëjetesë me vizitorët dhe të vizituarit dhe duke rindërtuar një identitet kolektiv.

Sjelljet apo veprimet në aparençë, ndonjëherë banale të turistëve, mundet të kenë konsekuenca të paparashikuara dhe të pakthyeshme mbi strukturën sociale ose mbi traditat e komunitetit të izoluar. Për arsye të delikatesës së tyre, Turizmi alternativ me theks tek eko-turizmi është vigjilent përballë efekteve negative të turizmit në planin social-kulturor, duke bërë kërkime të ndryshme në këtë fushë dhe duke dhënë zgjidhjet përkatëse në mbrojtje të tyre.

KOKLUZIONE

- "Turizmi Alternativ" me theks "Eko-turizmin" është modeli më i arrirë, që ashtu si ari edhe ai është tepër i vështirë të gjendet", por, në jetë duhet gaxuar, duhet synuar për të fituar. Prandaj duhet të tentojmë për t'a realizuar atë, nëse me të vërtetë duam zhvillimin, duam qytetërimin, duam integrimin.
- "Turizmi Alternativ" me theks "Eko-turizmin" është nevojë e kohës, pasi e gjithë bota është kthyer tashmë drejt saj, prandaj duhen studime konkrete me specifikat e zonave të ndryshme turistike në një vend, për të hartuar norma, apo tregues të saktë me synim zbatimin e tyre nga organet kompetente, në funksion të realizimit të qëndrueshmërisë së zhvillimit dhe integritit në botën e qytetëruar moderne.
- Eko-turizmi bën që të ëndërrohet:
Udhëtarët shihen të zhytur në një "shungëll luksoze", në zemër të një ambienti të mbrojtur të hapësirave të rrala dhe të ngjyrosura.
Komuniteti shihet posedues i traditave të tij, duke qenë i sigurt për të ardhmen.
Shteti shihet si përfitues i një pjese të të ardhurave financiare, duke ju përgjigjur strategjive të tij për të aderuar në një zhvillim të qëndrueshëm dhe në një integrim të qytetëruar.
- Me qëllim që këto ëndrra të realizohen, duhet të shumëfishohen përpjekjet për studime me synim, kthjellimin e situatave, duke e parë "Turizmi Alternativ me theks Eko-turizmin" si një pistë për të këshilluar zhvillimin social-ekonomik të shoqërisë sonë dhe mbrojtjen e mjedisit në vendet tona. Një ëndërr e tillë do të bëhet realitet vetëm e vetëm nëse propozimi i treguesve të zhvillimit të Turizmit do të jetë i studiuar mbi bazën e veçorive të vendit dhe nëse bëhet i mundur zbatim i tyre, **atëherë moto duhet të jetë: të gjejmë të studiojmë, me qëllim që të propozojmë dhe të zbatojmë, me idenë që të fitojmë.**

Bibliografia:

- Alen Croix- Guide de L'histoire Local
Akademia e Shencave-Studime Gjeografike 7
Douglas Pearce-Geographie du Tourisme
Francois Vellas- Le Tourisme
Jan-Marie De Ketele- Guide du Formateur
Marc Boyer -La communication Touristique
Sarah Lemelle- Le Tourisme et des Loisirs
Vjollca Bakiu: Drejtimi i Ndërmarrjeve Hoteliere Turistike
Vjollca Bakiu- Menaxhimi i Turizmit
Vjollca Bakiu- Ekonomia e Turizmit

VALORIZIMI TURISTIK I MALIT SHARR NGA KËNDVËSHTRIMI I RESURSEVE NATYRORE

Prof.dr.Fauzi Skenderi¹

Hyrje

Ndryshimet bashkëhore që kanë ndodhur në aspektin e zhvillimit të përgjithshëm, kanë ndikuar edhe në vlerësimin dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore për zhvillimin e ekonomisë përkatësisht të zhvillimit të ekonomisë turistike në vjeçanti. Kështu që, Rajoni i Malit Sharr është kompleks në vehte që mundëson, si zhvillimin e turizmit, ashtu edhe të disa degëve primare të ekonomisë nëpërgjithsi. Duke patur parasyshë, se ky rajon nuk ka sasi të mjaftueshme pasurishë tjera natyrore, kur është fjala për resurse mineralike, pasi ky, mal i takon grupit të maleve të reja të orogjenezës alpine, që shkencërisht është vërtetuar se janë të varëra, që do të ndikonte në zhvillimin e sektorëve tjerë të ekonomisë, dhe për këtë ka shënuar ngecje në këtë plan. Ndërkaq, shfrytëzimi në shkallë më të lartë të resurseve turistike të këtij rajoni, do të ndikonte në rritjen numrit të punësuarve në sektorin terciar dhe do të pengonte shpërnguljen e popullsisë aktive që është plagë e pashërueshme e kësaj treve.

Pozita gjeografike

Mali Sharr paraqet masivin më të madh dhe më të lartë malor në Maqedoni, i cili shtrihet në pjesën veriperëndimore të vendit dhe në skajin më jugor të Kosovës. Ka pozitë verilindje – juperëndim, me një gjatësi 80 km dhe gjerësi 10-20 km. Me luginën e lumit Shkumbin të Tetovës, ndahet në dy tërësi morfologjike: në atë verilindore dhe jugore. Në lindje nga Mali i Zi i Shkupit është i ndarë me grykën e Kaçanikut, përkatësisht nga lugina e thellë e lumit Bukurosh, ndërsa përmes qafave të larta malore në pjesën burimore të Radikës në aspektin morfologjik, ndërlidhet me masivin malor të Korabit. Në Malin Sharr ka shumë maja malore mbi 2000 metra. Si më të rëndësishme janë: Lypeteni 2.499 m, Maja e Zezë 2.585 m, Maja e Diellit 2.748 m, si dhe shumë të tjera. Në periudhën antike Mali Sharr është quajtur Scardus, ndërsa emrin e sotshëm e ka që nga pjesa e parë e Shekullit XIX.² Mali Sharr është krijuar gjat rudozjes alpine, dhe në tërësi është formuar në terciarin e mesëm. Në përbërjen gjeologjike bëjnë pjesë: ranorët, kuarcitet, dollomitet, granitet, gëlqerorët e mermerizuar, diabazitet, etj.

Pasuritë natyrore

Rajoni i Malit Sharr posedon potencial të rëndësishëm, në të cilat duhet të mbështetet zhvillimi i ardhshëm, i cili duhet të orientohet në zhvillimin e atyre sektorëve për të cilat ekziston baza e potencialeve natyrore dhe ato veprimtari që kanë rëndësi të madhe për popullsinë e këtij rajoni si: zhvillimi i turizmit dimëror sportiv dhe veror rekreativ, turizmi malor, turizmi edukativturizmi i gjuetisë dhe peshkatarisë, turizmi shëtitës, zhvillimi i pylltarisë, zhvillimi i blegtorisë etj.

¹ Departamenti i Gjeografisë- Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Bulevardi "Gostivari", pa.1200 tetovë, fauzi_skenderi@yahoo.com

² Skenderi, F.Gjeomorfologjia, Tetovë. 2006

³ Stojmilov, A.Gjeografia e Republikës së Maqedonisë Shkup1996

Sharrë me bukuritë e ralla natyrore dhe me biodiversitetin të llojeve bimore dhe shtazore, është nga më të veçantit në gadishullin Ballkanik. Vlerat e trashigimisë natyrore janë pasuri e një populli, ndërsa përkushtimi i kujdesjes ndaj tyre tregon në përgjithësi nivelin kulturor dhe shoqërorë të popullit përkatës. Potenciali për zhvillimin e këtij rajoni janë: resurset natyrore dhe humane

Mirëpo natyra e këtij rajoni përbën pasurinë më të madhe: përbërja gjeologjike dhe relievi karakteristik, klima, hidrografia, flora dhe fauna sidhe pejzazhet mahnitëse që mbretërojnë në këtë masiv malor.

Klima

Klima është faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin e aktiviteteve të njeriut. Ajo përfshinë këto elemente klimatike: temperaturën e ajrit, diellzimin, lagështinë e ajrit, reshjet, dhe errërat.

Temperatura e ajrit – me rritjen e lartësisë mbidetare për çdo 100 metra vërehet rënia e temperaturës për 0.56°C . Kështu që në Malin Sharr mund të dallohen disa breza të lartësisë sipas dallimeve të temperaturës. Në lartësinë mbidetare 1400-1800 metra temperaturat e ulta paraqiten në periudha prej 4 muajsh, brezi i dytë i lartësisë është prej 1800-2100 metra ku temperaturat e ulta qëndrojnë një periudh prej 5 muajsh, në brezin e tretë të lartësisë prej 2100-2500 metra temperaturat e ulta zgjasin deri në 6 muaj, mbi 2500 metra temperaturat e ulta zgjasin mbi 6 muaj. Mirëpo në malin Sharr na paraqitet gjat dimrit edhe dukuria e inverzionit, ku për dallim nga fushgropa e Pollogut, temperaturat rriten me rritjen e lartësisë mbidetare.

Diellzimi - kushtëzohet nga këndi i rënies së rrezeve të diellit dhe nga kohëzgjatja e ndriçimit. Në Kodrën e Diellit, kohëzgjatja mesatare vjetore e ditëve me diell është 101.8 ditë. Numri më i madh i ditëve të kthjellëta është në muajin Gusht 15.3 ditë, kurse ditë më pak me diell, ka në Janar vetëm 5 ditë. Numri më i madh i ditëve me diell nuk është vetëm në stinën e verës, por edhe në dimër, ku mesatarisht kemi 7.3 ditë të kthjellëta, gjë që ndikon pozitivisht në zhvillimin e turizmit dimëror sportiv.

Lagështia e ajrit - ka shumë rëndësi për ofertën turistike. Lagështia mesatare vjetore e ajrit në Kodrën e Diellit është 73%, kurse në muajt e verës i afrohet vlerave optimale, duke aritur në 60%, gjë që mundëson qëndrim të këndshëm. Lagështia më e madhe e ajrit është në Tetor 84%, kurse më e ulët në Korrik 63%.

Rreshjet – paraqesin një element shumë të rëndësishëm meteorologjik, të cilët ndikojnë në zhvillimin e veprimtarive ekonomike. Rajoni i Malit Sharr dallohet me sasi të mjaftueshme të rreshjeve në formë të borës, me kohëzgjatje deri në 151 ditë, e cila ofron kushte shumë të mira për zhvillimin e turizmit dimëror.

Errërat – në malin Sharr më së shumti fryjnë nga veriu dhe verilindja e perëndimi. Në Kodrën e Diellit më së shpeshti fryjnë errërat verilindore. Këto errëra janë të forta dhe fryjnë zakonisht gjatë muajve të vjeshtës dhe dimrit. Në muajt e pranverës fryjnë errërat nga drejtimi i perëndimit, që populli i quan errëra jugore, këto janë të ngrohta dhe në pranverë e verë sjellin të rreshura shiu.⁴

Hidrografia

Rajoni i Malit Sharr është i pasur me rrjedha ujore dhe liqene akullnajore të njohura në popull si „sytë e malëve.. Lumejtë e Malit Sharr i përkasin pellgut të detit Egje dhe detit Adriatik. Të gjithë rrjedhat ujore pikënisjen e kanë në cirqet akullnajore, të cilët gjenden në lartësi të 1800-2500 metra, duke përbërë pellgun ujëmbledhës në sektorët e sipërm të këtyre

⁴ Skenderi, F. Gjeografia turistike, Tetovë, 2006

rrjedhave. Në dalje prej cirqeve këto rrjedha thellojnë shtratin e tyre deri sa arrijnë të formojnë lugina të thella, gjatë rrjedhës së poshtme të tyre duke marrë edhe trajtën e kanioneve. Midis këtyre rrjedhave veçojmë përroi e Orashës, lumin e Tearcës, Shkumbinin, atë të Bogovinës, Mazdraçës, përroi i Vrapçishtit etj. të cilët fillojnë nga cirqet midis majës së Lubotinit dhe Lumbardhit të Tearcës. Në Pollogun e Poshtëm lumi më i madh është Shkumbini, i cili buron në lartësi mbidetare 2410 metra, në shpatiet veriore të Majës së Diellit, ka një sipërfaqe të pellgut prej 192 km² dhe gjatësi 36.8km, i cili në fshatin Saraqinë derdhet në lumin Vardar.

